

ROBERTO BOLAÑO  
**DETEKTIVËT E EGËR**

---

BOTIMET TOENA



ROBERTO BOLAÑO

# Detektivët e egër

Përktheu nga origjinali spanjisht  
BAJRAM KARABOLLI

BOTIMET TOENA  
Tiranë, 2015

Ky libër botohet me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës

Botuese: Irena Toçi

Korrektore letrare: Arlinda Rrushi  
Përkujdesja grafike: Elida Stafa  
Kopertina: Albana Gega

ISBN 978-9928-205-27-8

© 1998 Roberto Bolaño  
© *në shqip* Botimet Toena, 2015

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA  
Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë  
Tel.: + 355 4 22 40 116; 22 58 893  
Fax: +355 4 22 40 117  
E-mail: [redaksia@toena.com.al](mailto:redaksia@toena.com.al)  
[botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)  
[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

Më 2 nëntor 1998, një juri e përbërë nga Salvador Klotas, Huan Kueto, Paloma Díaz-Mas, Luis Gojtisolo, Ester Tusket dhe botuesi Horhe Herralde i dha *Çmimin Herralde të Romanit*, me unanimitet të plotë, romanit *Detektivët e egër* të Roberto Bolanjos.

Më 2 gusht 1999, një juri, e përbërë nga Saul Sosnovski, Argjentinë; Antonio Benites Roho, Kubë; Anheles Mastreta, Meksikë; Hugo Açuğar, Uruguaj; Karlos Nogera, Venezuelë - ndër dhjetë romanet më të mira, midis 220 romaneve të vitit në Amerikën Latine, përzgjedhi romanin Detektivët e egër të shkrimtarit kilian Roberto Bolanjo, të cilit, me katër vota pro, iu dha Çmimi Ndërkombëtar i Romanit Rómulo Gallego.

*Për Karolina Lopesin dhe Lautaro Bolanjon, fatmirësisht të ngjashëm.*





- E doni ju shpëtimin e Meksikës?  
Doni që Krishti të jetë mbreti ynë?  
- Jo.

MALCOLM LOWRY



# I. Meksikanë të humbur në Meksikë (1975)



## 2 nëntor

U ftova përzemërsisht të bëhem anëtar i realizmit viseral<sup>1</sup>. Sigurisht, pranova. Nuk pati ceremoni hyrëse. Më mirë ashtu.

## 3 nëntor

Nuk e di mirë se ku qëndron realizmi i thellë. Jam shtatëmbëdhjetë vjeç, quhem Huan Garsia Madero, jam në semestrin e parë të karrierës së Drejtësisë. Unë dua të studioj Letërsi e jo Drejtësi, por im ungj nguli këmbë dhe, më në fund, i hapa udhë. Jam jetim. Do të bëhem avokat. Këtë i thashë tim ungji dhe tetos, domethënë së shoqes, pastaj u mbylla në dhomën time dhe qava tërë natën. Ose të paktën një pjesë të mirë të saj. Pastaj, me një nënshtrim të dukshëm, hyra në të lavdishmin Fakultet të Drejtësisë, por në krye të një muaji u regjistrova në studion e poezisë së Hulo Cezar Alamos, në Fakultetin e Filozofisë dhe Letërsisë, kështu njoha *real-visceralistas* ose *viscerealistas*, madje edhe *viscerrealistas*<sup>2</sup>, siç u pëlqen të quhen nganjëherë. Deri në atë kohë unë kisha asistuar katër herë në studio

---

<sup>1</sup> *Visceral* (sp.) – ndjenjë shumë e thellë dhe e rrënjosur, ndërsa *vice* (sp.) – zëvendës.

<sup>2</sup> Realizmi viseral ose real-viseralizmi (realismo visceral o real-visceralismo) - është emri fiktiv që autori i jep lëvizjes infrarealiste që vetë ai themeloi në Meksikë së bashku me Mario Santiagon, që do të thoshte shkëputje nga realiteti apo refuzimi i realitetit për të shkruar. Autori bën lojë fjalësh (me fjalët *visceral* dhe *vice*), duke u tallur me këto të ashtuquajtura lëvizje letrare, krijuar nga djelmosha si ai dhe shokët e tij.

dhe nuk më kishte ndodhur asgjë, që është një fjalë goje, sepse ç'është e vërteta gjithmonë ndodhnin gjëra: lexonim poema dhe Alamoja, varur se në ç'humor ndodhej, i ngrinte në qiell ose i asgjësonte fare; njëri lexonte, Alamoja kritikonte, tjetri lexonte Alamoja kritikonte, përsëri lexonte një tjetër, Alamoja kritikonte. Nganjëherë Alamoja mërzitej dhe kërkonte që edhe ne (ne që në ato çaste nuk lexonim) të kritikonim dhe atëherë ne kritikonim e Alamoja kthehej e lexonte gazetën.

Ishte një metodë e saktë që asnjë të mos bëhej mik me askënd ose që miqësitë t'i kishin themelet në smirën dhe inatin.

Nga ana tjetër nuk mund të them se Alamoja ishte një kritik i mirë, edhe pse gjithnjë fliste për kritikën. Tani e kam të qartë se fliste sa për të folur. E dinte se ç'ishte një perifrazë, jo shumë mirë, por e dinte. Ama nuk e dinte se ç'ishte një *pentapodia* (që, siç e dinë të gjithë, në metrikën klasike është një sistem pesë këmbësh), po ashtu nuk e dinte se ç'ishte një *nicárqueo* (që është një varg i ngjashëm me *falecio*-n), as çfarë ishte një *tetrástico* (që është një strofë me katër vargje). Po nga ta di unë që ai nuk i dinte? Sepse që ditën e parë në studio bëra gabimin për ta pyetur. Nuk e di nëse ishte duke menduar. I vetmi poet që i di përmendsh këto gjëra është Oktavio Paz<sup>3</sup> (armiku ynë i madh), të tjerët nuk e kanë idenë, të paktën kështu më tha Ulises Lima, disa minuta pasi unë të isha pranuar miqësisht në radhët e realizmit viseral. T'i bëje pyetje të tilla Alamos, siç do ta provoja më vonë, do të ishte një mungesë takti nga ana ime.

Në fillim e mora për shenjë admirimi buzëqeshjen që më lëshoi. Më vonë e mora vesh se qe thjesht një përbuzje. Poetët meksikanë (besoj se poetët në përgjithësi) të urrejnë, po t'u kujtosh injorancën e tyre. Por unë nuk desha t'ia dija dhe, kur më hodhi poshtë nja dy poezi në mbledhjen e dytë ku mora pjesë, e pyeta se a e dinte se ç'ishte një *rispetto*. Alamoja mendoi se unë i kërkova të respektonte poezitë e mia dhe filloi të fliste për kritikën objektive (për t'i ikur temës), se ajo na ishte një fushë e minuar ku duhet të kalojnë gjithë poetët e rinj, etj., por nuk e lashë të vazhdonte dhe pasi e sqarova se

---

<sup>3</sup> Octavio Paz (1914-1998) - poet, shkrimtar, diplomat dhe përkthyes meksikan. Fitues i çmimit *Nobel* në letërsi për vitin 1990.

unë kurrë në jetën time nuk kisha kërkuar respekt për krijimet e mia të mjera, ia formulova përsëri pyetjen, kësaj here duke e shqiptuar në rrokje me qartësinë më të madhe të mundshme.

- Mos më fol broçkulla, Garsia Madero, - tha Alamoja.

- Një *rispetto*, i dashur maestro, është një tip poezie lirike, për të qenë më i saktë, poezi dashurie, e ngjashme me *strambotto*-n, që ka gjashtë dhe tetë njëmbëdhjetërrrokësh, katër të parët me formë provansale dhe të tjerët të ndërtuar në çifte. Për shembull... - dhe isha gati t'i jepja një ose dy shembuj, po ndërkohë Alamoja u ngrit dhe menjëherë i dha fund diskutimit. Ajo që ndodhi më pas është e mjegullt (edhe pse unë kam një kujtesë të mirë): mbaj mend gazin e Alamos dhe të qeshurat e katër a pesë shokëve të studios, sigurisht duke u tallur në kurrizin tim.

Po të ishte ndonjë tjetër në vendin tim, nuk do të kishte shkelur më në studio, ndërsa unë, me gjithë kujtimet e mia ogurzeza (ose mungesa e kujtimeve, për rastin më zindjellës sesa bllokimi mnemoteknik i tyre), tërë javën në vazhdim isha atje, i përpiktë si gjithnjë.

Besoj se qe fati im që më çoi përsëri atje. Ishte e pesta mbledhje për mua në studion e Alamos (por mund të ishte edhe e teta apo e nënta, përfundimisht vura re se koha i përkulet ose i shtriqet arbitrit të vet) dhe tensioni, rryma alternative e tragjedisë vinte rrotull pa ditur askush ta shpjegonte pse. Që në fillim, ishim të gjithë, të shtatë nxënësit poetë të regjistruar fillimisht, diçka që nuk kishte ndodhur më parë. Gjithashtu: ishim nervozë. Vetë Alamoja, zakonisht shumë i qetë, ndiente njëfarë frike. Për një çast më shkoi mendja se ndoshta diçka kishte ndodhur në universitet, ndonjë shkëmbim zjarri në kampusin e tij, gjë për të cilën unë nuk dija gjë, ndonjë grevë e papritur, vrasje e dekanit të fakultetit, sekuestrim i ndonjë profesori të Filozofisë ose diçka e tillë. Por asgjë nga këto nuk kishte ndodhur dhe askush nuk kishte motive për të qenë nervoz. Të paktën, objektivisht askush nuk kishte motive. Por poezia (poezia e vërtetë) ashtu është: parandihet, vjen vërdallë si tërmeti që, siç thonë, e parashikojnë disa kafshë posaçërisht të afta për këtë punë. (Këto kafshë janë gjarpërinjtë, krimbat, minjtë dhe disa zogj.) Ajo që ndodhi më pas qe e vrullshme, por që dallohej nga diçka që, me

gjithë rrezikun për t'u bërë qesharak, do të marr guximin ta quaj të mrekullueshme. Erdhën dy poetë real-viseralistë dhe Alamoja, nga e keqja, na i prezantoi, edhe pse vetëm njërin prej tyre njihje personalisht, një tjetër e njihje me të dëgjuar ose ia kishte dëgjuar emrin, apo dikush i kishte folur për të, por gjithsesi na i prezantoi.

Nuk e di se ç'kërkonin ata atje. Vizita e tyre binte erë të qartë lufte, pa përjashtuar një nuancë propagandistike dhe proselitizmi. Në fillim real viseralistët u sollën të heshtur ose të matur. Në të njëjtën kohë Alamoja mbajti një qëndrim diplomatik, me një ironi të lehtë, për të pritur ç'do të ndodhte, por, pak nga pak, para drojës së të ardhurve e mori veten dhe pas gjysmë ore studioja u bë si gjithnjë. Atëherë filloi beteja. Real-viseralistët e vunë në dyshim sistemin kritik që përdorte Alamoja; ndërkohë ky i quajti real-viseralistët surrealistë pa vlerë dhe marksistë të rremë, duke qenë i mbështetur në këtë përplasje nga pesë anëtarë të studios, pothuaj nga të gjithë, përveç një djaloshi tepër thatim, i cili gjithnjë vinte me një libër të Levis Kerolit<sup>4</sup> dhe që pothuaj nuk fliste kurrë; po ashtu edhe përveç meje, ngaqë qëndrimi i të tjerëve sinqerisht më la pa mend, sepse ata që mbështetnin me aq guxim Alamon ishin po ata që u rezistonin me stoicizëm kritikave të tij të pamëshirshme, ndërsa tani hiqeshin si mbrojtësit e tij më besnikë (gjë që më habiste). Atëherë vendosa t'u dal pak krah të huajve duke e akuzuar Alamon se ai nuk e kishte idenë ç'ishte një *rispetto*; real-viseralistët pranuan publikisht se edhe ata nuk e dinin çfarë ishte një *rispetto*, por vërejtja ime iu duk me vend dhe ashtu e shprehën; njëri prej tyre më pyeti se ç'moshë kisha, unë thashë shtatëmbëdhjetë vjeç dhe u përpoqa përsëri të shpjegoja se ç'ishte një *rispetto*; Alamoja u bë spec nga inati; ndërsa anëtarët e tjerë të studios më akuzuan për pedant (njëri tha se unë bëja si një akademist); real-viseralistët më mbrojtën; atëherë mora zemër dhe e pyeta Alamon dhe gjithë të tjerët nëse dinin të paktën se çfarë ishte një *nicárqueo* apo një *tetrástico*. Po askush nuk dinte të përgjigjej.

Ndryshe nga ç'prisja unë, diskutimi nuk mbaroi në një sherr të përgjithshëm. Për këtë duhet të them se isha i kënaqur. Por, si përfundim, edhe pse një nga anëtarët e studios i premtoi Ulises

---

<sup>4</sup> Lewis Carroll (1832–1898) – romancier dhe matematikan britanik.



Limës se ndonjë ditë do t'i thyente turinjtë, edhe pse unë reagoja ndaj kërcënimit të tij (që, e përsërit, nuk më drejtohej mua), duke e siguruar kanosësin se do të isha përherë në dispozicion të tij, në çdo qoshe të kampusit, në ditën dhe orën që ai të kishte qejf, nuk ndodhi asgjë e dhunshme.

Fundi i mbrëmjes që i papritur. Alamoja e sfidoi Ulises Limën duke i thënë që të lexonte një nga poemat e tij. Ky, pa e bërë dy, nxori nga xhepi i xhaketës ca letra të pista e të zhubravitura. Sa e tmerrshme, mendova, ky budalla po futet vetë në gojën e ujkut. Besoj se mbylla sytë nga turpi për tjetrin. Ka vend për të lexuar poezi, ka dhe vend për të bërë grusht. Për mua ishte momenti për këtë të fundit. Siç thashë, mbylla sytë dhe dëgjova Limën duke pastruar zërin. Pastaj heshtje (nëse kjo është e mundur, megjithatë dyshoj), diçka e sikletshme po ndodhte rreth tij. Më në fund, dëgjova zërin e tij duke lexuar poemën më të mirë, të cilën unë nuk e kisha dëgjuar kurrë. Pastaj u ngrit Artur Belanoja dhe i tha të shkonin të kërkonin poetët që donin të merrnin pjesë në takimin që real-viseralistët mendonin të bënin. Të gjithëve do t'u pëlqente të merrnin pjesë, por pas diskutimit ndiheshin si të turpëruar dhe askush nuk e hapi gojën. Kur u mbyll studioja (më vonë se zakonisht), shkova me ta deri te stacioni i autobusëve. Ishte shumë vonë. Tashmë nuk kalonte asnjë, kështu që vendosëm të marrim së bashku një mikrobus deri te shëtitoretja *Reforma* dhe prej aty do të iknim në këmbë deri te një bar në rrugën *Bucareli* ku qëndronim deri vonë duke folur për poezinë.

U përmbajta dhe nuk fola për të gjitha. Emri i grupit, nga një anë, është një shaka dhe, nga një anë tjetër, është diçka plotësisht serioze. Besoj se vite të shkuara ka pasur një grup modernistësh meksikanë të quajtur real-viseralistët, por nuk e di nëse ishin shkrimtarë apo piktorë, gazetarë apo revolucionarë. Nuk e kam të qartë as nëse kanë vepruar në vitet njëzet apo tridhjetë. Sigurisht, nuk kisha dëgjuar për atë grup, por kjo është për faj të padijes sime në çështjet letrare (të gjithë librat e botës janë në pritje që t'i lexoj). Sipas Artur Belanos, real-viseralistët u zhdukën në shkretëtirën e Sonoras. Pasi përmendën njëfarë Sesarea Tinahero apo Tinaha, nuk më kujtohet, besoj se në ato çaste unë diskutoja me të bërtitura me një kamerier

për disa shishe birre, ata folën për *Poezjitë* e Kont të Lotreamo<sup>5</sup>, diçka për *Poezjitë* e asaj Tinaheros, dhe pastaj Lima bëri një pohim misterioz. Sipas tij, real-viseralistët e sotëm po ecnin mbrapa. Si mbrapa? - pyeta.

- Me shpinë, duke parë në një pikë, por duke u larguar prej saj, drejt një rruge të panjohur.

Thashë se më dukej mrekulli të ikësh në atë mënyrë, edhe pse në të vërtetë nuk kuptova asgjë. Ama, po ta mendosh mirë, është mënyra më e keqe e të ecurit.

Më vonë erdhën poetë të tjerë, disa real-viseralistë, të tjerë jo, dhe poterja u shtua. Për një çast mendova se Belanoja dhe Lima, duke u marrë tërë kohën me atë farë personazhi të çuditshëm, më kishin harruar mua, dhe kur filloi të agonte më thanë nëse doja të bëhesha pjesë e bandës. Nuk thanë “grupi” apo “lëvizja”, thanë banda dhe kjo më pëlqeu. Sigurisht, u thashë, po. Qe shumë e thjeshtë. Njëri nga ata, Belanoja, më shtrëngoi dorën, tha se tashmë isha njëri nga ata dhe pastaj kënduam një rançera<sup>6</sup>. Kaq ishte. Kënga bënte fjalë për fshatrat e humbura të veriut dhe për sytë e një gruaje. Para se të villja në rrugë, i pyeta nëse ata sy ishin të Sesarea Tinaheros. Belanoja dhe Lima më shikuan e më thanë se pa dyshim unë isha një real-viseralist dhe se bashkë do të ndryshonim poezinë latinoamerikane. Në gjashtë të mëngjesit, këtë herë isha vetëm, mora një mikrobus tjetër që më solli deri te lagjja Lindavista, ku jetoj. Sot nuk shkova në universitet. E kalova gjithë ditën mbyllur brenda në dhomë duke shkruar poezi.

#### 4 nëntor

U ktheva te bari në rrugën *Bucareli*, por real-viseralistët nuk u dukën. Ndërkohë që i prisja, iu futa të lexuarit e të shkruarit. Të zakonshmit e barit, një grup të dehurish të heshtur dhe të mbrapshtë, nuk po m'i shqitnin fare sytë.

---

<sup>5</sup> Conde de Lautréamont (1846–1870) – poet uruguian me origjinë franceze.

<sup>6</sup> Rançera (ranchera sp.) – këngë popullore meksikane.

Pasoja e pritjes pesë orë rresht: katër birra, katër tekila, një pjatë supe që e lashë në mes (ishte gjysmë e prishur), leximi i plotë i librit të fundit me poema të Alamos (të cilin e kisha marrë me vete vetëm që ta tallja atë me miqtë e mi të rinj), shtatë tekste të shkruara në mënyrën e Ulises Limës (i pari mbi supat që mbanin erë varri, i dyti mbi universitetin: e shikoja të shkatërruar, i treti për universitetin: unë bridhja lakuriq në mes të një turme lugetërish, i katërti mbi hënën e Meksikos, i pesti për një këngëtar të vdekur, i gjashti mbi një shoqëri sekrete, që jetonte poshtë ujërave të zeza të *Chapultepec*-ut, dhe i shtati për një libër të humbur dhe për miqësinë) ose më saktë sipas mënyrës së të vetmes poemë që njoh të Ulises Limës, të cilën nuk e kam lexuar, por e kam dëgjuar, madje sipas një ndjenje fizike e shpirtërore vetmie.

Nja dy të dehur deshën të më provokonin, por me gjithë moshën e vogël, kam një karakter që i thyej turinjtë kujtdo. Një kameriere (di që quhet Brixhida dhe thoshte se do të më kujtonte për natën që kalova atje me Belanon dhe Limën) më përkëdheli flokët. Qe një përkëdhelje e shkujdesur, ndërsa shkonte për të shërbyer te tavolina tjetër. Më pas, u ul një çast me mua dhe si pa të keq tha se kisha flokë shumë të gjatë. Megjithëse ishte simpatike, nuk desha t'i përgjigjem. Në orën tre të mëngjesit u ktheva në shtëpi. Real-viseralistët nuk u dukën. A thua nuk do t'i shoh më?

## 5 nëntor

Asnjë lajm për miqtë. Po bëhen dy ditë që nuk shkoj në fakultet. As më shkon në mendje të kthehem përsëri në studion e Alamos. Sot pasdite shkova prapë te *Kryqëzimi Veracruzana* (bar i *Bucareli*-t), por asnjë fytyrë të real-viseralistëve nuk pashë. Është interesante: ç'ndryshime pëson një bar i tillë i vizituar pasdite apo natën, madje edhe në mëngjes. Kushdo do të thoshte se janë klube të ndryshme. Këtë pasdite lokali dukej më zgjyrë nga ç'është në të vërtetë. Fytyrat kriminele të natës ende nuk ishin paraqitur, që do të thoshte se klientela është më bishtnuese, më transparente dhe më paqësore. Tre zyrtarë sojsëzë, si duket funksionarë, të bërë tapë, një shitës

vezësh breshkujësesh me shportëzën bosh, dy maturantë, një zotëri i thinjur i ulur në një tavolinë duke ngrënë pite pikante. Kamerieret po ashtu janë të ndryshme. Tri të sotmet nuk i njihja edhe pse njëra m'u afrua e ma tha copë: ti duhet të jesh poeti. Duhet ta them troç se nga ky pohim u turbullova, por edhe m'u bë qejfi.

- Po, zonjushë, jam poet. Po ju nga e dini?

- Më ka folur Brixhida për ty.

Brixhida, kamerierja!

- E çfarë ju tha më? - e pyeta pa guxuar ende t'i drejtohem me ti.

- Se shkruan poezi shumë të bukura.

- Si mund ta di këtë ajo kur nuk ka lexuar asgjë nga poezitë e mia?

- Thashë duke u skuqur pak, por gjithnjë e më i kënaqur nga udha që kishte marrë biseda jonë. Gjithashtu mendova se vërtet Brixhida mund të kishte lexuar ndonjë nga poezitë e mia: më ka përçmuar! Kjo nuk më pëlqeu fare.

Kamerierja (me emrin Rosario) më pyeti nëse mund t'i bëja një nder. Duhej t'i thosha "varet", siç më ka mësuar (deri në mërzi) im ungj, por nuk jam i tillë dhe i thashë fol, si është puna.

- Do të më pëlqente të më bëje një poezi, - tha.

- Qoftë e kryer! Këto ditë e ke gati, - i thashë, duke iu drejtuar me ti për herë të parë dhe si me rrëmbim i kërkova të më sillte një tekila tjetër.

- Mirë, po të qeras unë, - tha ajo. - Ama poezinë e dua tani.

U përpoqa t'i shpjegoj se një poezi nuk shkruhej ashtu, fët-fët.

- Po pse u dashka me aq nxitim?

Shpjegimi që më dha që një çik i mugët; me sa dukej ishte fjala për një premtim bërë Virgjëreshës së Guadalupe, diçka lidhur me shëndetin e dikujt, një familjar shumë i dashur dhe shumë i malluar që ishte zhdukur dhe dukur përsëri. Po çfarë përshkruante një poemë në gjithë këtë? Për një çast mendova se kisha pirë shumë, se kisha shumë orë pa ngrënë dhe se alkooli e uria më kishin shkëputur nga realiteti. Por shpejt kuptova se nuk isha dhe aq keq. Pikërisht një nga premisat për të shkruar poezi të këshilluara nga realizmi visceral, nëse nuk e kam harruar (edhe pse në të vërtetë nuk i vë dot duart në zjarr), ishte ndërprerja e përkohshme me çdo lloj realiteti. Sidoqoftë, e vërteta është se në atë orë klientët rralloheshin shumë, prandaj të dy

kamerieret dalëngadalë u afruan te tavolina ime dhe tani ndodhesha në siklet, në një pozitë gati dudumi (realisht dudumi), por çdo shikuesi që nuk e kishte idenë e skenës, për shembull, një polici, nuk do t'i dukej ashtu: një student i ulur dhe tri femra në këmbë pranë tij, njëra prej të cilave fërkonte me ijën e djathë të saj supin dhe krahun e majtë të tij, dy të tjerat, me kofshët të mbështetura buzë tavolinës (sigurisht buza e tavolinës do të linte shenja në ato kofshë), i qenë futur një kuvendimi të çiltër letrar, por që, i parë nga dera, mund të dukej gjë krejt tjetër. Për shembull: një pusht në kulmin e llafit me putanat e tij. Apo: një student kodosh që nuk resht së ngashënjyeri.

Vendosa të marr masa të rrepta. Bëra si bëra, u ngrita, pagova, i lëshova një përshendetje plot dashuri Brixhidës dhe ika. Në rrugë më verboi dielli për disa sekonda.

## 6 nëntor

As sot nuk shkova në fakultet. U ngrita shpejt, mora autobusin për në UNAM<sup>7</sup>, por zbrita më përpara dhe një pjesë të mëngjesit u sorollata kot në qendër. Në fillim hyra në Librarianë *Sótano* dhe bleva një libër të Pier Luisë<sup>8</sup>, pastaj kapërceva bulevardin *Juarez*, bleva simite me proshutë dhe shkova të haja e të lexoja, ulur në një stol te parku *Alameda*. Historia e Luisë, e mbi të gjitha ilustrimet, më provokuan një ereksion prej kali. Bëra të ngrihem në këmbë e të ecja, por me karin në atë gjendje ishte e pamundur të shkoje pa bërë të të vështronin të skandalizuar jo vetëm të pranishmit, por edhe gjithë kalimtarët. Kështu që u ula përsëri në stol, mbylla librin dhe fillova të shkund thërrimet nga xhaketa dhe pantallonat. Disa çaste i kalova duke vrojtuar diçka që m'u duk si ketër dhe që rrëshqiste tinëzisht nëpër degët e një peme. Në krye të dhjetë minutave (afërsisht) kuptova se nuk ishte një ketër po një mi. Mi aq i madh?! Nga ky zbulim më mbyti trishtimi. Unë qëndroja aty, pa mundur të lëviz, dhe njëzet metra më tej, i kapur mirë pas një

---

<sup>7</sup> UNAM – Universiteti Nacional Autonom i Meksikës.

<sup>8</sup> Pierre Louÿs (1870–1925) – shkrimtar dhe poet francez.

dege, një mi eksplorator dhe i uritur në kërkim të vezëve të zogjve ose të thërrimeve të shpërndara nga era deri në majë të pemëve (e dyshimtë) apo gjithandej. Zalia m'u ngjit deri në fyt dhe më erdhi të përzier. Nuk prita të villja dhe u ngrita e ia futa vrapit. Pas pesë minutash ecjeje të mirë, ereksioni u zhduk.

Mbrëmjen e kalova në rrugën *Corazón* (paralele me rrugën time) duke parë një ndeshje futboll. Ata që luanin ishin miqtë e mi të fëmijërisë, megjithëse të thuash miq fëmijërie mbase është e tepruar. Shumica ende janë maturantë dhe të tjerët nuk i kanë vazhduar studimet dhe punojnë me prindërit e tyre ose nuk bëjnë asgjë. Që kur unë hyra në universitet, hendeuku që na ndante u zmadhua menjëherë dhe tani jemi si dy planetë të ndryshëm. Kërkova të më fusnin në lojë. Ndriçimi në rrugën *Corazón* nuk është shumë i mirë dhe topi mezi dukej. Veç kësaj, në çdo çast kalonin makina dhe duhej të prisnim. Hëngra nja dy shkelma dhe një goditje topi në fytyrë. Mjaft. Do të lexoj edhe ca Pier Luinë e pastaj do të fik dritën.

## 7 nëntor

Meksikoja ka katërmbëdhjetë milionë banorë. Nuk do t'i shoh më real-viseralistët. Po ashtu nuk do të kthehem më në fakultet, as në studion e Alamos. Të shohim tashmë si do ta rregulloj me tim ungj dhe me teton. Kam mbaruar një libër të Luisë, *Afrodita*, dhe tani po lexoj poetët e vdekur meksikanë, kolegët e mi të ardhshëm.

## 8 nëntor

Kam zbuluar një poemë të mrekullueshme. Për autorin e saj, Efren Rebojedo (1887-1929), nuk më kishin thënë gjë kurrë për të, në leksionet e letërsisë. Po jua kopjoj:

## Vampiri

Kaçurrelat e tua të buta, të arta,  
mbi kurmin tënd të brishtë derdhen lumë,  
me afsh mbi flokët e tu rrëke mbjell unë,  
i zymtë, trëndafila puthjesh të zjarrta.

Ndërsa prek dallgët e tua dredha-flori  
e ti butë-butë, me duart akull më fërkon,  
së brendshmi një rrëqethje më përshkon  
dhe ndiej se më futet në kockë e gj.

Në bebëzat e tua një dritëz e ngazëllyer  
shkëlqen egër tek ma dëgjon psherëtimën  
që del së thelli nga një zemër e shqyer,

ndërsa unë shpirt jap, ti plot lakmim,  
si një vampir i zi lëshon hungërimën  
dhe jetë merr nga i ngrohti gjaku im.

Herën e parë që e lexova (ka disa orë) u mbylla me çelës në dhomën time dhe zura t'i bie me dorë ndërkohë që e recitoja një, dy, tri, deri dhjetë apo pesëmbëdhjetë herë, duke përfytyruar Rosarion, kamerieren, me shalë hapur sipër meje, duke më kërkuar t'i shkruaja një poezi për atë qenie të dashur e të malluar ose duke m'u lutur që ta ngulja mbi shtrat me karin tim përvëlues.

Pastaj i shkarkuar, fillova të reflektoj mbi poezinë.

Vargu "... mbi flokët e tu rrëke mbjell" besoj se nuk ofron asnjë mëdyshje interpretimi. Nuk ndodh kështu me vargun e parë të strofës së dytë: "ndërsa prek dallgët e tua dredha-flori", që shumë mirë mund t'i referohej "mbi flokët e tu rrëke mbjell", duke e marrë fjalë për fjalë, por ku folja "mbjell" ndoshta shpreh një kuptim tjetër.

As "... dallgët dredha-flori" nuk janë shumë të qarta. Vallë janë kaçurrelat e leshit të pubisit, kaçurrelat e flokëve të vampirit apo janë hyrje të *ndryshme* në trupin njerëzor? Me një fjalë, mos po ia fut nga mbrapa? Besoj se leximi i Pier Luisit akoma rëndon në shpirtin tim.

## 9 nëntor

Kam vendosur të kthehem te *Kryqëzimi Veracruzana*, jo ngaqë pres të takoj real-viseralistët, por për të parë edhe një herë Rosarion. I kam shkruar disa vargje. Ku flas për sytë e saj dhe për horizontin e pambarimtë mexikan, për kishat e braktisura dhe për mirazhet e rrugëve që të çojnë drejt kufirit. Nuk e di pse, por mendoj se Rosario është nga Verakruzi ose nga Tabaskoja, po mund të jetë edhe nga Jukatani. Sapo e përmenda atë. Mund të jetë vetëm një imagjinatë e imja. Ndoshta kjo ngatërresë vjen për shkak të emrit të barit dhe Rosario mund të mos jetë as verakruzane, as jukatane, por nga Meksikojë. Sidoqoftë, mendova se disa vargje që evokojnë vise plotësisht të ndryshme nga ato të sajat (në hamendjen për të qenë verakruzane, gjë që përherë e më shumë dyshoj) do të rezultojnë më premtuese, të paktën për sa u përket qëllimeve të mia. Më vonë do të ndodhë ajo që duhet të ndodhë.

Këtë mëngjes shëtita përreth Vilës duke menduar për jetën time. E ardhmja nuk duket shumë e ndritshme, sidomos po të vazhdoj të mungoj në leksione. Megjithatë ajo që më shqetëson në të vërtetë është edukimi im seksual. Nuk mund ta kaloj jetën duke i rënë me dorë. (Gjithashtu më shqetëson edhe edukimi poetik, por e mira është të mos përballesh në të njëjtën kohë me dy probleme). A do ta kem dashnore Rosarion? Po të ketë të dashur tjetër, a do të jetë ai një tip xheloz dhe zotërues? Ajo është shumë e re për t'u martuar, por nuk mund të përjashtohet kjo mundësi. Besoj se i pëlqej unë, gjë që duket hapur.

## 10 nëntor

I gjeta real-viseralistët. Rosario është nga Verakruzi. Të gjithë real-viseralistët më dhanë adresat e tyre dhe unë u dhashë atyre timen. Mbledhjet bëheshin në kafe *Quito*, në *Bucareli*, pak më lart nga *Kryqëzimi Veracruzana*, dhe në shtëpinë e Maria Fontit, në lagjen Kontesha, ose në shtëpinë e piktores Katalina O'Hara, në lagjen *Coyoacán*. (Maria Fonti, Katalina O'Hara, këta emra më kujtojnë diçka, megjithëse ende nuk e di se çfarë.)



Për fat, gjithçka përfundoi mirë, edhe pse qe gati të mbaronte në tragjedi.

Ja si ndodhën gjërat: mbërrita nga ora tetë e mbrëmjes te *Kryqëzimi Veracruzana*. Bari ishte plot dhe pjesëmarrja nuk mund të ishte më mjerane e më e keqe. Në një qoshe ishte edhe një i verbër që i binte akordeonit dhe këndonte. Por unë, pa ndrojtje, u futa në të parën hapësirë boshe që pashë në banak. Rosario nuk ishte. Pyeta kamerieren që më doli përpara dhe ajo u soll si të isha dredharak, trillan dhe fodull. Me një buzëqeshje, kështu po, të mos i dukeshka keq për gjithçka. Singërisht nuk e kuptova fare se ç'desh të thoshte. Pastaj e pyeta se nga ç'vend ishte Rosario dhe më tha nga Verakruzi. Po ashtu e pyeta se nga ishte edhe ajo vetë. Brenda nga kryeqyteti, tha. Po ti? Unë jam kalorësi i Sonoras, i thashë menjëherë, pa u menduar fare. Në të vërtetë, kurrë nuk kam qenë në Sonora. Ajo qeshi dhe ashtu do ta kishim vazhduar bisedën për çaste të tëra, por iu desh të ikte për të shërbyer te një tavolinë. Brixhida, përkundrazi, ishte aty dhe, kur unë po merrja tekilën e dytë, u afrua e më pyeti çfarë po ndodhte. Brixhida është një femër fytyrëvrenjtur, melankolike, si e lënduar. Prej saj më kishte mbetur një imazh krejt ndryshe, por atëherë ajo ishte e dehur, kurse tani jo. E pyeta Brixhidën se ç'kishte bërë kaq vjet. U mundova t'i jap një përshtypje shkathtësie, përfshi edhe gëzimi, megjithëse nuk mund të them se isha vërtet i gëzuar. Brixhida ma mori dorën dhe e vuri mbi zemrën e saj. Në fillim u hodha përpjetë dhe shtytja e parë që pata ishte të largohesha nga banaku, mbase edhe të dilja me vrap nga bari, por e mbajta veten.

- E ndien? - tha.

- Çfarë?

- Zemrën time, budalla. Nuk e ndien si rreh?

Me mollëzat e gishtave preka sipërfaqen që po më dhuronte: bluza e linit dhe gjinjtë e Brixhidës, fshehur pas një gjimbajtëse që m'u duk shumë e vogël për t'i mbajtur ata gjinj. Por asnjë shenjë rrahjeje.

- Nuk ndiej asgjë, - thashë buzagaz.

- Zemra ime, o viçok i tredhur. Nuk e dëgjon si rreh, nuk e ndien se gati po çahet?

- Më fal, po nuk dëgjoj asgjë.

- E si mund ta dëgjosh me dorë, or cjan, unë po të them ta ndiesh. Nuk ndiejnë asgjë gishtat e tu?

- Në të vërtetë... jo.

- E ke dorën akull, - tha Brixhida. - Sa gishta të bukur, duket se nuk i ke vënë asnjëherë në punë.

Ndjeva që më shikonte, më studionte, më gozhdonte. Pijanecët çehrevrarë që ishin në banak i kishte tërhequr përcaktimi i fundit i Brixhidës. Për momentin nuk doja të përzihesha me ta dhe i pohova asaj se gabohej, se patjetër isha i detyruar të punoja për të paguar studimet. Atëherë Brixhida ma mbërtheu dorën, sikur donte të lexonte vijat e fatit tim në të. Kjo më qetësoi dhe e hoqa mendjen nga shikuesit e rrezikshëm.

- Mos m'u përdridh, - tha. - Mua nuk më gënjen dot, të njoh mirë. Je si djalkë mamaje, por ke ambicie të mëdha. Dhe ke fat. Do të arrish aty ku do. Megjithëse këtu shoh se do ta humbasësh rrugën disa herë, për fajin tënd, sepse nuk di se çfarë do. Ke nevojë për një femër që të jetë me ty në të mirë e në të keqe. Apo gaboje?

- Jo, mrekulli, vazhdo, vazhdo.

- Më mirë ikim këtej, - tha Brixhida. - Këta sarhoshë llafazanë nuk kanë pse ta dinë fatin tënd. Si thua?

Për herë të parë mora guximin të shikoj hapur tej e këtej. Katër a pesë pijanecë të frikshëm po dëgjonin me vëmendje fjalët e Brixhidës, madje njëri prej tyre ia kishte ngulur sytë dorës sime, sikur të bëhej fjalë për dorën e atij vetë. Nuk doja t'i zemëroja dhe u buzëqesha të gjithëve, për t'u dhënë të kuptonin se unë nuk kisha të bëja aspak me këtë çështje. Brixhida më pickoi kurrizin e dorës. Sytë e saj qenë ndezur, sikur ishte gati të fillonte një sherr apo t'ia jepte të qarit.

- Këtu nuk mund të vazhdojmë më, eja pas meje.

Diç pëshpëriti me një nga kamerieret dhe pastaj më bëri shenjë. *Kryqëzimi Veracruzana* ishte plot dhe mbi kokat e klientëve ngrihej një mjegull tymi dhe muzika e akordeonit të qorrit. Pashë orën, ishte gati dymbëdhjetë e natës. Mendova: koha paska fluturuar.

Iu vura pas.

U futëm në një hapësirë të magazinës dhe qilarit të ngushtë e të gjatë ku mbanin arkat e shisheve dhe veglat e pastrimit të barit (detergjente, fshesa, finjë, një pajisje gome për pastrimin e xhamave,

një duzinë me dorashka plastike). Në thellësi, një tavolinë dhe dy karrige. Brixhida më tregoi njëërën. U ula. Tryeza ishte e rrumbullakët dhe sipër ishte mbushur me të prera e gdhendje emrash, shumica të pakuftueshëm. Kamerierja qëndroi në këmbë, pak centimetra larg meje, në përgjim, si një perëndeshë apo si një shpend grabitqar. Ndoshta priste t'i kërkoja që të ulej. I mallëngjyer nga druajtja e saj, ashtu bëra. Për çudinë time, ajo u ul mbi gjunjët e mi. U gjenda në siklet të madh e megjithatë në pak sekonda, i tronditur, ndjeva se, jashtë intelektit tim, shpirtit tim, madje përtej edhe dëshirave të mia më të këqija, kari im po fryhej e ngrihej deri në kufijtë e së pamundurës për ta fshehur. Me siguri Brixhida e vuri re gjendjen time, sepse u ngrit dhe, pasi më hulumtoi që nga lart, propozoi biberonin.

- Çfarë..., - thashë.

- Një biberon. Ke qejf të bëjmë biberonin?

E pashë si i shushatur, por edhe si një notar i vetmuar dhe i lodhur që, dalëngadalë, çan në një det të zi të padijes së vet. Ajo ma hodhi sërish vështrimin. Kishte sy të fortë e të rrafshët. Dhe një karakteristikë që unë e kisha vënë re të gjitha qeniet njerëzore që kisha njohur deri atëherë: shikonte gjithnjë (në çdo vend, në çdo situatë, të bëhej ç'të bëhej) në sy. Vështrimi i Brixhidës mund të bëhej i padurueshëm, prandaj vendosa:

- Nuk e di për çfarë flet, - thashë.

- Për të ta thithur, zemra ime.

Nuk munda të përgjigjem dot dhe ndoshta që më mirë ashtu. Brixhida, pa ma ndarë vështrimin, u ul në gjunjë, më zbërtheu pantallonat, e nxori karin tim dhe e futi në gojën e saj. Në fillim kokën, të cilën filloi ta lëpijë e ta ndukë lehtas, gjë që nuk ishte pak shqetësuese, pastaj e futi të gjithë në gojë pa dhënë shenja se do të ma gëlltiste. Në të njëjtën kohë, dora e saj e djathtë po shëtiste duke më fërkuar fundbarkun, barkun dhe gjoksin, e duke më dhënë nëpër to, në intervale të rregullta, ca dacka, vurratat e purpurta të të cilave i ruaj ende. Me sa duket, dhimbja që ndjeva ndihmoi për ta bërë edhe më të veçantë kënaqësinë time, por në të njëjtën kohë bëri që ende të mos prishesha. Herë pas here, Brixhida ngrinte sytë nga puna e saj dhe, pa e lëshuar gjymtyrën time mashkullore, kërkonte

sytë e mi. Atëherë unë mbyllja sytë dhe recitoja vargje të shkëputura nga poezia “Vampiri”, që më vonë, duke u rikthyer tek incidenti, doli të mos qenë fare vargje të marra nga poezia “Vampiri”, por një përzierje djallëzore poezish të ndryshme, fraza profetike të tim ungji, kujtime fëmijërie, fytyra artistesh të adhuruara gjatë pjekurisë sime seksuale (për shembull, fytyra e Angjelicës, Maries, në bardhë e zi), peizazhe që vinin vërdallë të zvarritura nga një shakullinë. Në fillim u përpoqa të mbrohem nga dackat, por duke iu nënshtuar paafësisë së forcave të mia, ia kushtova duart e mia kokës së Brixhidës (e lyer me një ngjyrë gështenjë të hapur dhe jo shumë e pastër, siç munda ta provoj) dhe veshëve të saj të vegjël e të tultë, megjithëse me një fortësi gati mbinatyrore, sikur në ta të mos kishte asnjë grimë mishi apo dhjami, vetëm kërce, plastikë, jo, metal gati të zbutur, ku vareshin dy vathë të mëdhenj prej argjendi të rremë.

Kur përfundimi ishte i afërt dhe unë përpara mundësisë për të mos rënkuar, ngrita grushtet lart duke kërcënuar një qenie të padukshme, që hiqej zvarrë mureve të magazinës, u hap dera me tërsëllimë (po pa zhurmë); u duk koka e një kameriereje dhe nga buzët e saj doli një paralajmërim i thjeshtë:

- Ujë.

Brixhida menjëherë ndërpreu proçkën e saj. U ngrit, më pa në sy me një shprehje keqardhjeje dhe pastaj, duke më tërhequr për xhakete, më çoi deri te një derë, të cilën deri atëherë unë nuk e kisha pikasur.

- Mirupafshim herë tjetër, zemër, - tha me një zë më të ngjirur se zëri i zakonshëm i saj, ndërsa më shtynte jashtë dera.

Papritur e pa kujtuar u gjenda te shërbimet e *Kryqëzimit Veracruzana*, një dhomë katërkëndëshe, e gjatë, e ngushtë dhe e errët.

Eca disa hapa i rrvaguar, ende i trulllosur nga befasia e asaj që sapo më kishte ndodhur. Vinte erë dezinfektuesi dhe dyshemeja ishte e lagësht e vende-vende e mbytur në ujë. Ndriçimi që i mangët, për të mos thënë s’kishte fare. Midis dy lavamanëve të ciflosur pashë një pasqyrë; shikova veten me bisht të syrit; zhiva e pasqyrës më ndërmendi një imazh që më ngriti qimet përpjetë. Me kujdes, duke u munduar të mos shkel atë që rridhte në dysheme, për një çast e pashë se ishte një rrëke e hollë që vinte prej një banje. Atëherë u

afrova përsëri te pasqyra, i pickuar nga kureshtja. Pasqyra më tregoi një fytyrë kuneiforme, në ngjyrë të kuqe të errët, plot me bulëza djerse. U zmbarsa me vërtik sa gati rashë. Në një nga banjat ishte dikush. E dëgjova që qahej e mallkonte. Pa dyshim një pijanec i bërë thumb. Atëherë dikush më thirri në emër:

- Poeti Garsia Madero!

Pashë dy hije bashkë në shurrëtore. Ishin të mbështjella nga një mjegull tymi. Dy homo, a thua dy homo që ma dinë emrin?

- Poeti Garsia Madero, afrohu, robo.

Edhe pse logjika e shëndoshë më thoshte të kërkoja derën e daljes dhe të largohesha sa më shpejt nga *Kryqëzimi Veracruzana*, bëra disa hapa drejt tymnajës. Dy palë sy të ndritshëm, si ata të ujçërve në mes të një suferine (liri poetike, sepse unë kurrë nuk kam parë ujçër; suferinë po, dhe nuk përputhen shumë në veladonin e tymit që mbështillte dy tipat) më vrojtuan. I dëgjova të qeshnin. Hi-hi-hi. Vinte erë marijuanë. E mblodha veten.

- Poeti Garsia Madero, mbylle aparatën.

- Çfarë?

- Loqen... E ke përjashta.

Po mundohesha të mbërthehesha. Vërtet, nga nxitimi dhe hutimi nuk kisha arritur dot ta fshihja zogun tim. U skuqa nga turpi, desha t'i shaj nga nëna por u përmbajta, rregullova pantallonat dhe bëra edhe një hap në drejtim të tyre. M'u dukën të njohur dhe u përpoqa të çaj me sy errësirën që i mbulonte e të dalloja fytyrat e tyre. Ishte e kotë.

Në atë kohë një dorë e pastaj një krah dolën nga mbështjella e tymit që i mbronte, duke më ofruar mbetjen e marijuanës.

- Nuk e dua, - thashë.

- Është drogë, poeti Garsia Madero. Golden Akapulko.

Tunda kokën në shenjë mospranimi.

- Nuk më pëlqen, - thashë.

Zhurma që erdhi nga dhoma në anën tjetër më hodhi përpetë. Dikush foli me zë të lartë. Një burrë. Pastaj dikush bërtiti. Një grua. Brixhida. E mora me mend që pronari i barit po e godiste dhe desha të vërsulem për ta mbrojtur, edhe pse e vërteta është se Brixhida nuk më interesonte shumë (në fakt, nuk më interesonte fare). Kur

po matesha të kthehesha drejt magazinës duart e të panjohurve më mbërthyen. Atëherë pashë të dilnin fytyrat e tyre nga tymnaja. Ishin Ulises Lima dhe Artur Belano.

- Mos u ngatërro me ta, ata të dy ashtu e kanë gjithnjë, - tha Belanoja.

- Cilët ata të dy?

- Kamerierja dhe pronari i saj.

- Por është duke e goditur, - thashë, se goditjet e shpullave tani dëgjoheshin qartë. - Këtë nuk duhet ta lejojmë.

- Ah, çfarë poeti Garsia Madero, - tha Ulises Lima.

- Nuk duhet ta lejojmë, por nganjëherë zhurmat na gënjejnë. Dëgjomë dhe besomë mua, - tha Belanoja.

Pata përshtypjen se dinin shumë gjëra për *Kryqëzimin Veracruzana* dhe desha t'u bëj ca pyetje lidhur me këtë, po nuk i bëra për të mos u dukur i patak.

Me të dalë nga nevojtoret në dritën e barit m'u lëbyrën sytë. Të gjithë flisnin me të bërtitura. Disa këndonin duke ndjekur melodinë e të verbrit, një bolero ose e tillë m'u duk, që bënte fjalë për një dashuri të trishtuar, një dashuri që vitet nuk e kishin fashitur dot, edhe pse ishte bërë më e padenjë, më e pafisme, më mizore. Lima dhe Belanoja kishin nga tre libra secili dhe dukeshin studentë si unë. Para se të dilnim, u afruam te banaku, sup më sup, kërkuam tri tekila që i rrëkëllyem me një të hedhur, pastaj, duke qeshur, dolëm në rrugë. Kur e lamë *Kryqëzimin Veracruzana*, ktheva kokën dhe shikova për herë të fundit, me shpresë të shihja Brixhidën te dera e magazinës, por nuk e pashë.

Librat që kishte me vete Ulises Lima ishin:

*Manifeste électrique aux paupiers de jupes*, i Mishel Bultosë<sup>9</sup>, Matjë Mesazherit, Zhan-Zhak Fososë, Zhan- Zhak Ngyje Tatit, Zhill Bert-Ram-Sutrenomit F. M. midis poetëve të tjerë të Lëvizjes Elektrike, kolegët tanë francezë (hamendësoj).

---

<sup>9</sup> Michel Bulteau (1949) - poet, eseist, muzikant dhe kineast francez, i cili së bashku me poetë të tjerë francezë si Matthieu Messagier, Jean-Jacques Faussot, Jean-Jacques Nguyen That, Gyl Bert-Ram-Soutrenom F. M., më 1971 publikoi *Manifest elektrik me qepalla prej funde erash*, një manifest letrar që shkaktoi tronditje në botën letrare.

*Sang de satin*, i Mishel Bultosë.

*Nord d'été naitre opaque*, i Matjé Mesazherit.

Librat që kishte Artur Belanoja ishin:

*Le parfait criminel*, i Alen Zhufruasë<sup>10</sup>.

*Le pays ou tout est permis*, i Sofi Podolskit<sup>11</sup>.

*Cent mille milliards de poèmes*, i Rajmon Kenosë<sup>12</sup>. (Ky i fundit ishte i fotokopjuar dhe prerjet horizontale, që e tregonin fotokopjen më të prishur se një libër i keqpërdorur tej mase, e bënë të dukej si një lloj luleje e çuditshme prej letre, me petale të kërleshura drejt katër pikave të horizontit.)

Më vonë u takuam me Ernesto San Epifanion, i cili po ashtu kishte me vete tre libra. I thashë të më linte t'i shikojta. Ishin këto:

*Little Johnny's Confession*, i Braian Patenit<sup>13</sup>.

*Tonight at Noon*, i Adrian Henrit<sup>14</sup>.

*The Lost Fire Brigade*, i Spajk Hokinsit<sup>15</sup>.

## 11 nëntor

Ulises Lima jeton në një baxhë në rrugën *Anáhuac* pranë sheshit të *Kryengritësve*. Dhoma është e vogël, tre me dy e gjysmë, dhe librat janë përg gjithandej. Nga e vetmja dritare, si një vrimë e madhe, duken baxhat fqinje, ku, sipas Ulises Limës, Monsivaisi<sup>16</sup> thotë se bëhen ende sakrificat njerëzore. Në dhomë ka vetëm një dyshek të shtruar përtokë, të cilin Lima e palos çdo ditë ose kur ka vizita e përdor si sofa; gjithashtu ka një tavolinë të vockël, sipërfaqen e së cilës e zë të gjithën makina e tij e shkrimit; ka dhe një karrige. Sigurisht, vizitorët duhet të ulen në dyshek, në dysheme, ose të rrinë në këmbë. Sot ishim pesë: Lima, Belanoja, Rafael Barrios, Hasinto

---

<sup>10</sup> Alain Jouffroy (1928) – shkrimtar francez.

<sup>11</sup> Sophie Podolski (1953–1974) – poete belge.

<sup>12</sup> Raymond Queneau (1903–1976) – poet dhe romancier francez.

<sup>13</sup> Brian Patten, (1946) – poet anglez.

<sup>14</sup> Adrián Henri, (1932–2000) – poet anglez.

<sup>15</sup> Spike Hawkins, (1943) – poet britanik.

<sup>16</sup> Carlos Monsiváis (1938–2010) – shkrimtar dhe gazetar meksikan.

Rekena dhe unë. Karrigen e zuri Belanoja, dyshekun Barriosi dhe Rekena, Lima ndenji në këmbë tërë kohën (herë pas here lëvizte nëpër dhomën e vet), ndërsa unë u ula në dysHEME.

Folëm për poezinë. Asnjëri nuk ka lexuar asnjë poezi timen e megjithatë më quajnë si një real-viseralist më shumë. Shoqëria është spontane dhe e shkëlqyer!

Aty nga ora nëntë e darkës, u duk Felipe Myler, që është tetëmbëdhjetë vjeç, prandaj, para se të hyja unë, ishte më i riu në grup. Pastaj dolëm të gjithë për të darkuar në një kafe kineze dhe ndenjëm deri në tre të mëngjesit, duke shëtitur e duke folur për letërsinë. Të gjithë ishim plotësisht në një mendje se poezia meksikane duhej të ndryshonte. Situata jonë (siç m'u duk se dëgjova) është e lëkundur midis perandorisë së Oktavio Pazit dhe perandorisë së Pablo Nerudës. Domethënë: midis shpatës dhe murit.

I pyeta se ku mund t'i blija librat që ata kishin pasur me vete natën e kaluar. Përgjigja nuk më habiti: i vidhnin te Libraria Franceze në *Zona Rosa* dhe te *Libraria Baudelaire* në rrugën *General Martínez*, pranë rrugës *Horacio*, në *La Polanco*. Po ashtu desha të di diçka rreth autorëve e mes tyre (ajo që lexon një real-viseralist lexohet menjëherë prej të tjerëve) më treguan për jetën dhe veprën e *elektrikëve*, domethënë të Rajmon Kënosë, të Sofi Podolskit, të Alen Zhufruasë.

Felipe Myler më pyeti, mbase pak si me kunj, nëse dija frëngjisht. Iu përgjigja se me një fjalor mund t'ia nisja. Më vonë i bëra të njëjtën pyetje. Shoku, ti e di mirë frëngjishten? Përgjigja e tij qe negative.

## 12 nëntor

Në kafe *Quito* takohem me Hasinto Rekenën, Rafael Barriosit dhe Panço Rodriguesin. Rreth orës nëntë të mbrëmjes i pashë të hyjnë në lokal dhe u bëra shenjë që nga tavolina ime, ku për nja tri orë të mira po përfitoja nga vetmia për të shkruar e për të lexuar. Më prezantuan Panço Rodriguesin. Është po aq i shkurtër sa Barriosi, por ka fytyrën e një fëmije dymbëdhjetëvjeçar, megjithëse në të vërtetë është njëzet e dy. Pothuaj nga e keqja u pëlqyem. Panço Rodriguesit nuk i pushonte goja. Falë tij mora vesh se para mbërritjes



së Belanos dhe Mylerit (ata kishin ardhur në Meksiko pas grushtit të shtetit të Pinoçetit, prandaj ishin të huaj për grupin zanafillës), Ulises Lima kishte nxjerrë një revistë me poema të Maria Fontit, të Angjelika Fontit, të Laura Damianit, të Barrios, të San Epifanios, të njëfarë Marselo Robles (për të cilin nuk kisha dëgjuar të flitej) dhe të vëllezërve Rodrigues, Panço dhe Moktezuma. Sipas Panços, një nga dy poetët e rinj më të mirë meksikanë na ishte ai vetë, tjetri qenkej Ulises Lima, të cilin e deklaroi mikun e tij më të mirë. Revista (dy numra, të dy të vitit 1974) quhej *Lee Harvey Oswald*<sup>17</sup> dhe e kishte financuar tërësisht Lima. Rekena (i cili ende nuk i përkiste grupit) dhe Barriosi vërtetonin fjalët e Panço Rodriguesit. Atje qëndronte fara e realizmit viseral, thotë Barrios. Panço Rodriguesi nuk është në një mendje me të. Sipas tij, *Lee Harvey Oswald* duhej të vazhdonte, e prenë pikërisht në momentin më të mirë, kur njerëzit filluan të na njihnin, thotë ai. Ç'njerëz? E qartë pra, poetët e tjerë, studentët e Filozofisë dhe Letërsisë, çunakët që shkruanin poezi dhe që u drejttoheshin çdo javë njëqind studiove të përhapura si lule nëpër Meksiko. Barriosi dhe Rekena nuk janë dakord, edhe pse flasin me nostalgji për revistën.

- Ka shumë poetesha?

- T'u thuash poetesha është një çikë me të futur, - tha Pançoja.

- Thuhet poete, - tha Barriosi.

- Mirë, por a ka shumë?

- Si asnjëherë më parë në historinë e Meksikës, - tha Pançoja. - Hidh një hap dhe do të takosh një çupkë duke shkruar për gjërat e veta.

- Po si munda Lima të financojë vetëm *Lee Harvey Oswald*? - pyeta unë.

E pashë të arsyeshme të mos vazhdoja për momentin me temën e poeteshave.

- Ah, poeti Garsia Madero, një tip si Ulises Lima është i zoti të bëjë gjithçka për poezinë, - tha Barriosi ëndërrueshëm.

Pastaj folëm për emrin e revistës që mua m'u duk genial.

---

<sup>17</sup> Lee Harvey Oswald (1939-1963) – amerikani që u akuzua për vrasjen e presidentit Xhon Kenedi.

- Të shohim nëse e kam kuptuar. Poetët, sipas Ulises Limës, janë si *Lee Harvey Oswald*-i. Kjo është domethënia?

- Pak a shumë, - tha Panço Rodriguesi. - Unë sugjerova ta quanim *Bastardët e Sor Huana*, që tingëllon më meksikane, por shoku ynë vdes për historitë e gringove<sup>18</sup>.

- Në të vërtetë Ulisesi besonte se ekzistonte një shtëpi botuese e quajtur ashtu, por gabonte dhe kur e kuptoi gabimin e tij vendosi t'i vërë atë emër revistës së tij, - tha Barriosi.

- Ç'ishte ajo shtëpi botuese?

- P. J. Oswald, në Paris, që botoi librin e Matjé Mesazherit.

- Dhe palloshi Ulises mendonte se shtëpia botuese franceze quhej Oswald nga vrasësi. Por ajo ishte P-ë J-ë Oswald dhe jo E H-ë Oswald dhe një ditë, kur e mori vesh, vendosi ta përvetësojë emrin.

- Emri francez duhet të jetë Pier Zhak (Pierre-Jacques), - tha Rekena.

- Ose Pol-Zhan Oswald (Paul-Jean Oswald).

- Familja e tij ka para? - pyeta unë.

- Jo, familja e Ulisesit nuk ka para, - tha Rekena. - Në të vërtetë familja e tij është nëna e tij, kështu më duket. Të paktën unë nuk njoh tjetër njeri nga të tijtë.

- Unë ia njoh të gjithë familjen, - tha Pançoja. - E kam njohur Ulises Limën shumë më përpara nga të gjithë ju, shumë më përpara nga Belanoja, dhe mamaja e tij është e gjithë familja e tij. Dhe ju siguroj se nuk ka para.

- Po si mundi të financojë dy numra të një reviste?

- Duke shitur drogë, - tha Pançoja. Dy të tjerët heshtën, por nuk e përgënjeshtroan.

- Nuk më besohet, - thashë.

- Po ashtu është. Paraja vjen nga marijuana.

- T'ëmën.

- Shkonte e gjente në Akapulko dhe pastaj ua shpërndante klientëve të tij në Meksiko.

- Mbylle gojën, Panço, - tha Barriosi.

---

<sup>18</sup> Gringo (ose janki) - kështu u thonë me tallje qytetarëve të SHBA-së në Meksikë e përgjithësisht në Amerikën Latine.

- Pse ta mbyll gojën? Mos vallë ky çunak nuk është si ne, morr *real-viseralist*? Pse do ta mbyll, pra?

### 13 nëntor

Sot kam qenë me Limën dhe Belanon tërë ditën. Shëtitëm, udhëtuam me metro, me autobus, me një mikrobus, ecëm përsëri në këmbë dhe gjatë gjithë kohës nuk pushuam së foluri. Herë pas here ata ndaleshin dhe hynin në shtëpi private, unë atëherë duhet të qëndroja në rrugë për t'i pritur. Kur i pyeta se ç'bënin në ato shtëpi më thanë se kryenin një hetim. Po mua m'u duk se ndanin marijuanë nëpër banesa. Gjatë udhëtimit ua lexova poezitë e fundit që kisha shkruar, njëmbëdhjetë ose dymbëdhjetë, dhe besoj se u pëlqyen.

### 14 nëntor

Sot shkova me Panço Rodriguesin te shtëpia e motrave Fonti.

Kisha nja katër orë që rrija te kafe Kito, ku kisha pirë tri kafe me qumësht dhe entuziazmi im për të lexuar e shkruar kishte filluar të mekej, kur ia behu Pançoja dhe më tha që ta shoqëroja. Pranova me kënaqësi.

Motrat Fonti banonin në lagjen *Condesa*, në një shtëpi të bukur dhe elegante me dy kate dhe me oborr mbrapa nga rruga *Colima*.

Kopshti nuk është kushedi çfarë, ka nja dy pemë rakitike dhe bari është korrur shkel e shko, por oborri mbrapa është tjetër gjë: pemët aty janë të mëdha, ka bimë pa masë, me gjethe në një të blertë aq të thellë sa duken gati të zeza, një pishinë mbuluar me dredhëza (në pishinë, nuk guxoj ta quaj shatërvan, nuk ka peshq, por ka një nëndetëse govate, pronë e Horhito Fontit, vëllait të vogël të tyre) dhe një shtëpizë tërësisht të pavarur nga shtëpia e madhe që, me sa duket, dikur është përdorur shpesh si garazh ose si stallë dhe që tani e kanë të dy motrat Fonti.

Para se të mbërrinim Pançoja, më kishte paralajmëruar:

- Babai i Angjelicës është një çikë i mangët. Po të shikosh ndonjë gjë të pazakontë, mos e prish terezinë, ti bëj atë që do të bëj unë, edhe sikur të jetë diçka e papritur. Nëse bëhet i paduruar, nuk ia varim dhe mbaroi.

- Të mos ia varim? – pyeta pa ditur mirë për çfarë ishte fjala. – Ne të dy? Në shtëpinë e tij?

- Gruaja e tij do të na falënderonte shumë. Ai tip është bythë turtulli. Bëri pothuaj një vit që e kaloi një periudhë kohe në një hotel beqarësh. Por këtë mos ua thuaj motrave Fonti, të paktën mos u thuaj që të thashë unë.

- Domethënë që ky tip qenka i marrë? – thashë unë

- I marrë dhe e ka marrë lumi. Para pak kohësh kishin dy vetura, tri shërbëtore dhe organizonin festa me të madhe. Por kushedi ç'qark të shkurtër pësoi dhe mbeti çyryk. Tani ka marrë fund me të gjitha.

- Ama, për të mbajtur këtë shtëpi duhen para.

- Është vetjake dhe e vetmja që u ka mbetur.

- Me se merrej zoti Fonti para se të luante mendsh? – e pyeta.

- Ishte arkitekt, po tepër i keq. Qe ai që lidhi të dy numrat e *Lee Harvey Oswald*.

- Pa shiko!

Kur i ramë ziles, doli për të na hapur derën një tullac, me mustaqe dhe me pamje të shastisur.

- Është babai i Angjelicës, – më pëshpëriti Pançoja.

- E mora me mend, – thashë.

Tipi u afrua te porta e rrugës me hapa të gjatë, na nguli një vështrim që transmetonte urrejtje aq të koncentruar sa unë u gëzova që ndodhesha matanë gardhit të hekurt. Pas disa sekondave mëdyshjeje, sikur nuk dinte ç'të bënte, hapi portën dhe u hodh drejt nesh. Unë u hodha mbrapa, ndërsa Pançoja i shtriu krahun duke e përshëndetur ngrohtësisht. Atëherë, burri u ndal dhe nderi një dorë të pasigurt, para se të na lironte rrugën.

Pançoja nxitoi të ecte drejt pjesës së pasme të shtëpisë dhe unë pas tij. I ati i motrave Fonti u fut prapë në shtëpinë e madhe, duke folur me vete. Ne u futëm thellë nëpër një rruginë plot me lule që lidhte kopshtin përpara me oborrin mbrapa. Pançoja më shpjegoi se

njëri nga motivet e angështimit të të shkretit zotit Fonti ishte vajza e tij Angjelika:

- Maria tashmë e ka humbur virgjërinë, – tha Pançoja, - por Angjelika ende jo, megjithëse është gati. Këtë e di plaku dhe kjo e çmend.

- Si e di?

- Mendoj se është një mister atëror. Çështja është se e kalon tërë ditën duke menduar se cili do të jetë ai kodosh që do t'i zhvirgjërojë të bijën dhe kjo është gjë e rëndë për një burrë të vetmuar. Unë e kuptoj thellësisht. Po të isha në vend të tij, do të ndodhte e njëjta gjë.

- Por mendon për dikë, apo dyshon te të gjithë?

- Sigurisht, dyshon te të gjithë, megjithëse janë dy a tre që i përjashton: pederastët dhe motra e saj. Plaku nuk është budalla.

Nuk mora vesh asgjë.

- Vitin e kaluar Angjelika fitoi çmimin “Laura Damian” për poezi. Të kujtohet? Dhe ishte vetëm tetëmbëdhjetë vjeçe.

Në jetën time kisha dëgjuar të flitej për këtë çmim. Siç më tregoi Pançoja më vonë, Laura Damian kishte qenë një poeteshë e cila kishte vdekur para se të mbushte njëzet vjeç, më 1972, dhe prindërit e saj kishin krijuar çmimin në kujtim të saj. Sipas Panços çmimi “Laura Damian” ishte një nga më të vlefshmit për njerëz *të veçantë* të Meksikos. E pashë sikur doja ta pyesja me sy çfarë tipi idioti je ti, por Pançoja, ashtu siç prisja, nuk e mori vesh ku rrihte çekani. Pastaj e ngrita vështrimin lart dhe m'u duk se pashë një perde që lëvizte në një nga dritaret e katit të dytë. Ndoshta që vetëm një rrymë ajri, por vazhdova të ndihem i vëzhguar derisa kapërceva pragun e shtëpizës së motrave Fonti.

Atje ishte vetëm Maria.

Maria është e gjatë, zeshkane, me flokë të zinj të lëmuar, me hundë të drejtë (përsosmërisht të drejtë) dhe me buzë të holla. Duket me një karakter të mirë, megjithëse nuk është vështirë të parashikosh se zemërimet e saj mund të jenë të zgjatura e të tmerrshme. E gjetëm në këmbë në mes të dhomës, duke ushtruar hapa vallëzimi, duke lexuar Sor Huana Ines de la Krus<sup>19</sup>, duke

---

<sup>19</sup> Sor Juana Inés de la Cruz (1651 – 1695) – shkrimtare meksikane.

dëgjuar një disk të Billi Hollidei<sup>20</sup> dhe duke pikturuar, me pamje të përhumur, një akuarel, ku duken dy gra me duar të gërshetuara në këmbët e një vullkani të rrethuar nga rrëketë e llavës. Në fillim pritja e saj është e ftohtë, sikur prania e Panços ta mërzhiste, por po e toleronte për respekt të së motrës dhe se, hakçe, kjo shtëpizë nuk është vetëm e saj, por e të dyjave. Mua as që m'i hodhi sytë.

Kulmi ishte kur i lejova vetes t'i bëj një vërejtje ca si banale rreth Sor Huanas, gjë që e bëri të jetë edhe më shumë kundër meje (një ndeshtrashë aspak e përshtatshme mbi vargjet tepër të famshme: *Ju të marrë që akuzoni / femrën pa të drejtë, / pa ditur se ju vetë / jeni shkak për çka fajësoni* dhe që pastaj u përpoqa më kot ta rregulloja duke recituar të tjera: *Ndal, terrin nga e mira ime largoj / imazhi i vendit që aq shumë dua / ëndërr e bukur kush gëzton më vdes mua / trill i ëmbël për atë që vuan rroj*).

Kështu pra, papritur, u ndodhëm atje të tre, të kredhur në një qetësi të druajtur e të zymtë, varet, ndërsa Maria Fonti as që na shikonte, edhe pse unë nganjëherë e shikoja atë apo akuarelin e saj (ose më mirë të them shihja fshehtas, me bisht të syrit, atë dhe akuarelin e saj). Kurse Panço Rodriguesi, i cili as që donte të dinte fare për mërinë e Maries dhe të babait të saj, shikonte librat duke vërshëlyer një melodi që me ç'munda të dëgjoj nuk kishte të bënte fare me atë që po këndonte Billie Hollidei. Dhe më në fund u duk Angjelika. Atëherë e kuptova Pançon (a thua se mëtonte për të zhvirgjëruar Angjelicën?!), e kuptova edhe babanë e motrave Fonti, megjithëse për mua, duhet ta pranoj ndershmërisht, virgjëria nuk ka kurrfarë rëndësie (pa shkuar shumë larg, unë vetë jam i virgjër. Atë thithjen e ndërprerë të Brixhidës nuk do ta konsideroja si një zhvirgjërim. Mos vallë kjo është të bësh dashuri me një femër? Mos duhej që, në të njëjtën kohë, edhe unë t'ia kisha lëpirë asaj seksin për ta quajtur se vërtet bëme dashuri? Pse një mashkull që të prishë virgjërinë u dashka ta fus karin e tij në vaginën e një femre dhe jo në gojën, bythën apo sjetullën e saj? Pse për të quajtur se vërtet kam bërë dashuri u dashka paraprakisht t'ia derdh brenda? E gjithë kjo është një gjë e ngatërruar).

---

<sup>20</sup> Billie Holiday (Eleanora Fagan Gough, 1915-1959) - këngëtare xhazi amerikano-veriore.

Por të kthehem ku e lamë. U duk Angjelika dhe nga mënyra si e përshëndeti Pançon ishte e qartë, të paktën për mua, se ky kishte ca lidhje sentimentale me poeteshën e lauruar. U përshëndeta me të fluturimthi dhe mbeta prapë mënjanë.

Pançoja dhe Angjelika shpalosën një perde që ndante dhomën në dy pjesë, pastaj u ulën mbi krevat dhe nuk i dëgjova të bisedonin më, veç të çuçurisnin.

Iu afrova Maries dhe bëra ca vërejtje mbi cilësinë e akuarelit të saj. Zgjodha një taktikë tjetër: fola për realizmin viseral, për Ulises Liman dhe për Artur Belanon. Po ashtu, e konsiderova (burri burrit: çuçuritjet në anën tjetër të perdes sa vinte e më bënin më nervoz) akuarelin që kisha përpara syve si një vepër real-viseraliste. Maria Fonti më shikoi për herë të parë dhe vuri buzën në gaz:

- Nuk më interesojnë hiç real-viseralistët.

- Po unë mendova se ti bën pjesë në grupin e tyre, desha të them në atë lëvizje.

- Gjallë në botë... Të paktën të kishin kërkuar një emër më pak të neveritshëm... Jam vegetariane. Çdo gjë që më kujton rropullitë më bën të vjell.

- Ç'emër do t'i vije ti?

- Oh, nuk e di. Ndoshta Seksioni Surrealist Meksikan.

- Më duket se tashmë ekziston një Seksion Surrealist Meksikan në Kernavaka. Veç kësaj ne pretendojmë të krijojmë një lëvizje në shkallë latinoamerikane.

- Në shkallë latinoamerikane? Mos më bëj të qesh.

- E po mirë, nëse e kam kuptuar mirë, ajo që duam është për një afat të gjatë.

- Po ti, nga dole?

- Unë jam miku i Limas dhe Belanos.

- Si është e mundur që nuk të kam parë asnjëherë këtej?

- Puna është se pak kohë kam që i kam njohur...

- Ti, mos je ai djaloshi i studios së Alamos?

Në të vërtetë, pa ditur pse, u skuqa. Pranova se atje u njohëm.

- Pra, tashmë, ekzistua një Seksion Surrealist Meksikan në Kernavaka, – tha Maria mendueshëm. – Mbase do të ishte mirë të shkoja e të jetoja në Kernavaka.

- E kam lexuar në Excelsior. Janë ca plakushë që i janë kushtuar pikturës. Besoj, një grup turistësh.

- Në Kernavaka jeton Leonora Karrington<sup>21</sup>, – tha Maria. – Për atë e ke fjalën?

- Jo, jo, – thashë. – Nuk e kam idenë se kush është Leonora Karrington.

Ndërkohë dëgjuam një rënkim. E kuptova menjëherë se nuk ishte nga kënaqësia, por nga dhimbja. Atëherë më ra ndër mend se kishte çaste që nuk kisha dëgjuar gjë nga ana tjetër e perdes.

- Je mirë, Angelika? – foli Maria.

- Sigurisht që jam mirë. Të lutem, dil e bëj një xhiro, merre me vete edhe atë tipin, – u përgjigj Angelika me një zë të mbytur.

Me një gjest pakënaqësie dhe neverie Maria hodhi penelat në tokë. Nga njoilat e bojës në pllakat e dyshemesë kuptova se nuk ishte hera e parë që e motra i kërkonte një çikë më shumë intimitet.

- Eja me mua.

Shkova pas saj deri te një qoshe e mënjanuar e oborrit, pranë një muri të lartë mbuluar me dredhëza, ku kishte një tavolinë dhe pesë karrige metalike.

- Ti mendon se janë duke...? – thashë dhe, aty për aty, u pendova që kureshtjen time desha ta ndaj me të.

Për fat Maria ishte tepër e mërzhitur dhe as që ma mori për keq.

- Duke u qirë? Jo, as mos të të shkojë në mendje.

Për një çast qëndruam të heshtur. Maria trokëllinte me gishta mbi sipërfaqen e tavolinës dhe unë, pasi kryqëzova këmbët nja dy herë, u vura të hulumtoj florën e oborrit.

- E po, çfarë pret, lexomë poezitë e tua, – tha.

Lexova e lexova derisa m'u mpi njëra këmbë. Dhe në fund nuk guxova ta pyes nëse i kishin pëlqyer apo jo. Pastaj Maria më ftoi për kafe te shtëpia e madhe.

Në kuzhinë gjetëm të atin dhe të ëmën duke gatuar. Që të dy dukeshin të lumtur. M'i prezantoi. I ati nuk e kishte më atë pamjen e shastisur dhe u tregua shumë i përzemërt me mua; pyeti për çfarë

---

<sup>21</sup> Leonora Karrington (1917-2011) – piktoresh surrealistike dhe shkrimtare meksikane me origjinë angleze.



studioja, nëse mund të harmonizoheshin ligjet me poezinë, a ishte mirë Alamoja (me sa duket njiheshin ose në rininë e tyre kishin qenë miq). E ëma foli për gjëra kot sa mezi i kujtoj: besoj se përmendi një sesion spiritizmi në *Coyoacán*, ku kishte qenë para pak kohësh dhe për shpirtin e një këngëtare raçerash të viteve dyzet. Nuk e mora vesh nëse e kishte me gjithë mend apo bënte shaka.

Pranë televizorit rrinte Horhito Fonti, të cilit Maria nuk i foli fare dhe as e prezantoi me mua. Është dymbëdhjetë vjeç, flokëgjatë dhe me pamje lypësi. Të gjithëve u drejtohej me nofkën *nako*. I thoshte së ëmës, shiko, *naka*, nuk dua ta bëj këtë, të atit, dëgjo, *nako*, të motrës, *naka* ime e mirë, pacientja ime *naka*, dhe mua më tha ç’kemi, *nako*.

*Nako-t*, me sa di unë, janë indianët qytetas, indianët qytetarë, por mbase Horhitoja e thoshte me tjetër kuptim.

## 15 nëntor

Sot, përsëri te shtëpia e motrave Fonti.

Gjërat, me pak ndryshim, janë njësoj si dje.

Pançoja dhe unë u takuam te kafja kineze *El Loto de Quintana Roo*, pranë sheshit të *Kryengritësve*, dhe pasi morëm disa kafe me qumësht dhe disa gjëra më të forta (që i pagova unë), u nisëm drejt lagjes Kontesha.

Përsëri zoti Fonti iu drejtua alarmit të ziles dhe gjendja e tij nuk dallohej fare nga dje, përkundrazi ecte me hapa të mëdhenj në rrugën e çmendurisë. Sytë thua se do t’i dilnin nga vendi, kur kapi dorën rioshe që Pançoja, i patrembur, ia zgjati; mua nuk më dha asnjë shenjë njohjeje.

Në shtëpizën e oborrit ishte vetëm Maria: pikturonte të njëjtin akuarel të djeshëm dhe në dorën e majtë mbante të njëjtin libër të djeshëm, por në gramafon dëgjohej zëri i Olga Gijotit<sup>22</sup> dhe jo ai i Billie Hollideit.

Përsëritja e saj qe njësoj si dje e ftohtë.

---

<sup>22</sup> Olga Guillot (1922–2010) – këngëtare e famshme kubane.

Pançoja, nga ana e tij, përsëriti rutinën e një dite më parë dhe zuri vend në një karrige xunkthi, ndërsa priste ardhjen e Angelikës.

Kësaj radhe isha i kujdesshëm në guximin për të shprehur çdo gjykim mbi Sor Huanën dhe së pari iu kushtova hulumtimit të librave e pastaj, në krah të Maries, por duke mbajtur një distancë të arsyeshme, vrojtoja akuarelin që kishte pësuar ndryshime të rëndësishme. Të dy gratë në brinjë të vullkanit, që të kujtonin një akt solemn, të paktën serioz, tani pickonin krahët e njëra-tjetrës; njëra prej tyre qeshte apo bënte sikur qeshte; tjetra qante ose bënte sikur qante; në rrëketë e llavës (ato vazhdonin të ishin të kuqe apo ngjyrë gjaku) notonin kuti sapuni për makina larëse, kukulla shogane dhe shporta xunkthi, plot me minj; fustanet e grave ishin të grisura dhe tregonin pjesë të lëkurës; në qiell (ose të paktën në pjesën e sipërme të akuarelit) po përgatitej furtuna; në pjesën e poshtme Maria kishte kopjuar pjesën meteorologjike të ditës për Meksikon.

Kuadri ishte i frikshëm.

Pastaj erdhi Angelika, rrezatuese, dhe ajo e Pançoja përsëri u mbyllën në të ndarën e saj. Ndërsa Maria pikturonte, unë për një çast mbeta i menduar: tashmë nuk kisha dyshimin më të vogël se Pançoja më zvarriste deri te shtëpia e motrave Fonti që të kaloja kohën me Marien, ndërkohë që ai dhe Angelika t'i kushtoheshin çështjes së tyre. Nuk m'u duk shumë e drejtë. Më përpara, në kafen kineze, e pyeta se ç'mendonte për një real-viseralist. Përgjigjja e tij ishte e gjatë dhe e paqartë. Foli për klasën punëtore, për drogën, për Flores Magonë, për disa figura të shquara të Revolucionit Meksikan. Pastaj tha se sigurisht poezitë e tij do të dilnin në revistën që do të nxirrnin së afërmi Lima dhe Belanoja. Dhe tha se, po të mos ia botonin, le të shkonin në piçkë të s'ëmës. Nuk e di pse, por kam përshtypjen se e vetmja gjë që i intereson Panços është të bëjë seks me Angelikën.

- Je mirë, Angelika? - pyet Maria, kur filluan, tamam si dje, rënkimet nga dhimbja.

- Po, po, mirë jam. Pse nuk dilni një xhiro?

- Patjetër, - tha Maria.

Përsëri, duke iu nënshtruar fatit, shkuam e u ulëm te tavolina metalike, nën dredhëz. Pa ndonjë shkak të dukshëm, zemra më ishte bërë copë. Maria nisi të më tregonte historitë e fëmijërisë së saj dhe të Angjelicës, ca histori tepër të mërztitshme që dukej se i tregonte vetëm për të vrarë kohën dhe që unë hiqesha sikur i dëgjoja me interes. Shkolla, festat e para, matura, dashuria e të dyjave për poezinë, dëshira për të udhëtuar, për të njohur vende të tjera, *Lee Harvey Oswald*, ku të dyja botuan, çmimi “Laura Damian” që mori Angjelika... Me të mbërritur në këtë pikë, nuk di pse, ndoshta sepse Maria heshti për një moment, desha të dija se kush kishte qenë Laura Damiani. Ishte thjesht një intuitë. Maria tha:

- Një poete që vdiq shumë e re.
- Këtë e di. Njëzet vjeçe. Por cila ishte? Si mundet që s’kam lexuar asgjë nga ajo?
- E ke lexuar Lotreamonin, Garsia Madero? – pyeti ajo.
- Jo.
- E po, atëherë është normale që nuk di asgjë për Laura Damianin.
- Më fal, e di që jam injorant.
- Nuk desha të them këtë. Vetëm se je shumë i ri. Veç kësaj i vetmi libër i botuar i Laurës, *Kroi i muzave*, është një botim jo i shitur. Është një libër postum, i financuar nga prindërit e saj që e donin shumë dhe që ishin të parët lexues të saj.
- Duhet të kenë para shumë.
- Pse e beson këtë?
- Në qoftë se janë të zotët të nxjerrin nga xhepi i tyre një çmim vjetor për poezinë, duhet të kenë shumë para.
- Mirë, po mos e ekzagjero. Angjelicës nuk i dhanë shumë para. Në të vërtetë rëndësia e çmimit është më tepër prestigj se sa ekonomi. As prestigji nuk duhet tepruar. Ki parasysh se është një çmim që jepet vetëm për poetët minorë, njëzetvjeçarë.
- Moshë që kishte Laura Damiani kur vdiq. Ç’gjë anormale!
- Nuk është anormale, është e trishtueshme.
- A ishte ti në dorëzimin e çmimit?
- Sigurisht.
- Ku? Në shtëpinë e saj?

- Jo, në Fakultet.  
- Në ç'fakultet?  
- Tek ai i Filozofisë dhe Letërsisë. Atje studionte Laura.  
- Dreqi ta marrë. Sa anormale!  
- Unë nuk shikoj anomali këtu. Më duket se i vetmi anormal je ti, Garsia Madero.

- E di çfarë? Më mërzit kur më thua Garsia Madero. Është njësoj si të të them unë ty Fonti.

- Të gjithë ashtu të thonë, nuk kuptoj pse unë të të drejtohem ndryshe.

- E po mirë, njësoj është, tregomë ndonjë gjë tjetër për Laura Damianin. Ti nuk je paraqitur kurrë për çmim?

- Po, por fitoi Angjelika.

- Po përpara Angjelicës kush fitoi?

- Një gocë nga Aguaskalientes që studionte për mjekësi në UNAM.

- Po më përpara?

- Më përpara nuk fitoi askush, sepse çmimi nuk ekzistonte. Vitin që vjen mund të paraqitem prapë, ndoshta dhe jo.

- E ç'do të bësh me paratë, po fitove?

- Me siguri, do të shkoj në Europë.

Për disa sekonda të dy qëndruam në heshtje. Maria Fonti duke menduar për vendet e panjohura dhe unë duke menduar për gjithë të panjohurit që kishin bërë dashuri pa mëshirë me të. Kur erdha në vete, u hodha përpjetë. Mos vallë kisha rënë në dashuri me Marien?

- Si vdiq Laura Damiani?

- E shtypi një veturë në Tlalpan. Ishte vajzë e vetme, prindërit e saj mbetën të shkretuar, besoj se e ëma tentoi të vriste veten. Duhet të jetë e trishtë të vdesësh aq e re.

- Shumë e trishtë, – thashë duke imagjinuar Maria Fontin në krahët e një anglezi dy metra të gjatë, gati çubardh, që i fuste një gjuhë të gjatë e të kuqe midis buzëve të saj të holla.

- Di ti se kë duhet të pyesësh tjetër për Laura Damianin?

- Jo. Kë?

- Ulises Limën. Ai ka qenë miku i saj.

- Ulises Lima?

- Po. Pothuaj, nuk ndaheshin kurrë, studionin bashkë, shkonin në kinema bashkë, i huanin libra njëri-tjetrit, pra, ishin shumë miq.

- Nuk e dija këtë gjë, – thashë.

Dëgjuam një zhurmë të ardhur nga shtëpiza dhe për një çast të dy qëndruam në pritje.

- Ç'moshë kishte Ulises Lima, kur vdiq Laura Damiani?

Maria u vonua të më përgjigjej.

- Ulises Lima nuk quhet Ulises Lima, – tha me zë të ngjirur.

- Do të thuash se ai është emri i tij letrar?

Maria bëri një shenjë pohimi me kokë, me vështrimin e humbur te format e pleksura të dredhëzës.

- Atëherë, si quhet?

- Alfredo Martines apo diçka e tillë. Tani e kam harruar. Por kur e njoha, nuk quhej Ulises Lima. Laura Damiani ia vuri atë emër.

- Hajde, ç'lajm!

- Të gjithë thoshin se ishte i dashuruar me Laurën. Por unë besoj se kurrë nuk bënë seks. Për mua Laura vdiq e virgjër.

- Njëzet vjeçe e virgjër?

- Sigurisht. Pse jo?

- Mirë, në është e sigurt.

- Vërtet, sa e trishtueshme.

- Po. Është e trishtueshme. Po ç'moshë kishte atëherë Ulises Lima ose Alfredo Martinesi?

- Ca më i vogël, nëntëmbëdhjetë ose tetëmbëdhjetë.

- Besoj se vdekja e Laurës do të ketë qenë një goditje për të.

- U sëmur. Thonë se qe në buzë të vdekjes. Mjekët nuk dinin ç'kishte, vetëm se iku në një lagje tjetër. Unë i shkova në spital për ta parë, ishte i mbaruar fare. Por një ditë u bë mirë dhe aty mbaroi gjithçka, në mënyrë aq misterioze siç kishte filluar. Pastaj Ulisesi e la universitetin dhe themeloi revistën e tij. Ti e njeh revistën. Apo jo?

- *Lee Harvey Oswald*, po, e njoh, – gënjeva. Aty për aty pyeta veten pse kur isha në baxhën e Ulises Limës nuk ma kishin lënë të shihja një numër, qoftë sa për ta shfletuar.

- Emër më i tmerrshëm nuk mund të gjendej për një revistë me poezi.

- Mua më pëlqen. Nuk shoh gjë të keqe.

- Është fare pa shije.  
- Po, ç'emër do t'i kishe vënë ti?  
- Nuk e di. Ndofta Seksioni Surrealist Meksikan.  
- Interessant.  
- E di që im atë e radhiti për shtyp gjithë revistën?  
- Diçka më ka thënë Pançoja.  
- Disenjoja, është gjëja më e mirë e asaj reviste. Tani të gjithë e urrejnë tim atë.

- Të gjithë? Të gjithë real-viseralistët? E pse duhet ta urrejnë? Përkundrazi.

- Jo, jo real-viseralistët, arkitektët e tjerë të studios së tyre. Mendoj se i zileps karizma që ka me të rinjtë. Çështja është se nuk e gëlltisin dot dhe tani po e bëjnë të paguajë. Për punën e revistës.

- Për *Lee Harvey Oswald*?

- Sigurisht, meqenëse im atë e radhiti në studio, tani e bëjnë përgjegjës për çfarë mund të ndodhë.

- E ç'mund të ndodhë?

- Një mijë gjëra. Duket që ti nuk e njeh Ulises Limën

- Jo, nuk e njoh, - thashë, - por sikur e kam një ide.

- Është një minë me sahat, - tha Maria.

Në atë çast vura re se ishte errësuar dhe nuk mund ta shihnim njëri-tjetrin, vetëm e dëgjonim.

- Shiko, duhet të të them diçka: pak më parë të gënjeva. Kurrë nuk më ka rënë në dorë ajo revistë dhe vdes për t'i hedhur një sy. Mund të ma japësh?

- Patjetër që mund të ta dhuroj, kam disa numra.

- Po një libër të Lotreamonit, a mund të ma japësh hua?

- Po. Por atë duhet të ma kthesh patjetër, është një nga poetët e mi më të preferuar.

- Të premtoj.

Maria hyri në shtëpinë e madhe. Mbeta vetëm në oborr dhe për një çast m'u duk gënjeshtër që jashtë të ishte Meksikoja. Pastaj ndjeva zëra në shtëpizën e motrave Fonti dhe pashë të ndizej një dritë. Mendova se ishin Angjelika dhe Pançoja, mendova se pas një çasti Pançoja do të dilte në oborr të më kërkonte, por nuk ndodhi asgjë. Kur u kthye Maria me dy ekzemplarë të revistës dhe me *Këngët*

e *Maldororit*, gjithashtu vuri re se dritat në shtëpizë ishin të ndezura dhe gjatë disa sekondave qëndroi në pritje. Befas, kur nuk e prisja kurrë, më pyeti nëse isha i virgjër apo jo.

- Jo, sigurisht që jo, – gënjeva për herë të dytë atë pasdite.

- A të kushtoi shumë ta humbisje virgjërinë?

- Një çikë, – thashë pasi u mendova një çast për t’u përgjigjur.

Vura re se zëri i saj përsëri ishte i ngjirur.

- Ke të dashur?

- Jo, sigurisht që jo, – thashë.

- Po atëherë me kë e bën? Me ndonjë kurvë?

- Jo, me një vajzë të Sonoras, të cilën e njoha vitin e kaluar, - thashë. – Takohemi çdo tri ditë.

- Dhe nuk e ke bërë më me asnjë tjetër?

Isha gati t’i tregoja aventurën time me Brixhidën, po pastaj vendosa se ishte më mirë të mos e bëja.

- Me asnjë tjetër më, – thashë dhe u ndjeva si mos më keq.

## 16 nëntor

Fola me Marien në telefon. I thashë se doja ta shihja. Iu luta që të takoheshim. E lamë te kafe *Quito*. Sa mbërriti, aty rreth orës shtatë të mbrëmjes, disa tipa nuk po ia ndanin sytë që kur hyri e derisa u ul në tavolinën ku e prisja.

Është e bukur. Ka veshur një bluzë oaksakenjase, bluxhinse të ngjeshura pas trupit dhe sandale lëkure. Në sup mban një çantë të murrme të errët, me kuaj ngjyrë kremi të vizatuar anëve, plot me libra dhe letra.

I kërkova të më lexonte një poezi.

- Mos u bëj i bezdisur, Garsia Madero, – tha ajo.

Nuk e di pse, përgjigjja e saj më dëshpëroi. Besoj se kisha një nevojë fizike të dëgjoja prej buzëve të saj një nga poezitë e veta. Por, mbase nuk ishte mjedis i përshtatshëm: kafe *Quito* është një kazan që zien nga zërat, të bërtiturat e të qeshurat. I ktheva librin e Lotreamonit.

- A e lexove? – tha Maria.

- Sigurisht, – thashë, – mbeta gjithë natën pa gjumë, duke lexuar, gjithashtu lexova edhe *Lee Harvey Oswald*, është një revistë e mrekullueshme, sa keq që nuk del më. Shkrimet e tua më pëlqyen.

- Dhe nuk u shtrive fare në shtrat?

- Deri tani jo, por ndihem mirë, i tejzgjuar.

Maria Fonti më shikoi në sy dhe buzëqeshi. Një kameriere na u afrua dhe na pyeti se ç'do të merrnim. Asgjë, tha Maria, tani po ikim. Në rrugë e pyeta nëse kishte ndonjë gjë për të bërë dhe më tha asgjë, se e vetmja gjë ishte që kafe *Quito* nuk i pëlqente fare. Kaluam nëpër *Bucareli* deri te *Reforma*, e kapërcyem atë dhe u futëm në bulevardin *Guerrero*.

- Kjo është lagjia e kurvave, – tha Maria.

- As që e kam idenë, – thashë unë.

- Futma krahun, nuk dua të më ngatërrojë.

E vërteta është se në fillim nuk vura re asnjë shenjë që ta dalloja atë rrugë për ato që sapo pamë. Trafiku ishte njëlloj i dendur dhe turma që qarkullonte nëpër trotuare nuk dallohej fare nga ajo që gëlonte nëpër *Bucareli*. Por, më vonë (ndoshta i ndikuar nga paralajmërimi i Maries), vura re disa ndryshime. Ndriçimi publik në *Bucareli* është i bardhë, ndërsa në bulevardin *Guerrero* kishte një nuancë qelibari. Makinat: në *Bucareli* ishte gjë e pazakontë të gjeje një veturë të parkuar pranë trotuarit, kurse në *Guerrero* i gjeje me bollëk. Baret dhe kafenetë në *Bucareli* ishin të gjera dhe të ndriçuara, në *Guerrero*, edhe pse me shumicë, ngjanin si të mbyllura në vetvete, pa dritare të mëdha nga rruga, të fshehta apo që nuk binin në sy. Dhe për ta mbyllur, muzika: në *Bucareli* nuk ekzistonte, kishte vetëm zhurmë makinash ose njerëzish, kurse në *Guerrero*, sapo futej njeriu në lokal, sidomos aty ku kryqëzohet *Violeta* me *Magnolia*-n, muzika bëhet sundimtare e vetme e rrugës; është muzika që del nga baret dhe nga makinat e parkuara, muzika që lëshojnë radiot e dorës dhe ajo që vjen nga dritaret e ndriçuara të pallateve me fasada të errëta.

- Më pëlqen kjo rrugë, ndonjë ditë do vij të jetoj këtu, – tha Maria.

Një grup kurvash adoleshente kishin ndalur pranë një Kadillaku të vjetër të parkuar buzë trotuarit. Maria qëndroi dhe përshëndeti njëtrën prej tyre:

- Ç'kemi, Lupe, gëzohem që të shoh.



Lupja ishte tepër e hajthme dhe me flokë të prera shkurt. M'u duk po aq e bukur si Maria.

- Maria! Nga mbive, motra, ua, sa kohë! – tha dhe e përqafoi.

Ato që e shoqëronin Lupen me bythët mbi kofanon e Kadillakut ia ngulën sytë Maries, duke e vrojtuar ngeshëm. Mua pothuaj nuk m'i hodhën sytë fare.

- Kam menduar se kishe vdekur, – tha Maria papritur. Mizoria e pohimit të saj më la pa mend. Të tilla kratere ka delikatesa e Maries.

- Siç e shikon, jam gjallë. Ama, gati ika. Apo jo, Karmensita?

E quajtura Karmensita tha “ixtles”<sup>23</sup> dhe vazhdoi të studionte Marien.

- Ajo që u dorëzua që Gloria. E kishe njohur? Ç'fund i papritur, motra, por atë gërdallë nuk e donte askush.

- Nuk e kam njohur, – tha Maria me një buzagaz të ngrirë.

- E hoqën qafe policët, – tha Karmensita.

- U bë gjë për të? – tha Maria.

- Jo, – tha Karmensita. – Pse? Gërdalla kishte marrë udhën e ujëve me historitë e saj të fshehta. Konsumonte çdo gjë, kështu që ishte e pamundur.

- Sa e trishtueshme, – tha Maria.

- Po ti si shkon me universitetin? – pyeti Lupja.

- Njëfarësoj, – tha Maria.

- Vazhdon të të përgjojë nga ballkoni demi S?

Maria shikoi nga unë dhe qeshi.

- Kjo shoqja ime e ngushtë është balerinë, – u tha Lupja shoqeve të saja. – Jemi njohur në *Danza Moderna*, shkolla që është në *Donceles*.

- Ulu ca se të panë, – tha Karmensita.

- Është e vërtetë, Lupja shkante në Shkollën *Danza Moderna*, – tha Maria.

- Po pse tani është duke bërë këtë me nder punë? – pyeti njëra që deri atëherë nuk e kishte hapur gojën, ishte më e shkurtra nga të gjitha, gati xhuxhe.

Maria e shikoi dhe mblodhi supet.

---

<sup>23</sup> IXTLES – sipas një dialekti të vjetër indigjen në Meksikë, do të thotë “vdekje”.

- Apo vjen me ne për një kafe me qumësht? – i tha Lupes.

Lupja pa orën në kyçin e dorës së djathtë dhe pastaj shikoi nga shoqet e veta.

- Po unë jam në punë.

- Vetëm pak çaste, pastaj kthehu, – tha Maria.

- Në të s'ëmës puna, eja ikim, – tha Lupja dhe iku me Marien.

Unë pas tyre.

U kthyem në të majtë, u futëm në Magnolia e vazhduam deri te bulevardi *Jesús García*. Pastaj u kthyem prapë drejt jugut, deri te *Héroes Revolucionarios Ferrocarrileros*, ku u futëm në një kafe.

- Ky çuni është ai që të vardiset tani? – dëgjova t'i thotë Lupja Maries.

Maria qeshi përsëri.

- Është vetëm një mik, – i tha dhe m'u kthye mua: - Nëse duket këtej ai kodoshi i Lupes, duhet të na mbrosh të djave, Garsia Madero.

Mendova se bënte shaka. Pastaj dyshova nëse e kishte me gjithë mend dhe sinqerisht përfytyrova një situatë të lezetshme. Në ato momente nuk imagjinoja incident tjetër më të mirë për t'u bërë hero në sytë e Maries. U ndjeva i lumtur, kisha gjithë natën në dispozicion.

- Mashkulli im është shtazë, – tha Lupja. – Nuk i pëlqen të shoqërohem me të panjohur. – Ishte hera e parë që fliste duke m'u drejtuar mua.

- Po unë nuk jam një i panjohur, – tha Maria.

- Jo, motra, ti jo.

- E di si e kam njohur Lupen? – më tha Maria.

- Nuk di asgjë, – thashë.

- Në shkollën *Danza Moderna*. Lupja ishte mikesha e Pako Duartes, balerinit spanjoll. Drejtori i shkollës.

- E takoja një herë në javë, – tha Lupja.

- Nuk më besohet që të studioje për valle, – i thashë.

- Jo, unë nuk studioja asgjë, shkoja sa për të thënë, – tha Lupja.

- Nuk e kam fjalën për ty, po për Marien, – thashë.

- Isha katërmbëdhjetë vjeçe, – tha Maria. – Ishte shumë vonë për t'u bërë një balerinë e mirë. Ç't'i bësh.

- Po ti vallëzon shkëlqyer, motra. E paparë, por atje të gjithë janë gjysmëzabërhanë. Ti e ke parë duke kërcyer?

- Jo, – thashë.

- Do të të bëjë për vete, kur ta shohësh.

Maria bëri një gjest mohues me kokë. Kur erdhi kamerierja porositem tri kafe me qumësht, kurse Lupja kërkoi edhe një sanduic me djathë, pa fasule.

- Nuk m'i tret dot stomaku, – shpjegoi ajo.

- Si vazhdon me stomakun? – tha Maria.

- Hiq e mos e këput, nganjëherë më dhëmb shumë, nganjëherë e harroj se ekziston. E kam nervore. Kur nuk e duroj dot, i fut një *prix*<sup>24</sup> dhe çështja zgjidhet. Po nga ti, ç'kemi? Nuk shkon më në shkollën *Danza Moderna*?

- Më pak se më përpara, – tha Maria.

- Kjo budallaçka më zuri mat një herë në zyrën e Pako Duarte, – tha Lupja.

- Gati sa nuk më ra të fikët nga të qeshurit, – tha Maria. – Nuk e di pse më mori një gaz i madh. Edhe unë kisha rënë në dashuri me Pakon, në të vërtetë ishte një goditje historie.

- Ik, moj, tutje. Nuk të besoj, motra, ai frëngaleci nuk ishte tipi yt.

- Po çfarë ishte duke bërë me atë farë Pako Duarte? – thashë unë.

- E po asgjë, kot. E kisha njohur njëherë në bulevard dhe meqë ai nuk vinte dot tek unë, as unë nuk mund të shkoja në shtëpinë e tij, ai ishte i martuar me një gringeshë, kështu që shkoja unë ta takoja në shkollën *Danza Moderna*. Veç kësaj, ajo që i pëlqente më shumë qenit ishte të më qinte në zyrën e tij.

- Po ai kodoshi yt si të linte të bëje pallë aq larg zonës tënde? – i thashë.

- Po ti çunak ku e di se cila është zona ime? Ku e di ti se kam kodosh apo nuk kam kodosh unë?

- Dëgjo, më fal në qoftë se të ofendova, por Maria tha pak më përpara se kodoshi yt është shumë i dhunshëm. A po jo?

- Unë nuk kam ndonjë kodosh, çuno. Ç'pandeh ti se mund të rrish me mua dhe mund të më fyesh kështu?

- Qetësohu, Lupe, nuk po të fyen njeri, – tha Maria.

---

<sup>24</sup> Priksol (prixol) – medikament për qetësimin e ulcerës.

- Ky trapi shau burrin tim, – tha Lupja. – Sikur të dëgjojë ai ç'më thua, të shuan pishën, çunak, të vë poshtë çak-fak. Jam e sigurt se ty do të të pëlqejë kari i mashkullit tim.

- Ej, unë nuk jam homoseksual.

- Të gjithë miqtë e Maries janë pederastë, kjo dihet.

- Lupe, mos u përziej me miqtë e mi. Kur kjo ishte e sëmurë, – m'u drejtua mua, - unë dhe Ernestoja e çuam në një spital që ta kuronin. Po ka njerëz që i harrojnë menjëherë të mirat.

- Ernesto San Epifanio? – thashë unë.

- Po, – tha Maria.

- Edhe ai studionte për valle?

- Edhe ai, – tha Maria.

- Eh, Ernestoja, ç'kujtime të mira kam për të. Më kujtohet se si më ngriti hopa, vetëm, dhe më futi në një taksì. Ernestoja është homo, – më shpjegoi Lupja, - por është i fortë.

- Nuk qe Ernestoja ai që të futi në taksì, trape, isha unë, – tha Maria.

- Atë natë thashë se ika, – tha Lupja. – Isha për bukuri dhe papritur pata marrje mendsh e fillova të vjell gjak. Copa gjaku. Ato çaste, thellë-thellë, nuk doja t'ia dija për vdekjen. Të vetmet gjëra që më erdhën në mendje ishin: im bir, premtimi i thyer dhe Virgjëresha e Guadalupes. E kisha tepruar duke ndenjtur derisa, ngadalë-ngadalë, doli hëna dhe, meqenëse nuk ndihesha mirë, xhuxhja, që pe pak më parë, më dha pak kurajë. Ishin çaste të vështira, çimentua duhet të ishte tërë jargë ose unë isha shumë keq. Në atë kohë, kur rashë e vdekur në një stol te sheshi *San Fernando*, u duk pikërisht shoqja ime dhe miku i saj, pederasti engjëllor.

- Ke një fëmijë, Lupe?

- Im bir vdiq, – tha Lupja duke m'i ngulur sytë.

- Po, sa vjeçe je?

Lupja më buzëqeshi. Buzëqeshja e saj ishte e madhe dhe e bukur.

- Sa thua ti?

Preferova të mos rrezikoj dhe nuk thashë asgjë. Maria i hodhi dorën mbi sup. Të dyja u panë në sy, i buzëqeshën dhe i shkelën syrin njëra-tjetrës. Kështu m'u duk.

- Një vit më e vogël se Maria. Tetëmbëdhjetë.

- Të dyja jemi Luani, – tha Maria.
- Po ti, çfarë shenje je? – pyeti Lupja.
- Nuk e di. Në të vërtetë, kurrë nuk më ka interesuar kjo.
- Atëherë, je i vetmi meksikan që nuk di shenjën e tij, – tha Lupja.
- Në ç'muaj ke lindur, Garsia Madero? – tha Maria.
- Në janar, në gjashtë janar.
- Je Bricjapi, si Ulises Lima.
- I famshmi Ulises Lima? – tha Lupja.

E pyeta nëse e njihte. Pata frikë mos më thoshte se edhe Ulises Lima shkonte në shkollën *Danza Moderna*. Në të qindin fraksion të sekondës e pashë veten time duke vallëzuar në maja të këmbëve në një palestër bosh! Por Lupja tha që e njihte vetëm me të dëgjuar, se Maria dhe Ernesto San Epifanoja flisnin shpesh për të.

Pastaj Lupja zuri të fliste për fëmijën e saj të vdekur. Fëmija ishte katër muajsh kur vdiq. Kishte lindur i sëmurë dhe Lupja i kishte premtuar Virgjëreshës se do ta linte rrugën, në qoftë se biri i saj do të shërohej. Tre muajt e parë e mbajti premtimin dhe fëmija, sipas saj, sikur u përmirësua. Por muajin e katërt iu desh të dilte prapë në rrugë dhe fëmija vdiq. Ma mori Virgjëresha, se e shkela betimin. Asokohe Lupja jetonte në një ndërtesë në rrugën *Paraguai*, pranë sheshit *Santa Katarina*, dhe ia linte fëmijën një plake, e cila kujdesej për të natën. Një mëngjes, kur u kthye, i thanë se i biri kishte vdekur. Dhe kjo qe e gjitha, tha Lupja.

- Nuk është faji yt, mos ji supersticioze, – i tha Maria.
- Si nuk është faji im? Kush nuk e mbajti premtimin? Kush u zotua se do ta linte këtë jetë dhe pastaj nuk e bëri?
- Po pse Virgjëresha nuk të vrau ty, por fëmijën tënd?
- Virgjëresha nuk e vrau të voglin tim, – tha Lupja. – E mori, moj motër, gjë që është krejt ndryshe. Mua më dënoi duke ma hequr, kurse atë e çoi në një jetë më të mirë.
- E po mirë, nëse e shikon ashtu, nuk ka asnjë problem. Apo jo?
- Vërtet, ashtu është zgjidhur gjithçka, – thashë unë. – Po ju, kur jeni njohur, para apo pas fëmijës?
- Pas, – tha Maria, – kur kjo qe bërë tym. Unë besoj se doje të vdisje, apo jo Lupe?

- Po të mos kishte qenë Alberti, do të isha bërë pleh tani, – pëshpëriti Lupja.

- Alberti është i dashuri... yt, besoj, – thashë unë. – E njeh? – pyeta Marien, e cila bëri një gjest pohimi me kokë.

- Është tutori i saj, – tha Maria.

- Por e ka më të madhe sesa mikushi yt, – tha Lupja.

- Vërtet e ka fjalën për mua? – thashë unë.

Maria qeshi.

- Sigurisht, për ty e ka fjalën, budalla.

U bëra flakë i kuq dhe pastaj qesha. Edhe Maria me Lupen qeshën.

- Sa e ka Alberti? – tha Maria.

- Njësoj sa thika e tij.

- E sa është thika e tij? – tha Maria.

- Kaq.

- Mos e ekzagjero, – thashë unë, edhe pse e mira ishte që ta ndërroja bisedën. Duke u përpjekur ta rregulloja gabimin, thashë: – Nuk ka thikë aq të madhe, – dhe e bëra më keq.

- Ah, motër, po si mund të jesh aq e sigurt për atë punën e thikës? – tha Maria.

- Ka pesëmbëdhjetë vjet që e mban atë thikë, ia ka dhuruar një kurvë nga Bondoho, një zhordë që tashmë ka vdekur.

- Po ti, ia ke matur atë gjërin me thikë, apo ia fut kot?

- Një thikë aq e madhe është vërtet e sikletshme, – ngula këmbë unë.

- E mat vetë ai, nuk është nevoja t'ia mat unë, mua mjafton që ma jep, e mat ai vetë dhe e mat gjithnjë, të paktën një herë në ditë thotë se duhet provuar që nuk i është zvogëluar.

- Ka frikë se mos i konsumohet rroçka? – tha Maria.

- Alberti nuk ka frikë nga asgjë, është një mashtrues i zoti që rron në kurriz të tjetrit.

- Atëherë si është ajo puna e thikës? Vërtet, nuk e kuptoj dot, – tha Maria. – Se, rastësisht, edhe mund të pritet. Nuk ka rastisur kurrë kjo?

- Po, ndonjëherë, por qëllimisht. Ai di ta përdorë mirë thikën.

- Do të thuash se tutori yt batakçi nganjëherë i bën prerje karit për qejf? – tha Maria.

- Po, pra.

- Nuk mund ta besoj dot.

- Vërtet. Ashtu ia shkrep, por jo çdo ditë, eh, kur është me nerva apo kur është tapë. Por për ta matur, ajo që quhet e matur, pothuaj e bën gjithnjë. Thotë se është mirë për burrërinë e tij. Thotë se i është bërë zakon që kur ishte në stan.

- Ai zorzop qenka psikopat, – tha Maria.

- Motra, puna është se ti je shumë delikate dhe nuk i kupton këto gjëra. Për mua s'ka asgjë të keqe këtu. Të gjithë meshkujt birbo e matin rroçkën. Ky imi e bën vërtet. Dhe e mat me thikën që ia ka falur kuçka e parë, e cila për të qe më shumë si një nënë.

- Vërtet e ka aq të madh?

Maria dhe Lupja qeshën. Imazhi i Albertit po zmadhohej e po kthehej në një figurë kërcënuese. Tashmë nuk kisha më dëshirë që të vinte aty dhe as t'i mbroja me çdo kusht vajzat.

- Një herë në *Azcapotzalco*, në një lokal këso punësh, bënë një zdërhallje të dehurish dhe ishte një zhordë putanë aty që i mundte të gjitha. Nuk kishte asnjë ruspí që mund ta gëlltiste karin komplet siç e gëlltiste ajo buçe. Atëherë Alberti u ngrit nga tavolina ku ishim dhe tha më prisni vetëm një çast, do të zgjidh një punë. Ata që ishin në tavolinën tonë i thanë, tani u tërbove, Albert. Duket që e njihnin. Unë e mora me mend se ç'do ta gjente të shkretën zhordë. Alberti doli në mes të pistës, nxori rroçkën, e fryu me nja dy të rëna dore dhe ia futi në gojë kampiones. Ajo ishte vërtet e fortë, po e bëri me mundim. Filloi ta gëlltiste pak nga pak karin midis britmave të habisë. Atëherë Alberti e mbërtheu për veshësh dhe ia futi të gjithin. Për më tej është vonë, tha dhe të gjithë ia dhanë gazit. Qesha edhe unë, megjithëse, ç'është e vërteta, më vinte një çikë turp, por edhe isha bërë pak xheloze. Në çastet e para, u duk sikur gërdalla do ta duronte, por pastaj u mbyt dhe filloi të asfiksohej...

- Ua, çfarë shtaze qenka ky Alberti yt! – thashë unë.

- Pa hë, vazhdo, ç'ndodhi më tej? – tha Maria.

- Asgjë. Zhorda filloi ta godiste Albertin dhe mundohej të shkëputej prej tij, kurse Alberti zuri të qeshte e t'i thoshte na, pelë, na, sikur t'ia kishte hipur një pele xanxare. Më merrni vesh, apo jo?

- Po, po, sikur të ishte një garë me kuaj në cirk, – thashë.

- Mua nuk më pëlqeu fare kjo gjë dhe bërtita lëre, Albert, se po e vret. Por besoj se nuk më dëgjoi. Ndërkohë, fytyra e zhordës sa vinte më shumë vrugohej, përndizej. Me sytë të hapur (vetëm kur e thithte i mbyllte) e shtynte Albertin nga rrëza e kofshëve, duke e mbërthyer, të themi, për xhepush e për rripi. Pothuaj qenë përpjekje të kota, sepse, pas çdo shtytje të saj për t'u shqitur prej Albertit, vinte një tjetër tërheqje e dhunshme për veshësh. Dhe ai e bënte gjithçka për të fituar, kjo dukej haptas.

- Po pse nuk i kafshoi aparatit? – tha Maria.

- Sepse ishte një argëtim midis miqsh. Po ta bënte atë, Alberti do ta vriste.

- Ti je e çmendur, Lupe, – tha Maria.

- Pse ti, jo? Të gjithë jemi të çmendur. Nuk është kështu?

Maria dhe Lupja qeshën. Unë doja të di fundin e historisë.

- Asgjë nuk ndodhi, – tha Lupja. – Plaka nuk mundi më dhe ia dha të vjellit.

- Po Alberti?

- Ai e la dhe u tërhoq pak më përpara. E mori vesh se ç'do të ndodhte dhe nuk dëshoi të fëlliqtë pantallonat. Kështu që, me një të hedhur tigrë, por nga mbrapa, shpëtoi paq, pa asnjë pikë të vjelle. Njerëzit në atë zdërrallje e duartrokitën me tërbim.

- Dhe ti ke rënë në dashuri me atë të marrë? – tha Maria.

- Ke rënë në dashuri? Nuk e di ç'do të thotë të biesh në dashuri. Unë dua një çikë më shumë, kjo është e gjitha. Edhe ti, po të ishe në vendin tim, këtë do të doje.

- Unë? Kurrë në botë.

- Është shumë burrë, – tha Lupja me vështrim të humbur matanë qelqajës, - kjo është thjesht e vërteta. Dhe më kupton më mirë se kushdo.

- Më mirë thuaj që të shfrytëzon më shumë se kushdo, – tha Maria duke u hedhur përpjetë e duke goditur tavolinën me duar. Nga goditja filxhanët lëvizën nga vendi.

- Ua, pse bën ashtu, motra?!

- Mirë thotë, mos bëj ashtu, ajo është zonja e jetës së saj dhe bën ç'të dojë me të, – thashë unë.



- Ti mos i fut hundët, Garsia Madero, ti i shikon gjërat nga jashtë, nuk kupton hiç se çfarë jemi duke folur.

- Edhe ti i shikon nga jashtë gjërat. Ti jeton me prindërit e tu, dreqi ta hajë, ti nuk je një kurvë, më fal, Lupe, e them pa dashur të të fyej.

- Mirë, nëse ti nuk më ofendon mua, djalosh, – tha Lupja.

- Pusho, Garsia Madero, – tha Maria.

Iu binda. Gjatë një çasti të tre mbetëm pa fjalë. Pastaj Maria filloi të fliste për Lëvizjen Feministe dhe përmendi Gertruda Steinin, Remedios Varon, Leonora Karringtonin, Alise B. Toklas (pordhë me rigon, tha Lupja, por Maria nuk ia vuri veshin), Unika Zurnin, Mariana Moren dhe të tjera, emrat e të cilave nuk më kujtohen. Ma merr mendja janë mbrojtëset e femrave të shekullit XX. Po ashtu përmendi edhe Sor Huana Ines de la Krus.

- Kjo është poete meksikane, – thashë.

- Gjithashtu është dhe një murgeshë, këtë gjë e di, – tha Lupja.

## 17 nëntor

Sot isha në shtëpinë e motrave Fonti pa Pançon. (Nuk mundem të rri i varur nga Pançoja përditë.) Megjithatë, me të mbërritur atje, m'u prish humori. Mendova se babai i Maries do të më përzinte me shkëlma, sepse nuk dija ta trajtoja mirë dhe se ai mund të më hidhej përsipër. Nuk pata guxim t'i bie ziles dhe në çast u ktheva mbrapsht e ia futa një xhiro nëpër lagje, duke menduar për Marien, Angjelicën, Lupen dhe poezinë. Po ashtu, pa dashur, më shkoi mendja te tetoja ime, tek im ungj dhe te jeta ime e deritanishme. Një jetë e këndshme e boshe dhe kuptova se kurrë më nuk do të vazhdonte të ishte e tillë. U gëzova thëllësisht për këtë gjë. Pastaj u ktheva përsëri, me hapa të nxituar, drejt shtëpisë së motrave Fonti dhe i rashë ziles. Zoti Fonti doli te dera dhe, që andej, më bëri një shenjë si të më thoshte mos ik, prit pak, tani vij e ta hap portën. Pastaj u zhduk, po derën e la gjysmë të hapur. Pas pak çastesh u duk prapë dhe përshkoi kopshtin duke përveshur mëngët e këmishës dhe me një buzëqeshje të madhe në fytyrë. E vërteta është se e gjeta në bend të mirë. Më liroi kalimin,

më tha ti je Garsia Madero, vërtet?, dhe më dha dorën. Unë i thashë si jeni ju, zotëri, dhe ai më tha, më thirr Kim, jo zotëri, sepse në këtë shtëpi nuk kanë vend këto formalizma. Në fillim nuk e mora vesh sesi donte që ta thërrisja dhe i thashë: Kim, që e kam lexuar te Rudjard Kipling?, por ai tha: jo, Kim është zvogëlim i emrit Hoakin në gjuhën katalane.

- E po mirë, Kim, – thashë me një buzëqeshje të lehtë e njëkohësisht i gëzuar. – Mua më quajnë Huan.

- Jo, më mirë do të vazhdoj të të flas Garsia Madero. Ashtu të flasin të gjithë, – tha ai.

Pastaj më tregoi një rrugë përmes kopshtit (më shoqëroi duke më mbajtur për krahu) dhe para se të më lëshonte më tha se Maria i kishte treguar për takimin e djeshëm.

- Të falënderoj, Garsia Madero, – tha. – Të rinj si ti, pak ka. Ky vend po shkon në hale dhe nuk e di sesi do t'ia bëjmë.

- Unë bëra atë që do të bënte kushdo, – thashë qorrazi.

- Edhe të rinjtë, që në teori janë shpresë për ndryshim, po kthehen në drogamanë, në prostituta. Kjo nuk shkon, kjo rregullohet vetëm me revolucion.

- Jam plotësisht dakord, Kim, – thashë.

- Sipas sime bije, je sjellë si një kavalier.

Mblodha supet.

- Ajo ka disa miqësi që ç'të them, tani do t'i njohësh vetë, – tha ai. – Një pjesë nuk më mërzit. Njeriu duhet të njohë njerëz gjithfarë, nganjëherë ia vlen edhe të lagesh nga realiteti, ë? Besoj se këtë e ka thënë Alfonso Rejes, mundet, nuk ka rëndësi. Por nganjëherë Maria e tepron, ë? Dhe unë nuk e kritikoj për këtë, që të laget nga realiteti, por të laget, jo të rrezikohet, apo jo? Sepse kush laget shumë, rrezikohet të kthehet në viktimë, nuk e di nëse më ndjek.

- Po të ndjek, – iu përgjigja.

- Në viktimitë të *realitetit*, sidomos në qoftë se janë miq apo mikështa, si të të them, magnetikë, ë? Njerëz që pafajësisht tërheqin fatkeqësitë ose tërheqin xhelatët, po më ndjek, vërtet, Garsia Madero?

- Si jo.

- Për shembull, ajo Lupja, vajza që takuat dje. Edhe unë e njoh. Nuk beson? Ka qenë këtu, në shtëpinë time, ka ngrënë e ka fjetur

këtu me ne, një natë ose dy, nuk po e ekzagjeroj, nuk ndodh asgjë me një natë apo dy, puna është se ajo vajzë ka *probleme*, apo jo? I tërheq vetë problemet, për këtë e kisha fjalën, kur të thashë se ka njerëz magnetikë.

- Të kuptoj. Janë si magnet.

- Tamam. Dhe në këtë rast, pra ai që është magnet tërheq diçka të keqe, shumë të keqe, por ngaqë Maria është shumë e re, pra nuk e kupton dhe nuk e shikon rrezikun, apo jo?, dhe në të vërtetë ajo do të bëjë *mirë*. T'u bëjë mirë atyre që kanë nevojë, pa u shqetësuar për rreziqet që mund të ketë në këto raste. Me një fjalë, vajza ime e shkretë do që mikja e saj, ose e njohura e saj, të braktisë jetën që bën.

- Tani e mora vesh se ku doni të dilni, zotëri, desha të them Kim.

- E shikon se ku dua të dal? Ku?

- E ke fjalën për atë rrufjanin e Lupes.

- Shumë mirë, Garsia Madero, aty është thelbi i çështjes. Kodoshi i Lupes. Ja ta shohim, çfarë është Lupja për të? Mjeti i tij i jetesës, zanati i tij, zyra e tij, me një fjalë puna i tij e përditshme. Dhe ç'bën një punëtor kur mbetet pa punë, ë? Më thuaj, çfarë bën?

- Zemërohet?

- Zemërohet *jashtëzakonisht*. Po me kë zemërohet? Për atë që i ka ndodhur me punën, mos e vër në dyshim këtë; ai nuk do të zemërohet me fqinjin. Edhe mundet, por në radhë të parë do të zemërohet me atë që e la pa punë, e qartë. Dhe kush po ia mbyll derën rrufjanit e po e lë pa punë? Ime bijë. Kështu që me kë do të zemërohet ai? Me time bijë. Dhe me familjen e saj, sepse dihet se ç'njerëz janë këta tipa; hakmarrja e tyre është e tmerrshme dhe s'ka kufij. Të betohem, ka net që shoh ca ëndrra aq të frikshme – qeshi pak, duke parë sheshin me bar, sikur të kujtonte ëndrrat e veta, - sa ia ngrenë qimet e kokës përpjetë edhe më trimit. Nganjëherë më bëhet në ëndërr sikur jam në një qytet që është Meksiko e në të njëjtën kohë nuk është Meksiko. Dua të them se është një qytet i panjohur, por unë e njoh nga ëndrrat e tjera. Nuk po të mërzis, vërtet?

- Jo, as mos e mendo.

- Pra, siç të thashë, është një qytet paqartësisht i panjohur e paqartësisht i njohur. E unë endem nëpër disa rrugë që s'kanë mbarim, duke u munduar të gjej një hotel ose një pension ku të

bujtem. Po nuk e gjej dot. Vetëm takoj një mashtrues të pagojë. Dhe më e keqja nga të gjitha është se po erret dhe unë e di mirë se kur bie nata jeta ime nuk do të vlejë hiç, apo jo? Do të jem, siç thonë, në mëshirë të forcave të natyrës. Është bela me ëndrrat, – shtoi mendueshëm.

- Mirë, Kim, po shikoj nëse janë vajzat.

- Sigurisht, – tha, por krahun nuk po ma lëshonte.

- Më vonë do të vij t'ju përshëndes, – thashë sa për të thënë diçka.

- Më pëlqeu ajo që ke bërë mbrëmë, Garsia Madero. Më pëlqeu që je kujdesur për Marien dhe që nuk je nervozuar fare përpara atyre kurvave.

- Dëgjo, Kim, ishte vetëm Lupja... Dhe mikeshat e mikeshave të mia janë mikeshat e mia, – thashë duke u skuqur deri te veshët.

- Mirë, ec e vizito gocat, besoj se kanë edhe një të ftuar tjetër; ajo dhomë është më tërheqëse se... – nuk gjeti dot krahasimin dhe qeshi.

U largova prej tij me aq nxitim sa munda. Kur isha gati të hyja në oborr ktheva kokën dhe pashë se Kim Fonti vazhdonte të qëndronte atje, duke qeshur shumë lehtë e duke shikuar manjolat.

## 18 nëntor

Sot shkova përsëri te shtëpia e motrave Fonti. Kimi, kur më hapi derën, më përqafoi. Në shtëpizë gjeta Marien, Angjelicën dhe Ernesto San Epifanion. Të tre ishin ulur te krevati i Angjelicës. Me të hyrë unë, instinktivisht bashkuan trupat e tyre si për të më penguar të shihja se ç'ishin duke parë bashkë. Më duket se prisnin Pançon. Kur panë se isha unë, fytyrat e tyre nuk u qetësuan.

- Duhet të mësohesh ta mbyllësh derën me çelës, – tha Angjelika. – Ashtu nuk do të ishim trembur.

Ndryshe nga Maria, Angjelika e ka fytyrën shumë të bardhë, por me një nuancë që nuk e di nëse është ngjyrë ulliri apo trëndafilí, besoj ngjyrë ulliri, me mollëzat e faqeve të dala, ballin të gjerë dhe buzët më të trasha se ato të së motrës. Me ta parë, ose më mirë të them me të parë që ajo po më shikonte (herët e tjera që kam qenë atje

në fakt *nuk* më ka shikuar), ndjeva se një dorë me gishta të gjatë e të hollë, po njëherazi edhe shumë e fortë, u mbështet mbi zemrën time, imazh që me siguri nuk do t'i pëlqente as Limës, as Belanos, por që ngjishej si një dorashkë e butë, sipas asaj që ndjeva në ato çaste.

- Nuk isha unë e fundit që hyra, – tha Maria.

- Po, ti ishe e fundit, – toni i Angjelicës ishte i sigurt, gati autoritar, dhe për një çast mendova se dukej si motra më e madhe, jo më e vogla. – Vëri llozin derës dhe ulu diku, – më tha mua.

Bëra si më thanë. Perdet e dritares ishin të mbyllura dhe drita që hynte brenda ishte në ngjyrë të gjelbër me hulliza të verdha. U ula në një karrige druri, pranë një rafti librash dhe i pyeta se çfarë po shikonin. Ernesto San Epifanio ngriti fytyrën dhe më kundroi disa sekonda.

- Ti nuk je ai që shënoi se ç'libra solla unë dje?

- Po. Brajan Paten, Adrian Henri dhe një tjetër që tani nuk më kujtohet.

- *The Lost Fire Brigade*, e Spajk Hokins.

- Po, pikërisht ai.

- Tani i ke blerë? – toni kishte një sarkazëm të lehtë.

- Ende jo, por jam gati.

- Duhet të shkosh në një librari të specializuar për letërsi angleze. Në libraritë normale të Meksikos nuk do t'i gjesh.

- Po, po, Ulisesi më tha për një librari ku shkoni ju.

- Ah, Ulises Lima, – tha San Epifanio duke u mëshuar shumë *i-ve*. – Me siguri do të dërgojë te *Libraria Baudelaire*, ku ka shumë poezi *franceze*, por shumë pak poezi *angleze*... Po cilët jemi ne?

- Ne? Çfarë ne? – thashë unë i habitur.

Motrat Fonti vazhdonin duke kundruar e duke shkëmbyer disa gjëra që unë nuk mund t'i shihja dot. Herë pas here qeshnin. E qeshura e Angjelicës ishte si një gurrë.

- Shfrytëzuesit e librarisë.

- Ah, e qartë, real-viseralistët.

- Mos më bëj të qesh. Sepse në atë grup lexojnë vetëm Ulisesi dhe miku i ngushtë i tij kilian. Të tjerët janë një bandë analfabetësh funksionalë. Më duket se e vetmja gjë që bëjnë ata nëpër librari është të vjedhin libra.

- Por pastaj i lexojnë, apo jo? – përfundova unë një çikë i inatosur.

- Jo, gabon. Pastaj ia dhurojnë Ulisesit dhe Belanos. Këta i lexojnë, ua tregojnë atyre dhe ata hiqen sikur kanë lexuar, për shembull, Kenonë, kur në të vërtetë vetëm *kanë vjedhur* një libër të Kenosë, por as që e kanë lexuar.

- Belanoja është kilian? – thashë jo vetëm duke u përpjekur të ndërroj temën e bisedës, por edhe pse vërtet nuk e dija.

- Ende nuk e ke marrë vesh? – tha Maria pa e ngritur shikimin nga ato që ishin duke parë.

- Mirë, por nga theksi më është dukur ndryshe, më është dukur, nuk e di, sikur ishte tamaulipekas apo jukatanas...

- Të është dukur jukatanas? Ah, Garsia Madero, qoftë bekuar çiltërsia. Belanoja i është dukur si jukatanas! – u tha San Epifanio motrave Fonti dhe të tre ia dhanë gazit.

Edhe unë fillova të qesh.

- Jo se m'u duk jukatanas, por mund të ishte. Veç kësaj unë nuk jam specialist për të njohur jukatanasit.

- E po ta dish, nuk është jukatanas. Është kilian.

- Ka kohë që jeton në Meksiko? – thashë sa për muhabet.

- Që nga puçi i Pinoçetit, – tha Maria, pa e ngritur kokën.

- Shumë më përpara puçit të Pinoçetit, – tha San Epifanio. – Unë e kam njohur më 1971. Puna është se më vonë u kthye në Kili dhe, kur ndodhi puçi, erdhi përsëri në Meksikë.

- Por atëherë ne nuk të njihnim, – tha Angelika.

- Belanoja dhe unë ishim shumë miq në atë kohë, – tha San Epifanio. – Të dy ishim nga tetëmbëdhjetë vjeç dhe ishim poetët më të rinj në rrugën *Bucareli*.

- Mund ta di se çfarë jeni duke parë? – thashë.

- Fotografitë e mia. Nëse do, mund t'i shohësh, por ka mundësi të mos të pëlqejnë.

- Je fotograf? – thashë duke u ngritur e duke u drejtuar për nga shtrati.

- Jo, jam vetëm poet, – tha San Epifanio duke më bërë vend. – Poezi kam sa të duash, edhe pse një vit me to, do të bëj gabimin vulgar e do t'i vihem shkrimit të tregimeve.

- Mbaji, – Angjelika më kaloi një tok fotografish, tashmë të para prej tyre, - duhet t'i shikosh duke ndjekur rendin kronologjik.

Duhet të ishin nja pesëdhjetë apo gjashtëdhjetë foto. Të gjitha të bëra me flash. Të gjitha qenë marrë brenda një banese, sigurisht një dhomë hoteli, në mos dy, nga dukej një rrugë natën e ndriçuar mangësisht, dhe një *Mustang* i kuq me disa njerëz brenda. Fytyrat e atyre që ishin në *Mustang* dukeshin të vagëlluara. Fotot e tjera tregonin një djalë gjashtëmbëdhjetë a shtatëmbëdhjetë vjeç, por mund të ishte edhe pesëmbëdhjetë, biond, me flokë të shkurtër, një vajzë ndoshta dy apo tre vjet më e vogël se ai, dhe Ernesto San Epifanio. Pa dyshim ishte një person i katërt, i cili i nxirrte në fotografi, por ai nuk dukej asnjëherë. Fotografitë e para ishin të djaloshit biond, veshur dhe pastaj dalëngadalë me më pak rroba. Duke nisur nga fotografia e pesëmbëdhjetë dukej San Epifanio dhe vajza. San Epifanio ishte veshur me një xhakëtë amerikane të purpurtë. Vajza me një fustan elegant feste.

- Kush është ai? – pyeta.

- Ti hesht dhe shiko fotot, pastaj pyet, – tha Angjelika.

- Është dashuria ime, – tha San Epifanio.

- Ua! Po ajo?

- Është motra e tij më e madhe.

Aty nga fotografia numër njëzet djaloshi biond fillonte të vishte fustanin e së motrës. Vajza, që nuk ishte aq bionde dhe vinte pak e trashë, i bënte gjeste të turpshme të panjohurit që fotografonte. Përkundrazi, San Epifanio, të paktën në fotot e para, mbahej zot i vetvetes, buzagaz, por serioz, ulur në një kolltuk imitim lëkure, ose në anë të krevatit. Gjithsesi, kjo nuk ishte më shumë se sa një iluzion, sepse nisur nga fotografia numër tridhjetë apo tridhjetë e pesë edhe San Epifanio zhvishej (trupi i tij, me këmbë dhe krahë të gjatë, dukej jashtëzakonisht i dobët, skelet, shumë më tepër nga ç'ishte në të vërtetë). Fotot në vazhdim tregonin San Epifanio duke puthur gushën e adoleshentit biond, buzët, sytë dhe supet e tij, karin e tij në gjysmështrizë, e pastaj karin e bërë dru (veç kësaj, një rroçkë e madhe për një djalosh aq delikat në dukje), gjithnjë nën një vështrim plot vëmendje të së motrës, e cila herë dukej me trup të plotë e herë pjesërisht (një krah e gjysmë, dora, ca gishtërinj, gjysma e fytyrës),

përfshi edhe hijen e saj të projektuar në mur. Duhet të rrëfehem se kurrë në jetën time nuk kisha parë gjëra të tilla. Sigurisht, askush nuk më kishte thënë që San Epifanio ishte homoseksual. (Vetëm Lupja, por Lupja tha edhe për mua se isha homoseksual.) Kështu që u përpoqa të mos i shfaq përshtypjet e mia (që, të paktën, ishin konfuze) dhe vazhdova të shikoj. Siç u trembeshja, fotot e mëtejshme tregonin lexuesin e Brajan Patenit duke u qirë në bythë nga adoleshenti blond. Ndjeva se po skuqesha dhe aty për aty kuptova se nuk dija qysh, në ç'mënyrë do t'i shikoja motrat Fonti dhe San Epifanion, kur të mbaroja vrojtimin tim të atyre fotove. Fytyra e djaloshtit qirës shtrembërohej në një ngërdheshje që shprehte njëherazi kënaqësi dhe dhimbje. (Ose bënte teatër, këtë mendova shumë më vonë.) Fytyra e San Epifanios dukej e mprehtë për momentin, si një presë brisku ose si një thikë që shkëlqen. Fytyra e së motrës, vrojtuese, kalonte nëpër të gjitha fazat e gjesteve të mundshme, që nga gëzimi i egër deri te melankolia më e thellë. Në fotografitë e fundit dukeshin, në poza të ndryshme, të tre të shtrirë në krevat, duke bërë sikur flinin apo duke i buzëqeshur fotografit.

- I shkreti çunak, duket se e kanë çuar atje me forcë, – thashë për të cytur San Epifanion.

- Me forcë? Ideja ishte e atij. Është një djalkë pervers.

- Ama, e do me tërë shpirtin tënd, – tha Angjelika

- Po, e dua me shpirt, por na kanë ndarë shumë gjëra.

- Çfarë? – pyeti Angjelika.

- Për shembull, paratë. Unë jam i varfër, ai është një fëmijë i pasur dhe i përkëdhelur, i mësuar me luks, me udhëtime, nuk i mungon absolutisht asgjë.

- Çudi, këtu nuk duket as i pasur, as i përkëdhelur, ka disa fotografi vërtet të mbrapshta, – thashë unë me një vrundull sinqeriteti.

- Familja e tij ka shumë para, – tha San Epifanio.

- Siç duket duhet të kini qenë në një hotel pak më të mirë. Ndriçimi është i filmit Santo.

- Është i biri i ambasadorit të Hondurasit, – tha San Epifanio duke më hedhur një vështrim kobzi. – Por këtë mos ia thuaj askujt, – shtoi pastaj, si i bërë pishman që më kishte rrëfyer sekretin e tij.



Ia ktheva tufën me fotografi, të cilat San Epifanio i futi në një çantë. Pak centimetra nga krahu im qëndronte krahu i majtë lakuriq i Angjelicës. Mblodha forcat dhe e pashë në fytyrë. Edhe ajo po më shikonte. Besoj se më hipi një skuqje e lehtë. U ndjeva i lumtur. Dhe u vura shkelmin të gjithave.

- Nuk erdhi Pançoja sot? – pyeta si budalla.

- Ende jo, – tha Angjelika. – Si t’u dukën fotot?

- Të trasha, – thashë.

- Vetëm të trasha? – San Epifanio u ngrit dhe u ul në karrigen prej druri ku isha ulur unë më parë. Që aty më kundroi duke më hedhur një nga ato buzëqeshjet e mprehta.

- E po mirë: kanë poezinë e vet. Por nëse do të thosha se më pëlqeu vetëm poetika, do të gënjeja. Janë fotografi të rralla. Unë do të thosha se është pornografi. Jo në kuptimin përcmues, por mendoj se është pornografi.

- Të gjithë kanë prirje t’i klasifikojnë gjërat sipas aftësisë së të kuptuarit të tyre, – tha San Epifanio. – Të eksituan fotot?

- Jo, – thashë me vendosmëri, edhe pse në të vërtetë nuk isha i sigurt. – Nuk më eksituan, por më pëlqyen.

- Atëherë nuk është pornografi. Të paktën, për ty nuk duhet të jetë kështu.

- Më pëlqyen, - pranova.

- Atëherë thuaj kështu: të kanë pëlqyer, nuk e di pse të kanë pëlqyer, gjithashtu kjo nuk ka shumë rëndësi, pikë.

- Kush është fotografi? – tha Maria.

San Epifanio pa nga Angjelika dhe qeshi.

- E po ky është një sekret. Më ka vënë në be që të mos i them askujt.

- Por ideja që e Billit, ç’rëndësi ka se kush i ka bërë fotografitë? – tha Angjelika.

Pra, i biri i ambasadorit të Hondurasit quhej Billi; tepër i goditur, mendova.

Dhe më vonë, nuk e di pse, dyshova se fotot i kishte nxjerrë Ulises Lima. E menjëherë pas kësaj mendja më shkoi te nacionaliteti i ri i Belanos për mua. Pastaj më mbetën sytë tek Angjelika, por jo që të më vinte re shumë, kryesisht kur ajo nuk më shikonte mua,

me kokën të zhytur brenda një libri me poezi (*Les Lieux de la douleur*, i Euzhen Savitskajës<sup>25</sup>), saqë vetëm e ngrinte për të marrë pjesë në bisedën që bënte tani Maria dhe San Epifanio mbi artin erotik. Pastaj u ktheva që të mendoja prapë për mundësinë se fotot i kishte nxjerrë Ulises Lima, kujtova gjithashtu atë që kisha dëgjuar në kafe *Quito*, se Lima merrej me trafikun e drogës dhe, nëse merrej me trafikun e drogës, kjo gjë gati ishte një fakt; mendova se mund të trafikonte edhe gjëra të tjera. Ndodhesha në këto vramendje, kur u duk Barriosi i shoqëruar nga një amerikane shumë simpatike (gjithnjë buzëqeshte), e quajtur Barbara Paterson dhe nga një poeteshë të cilën nuk e njihja, e quajtur Silvia Moreno, dhe pastaj të gjithë ia nisëm tymosjes së marijuanës.

Shumë më vonë, e kujtoj si në mjegull (megjithëse jo nga efekti i drogës, të cilën sapo e ndjeva) se dikush iu kthye sërish temës së nacionalitetit të Belanos, ndoshta isha unë, nuk e di, dhe të gjithë filluan të flisnin për të, dua të them të flisnin keq për të, përveç meje dhe Maries, sepse në një moment të caktuar, kur largohemi nga grupi, fizikisht e shpirtërisht, por edhe larg (mbase nga efekti i drogës) unë ende munda të dëgjoja çfarë thoshin. Gjithashtu flisnin për Limën, për udhëtimet e tij nëpër shtetin e Guerreros dhe nëpër Kilin e Pinoçetit, duke siguruar marijuanë, të cilën pastaj ua rishiste romancierëve dhe piktorëve të Meksikos. Por si mundej Lima të shkonte e të blinte marijuanë në anën tjetër të kontinentit? Dëgjova të qeshura. Besoj se edhe unë qeshja. Besoj se qeshja shumë. Sytë i kisha të mbyllur. Ata thanë: Arturi e detyron Ulises Limën të punojë shumë fare, tani rreziqet janë më të mëdha, dhe fraza më mbeti e regjistruar në kokë. I mjeri Belano, mendova. Pastaj Maria më kapi për dore dhe u futëm te shtëpiza, siç ndodhte kur atje ishte Pançoja me Angjelikën, po kësaj here nuk ishte Pançoja dhe askush nuk na përzuri.

Pastaj besoj se ia futa gjumit.

U zgjova në tre të mëngjesit, isha shtrirë në krah të Horhito Fontit.

---

<sup>25</sup> Eugène Savitzkaya (1955) – shkrimtar belg.

U ngrita me një të hedhur. Dikush më kishte hequr këpucët, pantallonat dhe këmishën. I kërkova qorrazi me dorë, duke u munduar që të mos e zgjoj Horhiton. Gjëja e parë që gjeta, në tokë, te këmbët e krevatit që çanta ime e shpinës, me librat dhe poezitë e mia. Pak më tej, hedhur në një karrige, gjeta pantallonat, këmishën dhe xhakatën prej lëkure qengji. Këpucët nuk po i gjeja dot. I kërkova poshtë krevatit dhe gjeta vetëm disa palë këpucë të ndryshme tenisi që ishin të Horhitos. U veshja dhe e pashë të arsyeshme të ndizja dritën ose të ikja pa këpucë. U afrova te dritarja, pa zgjedhur asnjë nga dy opsionet. Me të hapur perdet, mora vesh se ndodhesha në katin e dytë. Vrojtova oborrin në terr dhe pas disa pemësh dallova shtëpizën e motrave Fonti të ndriçuar lehtësisht prej hënës. Por shpejt e dallova se nuk që hëna ajo që ndriçonte shtëpizën, veçse një dritë rruge e ndezur pikërisht poshtë dritares sime, pak nga e majta, e varur në anën e jashtme të kuzhinës. Drita që e zbehtë. U orvata të shquaj dritaren e motrave Fonti. Nuk dallova dot asgjë, vetëm degë dhe hije. Për disa sekonda u mëdysha në mundësinë për t'u kthyer përsëri në shtrat e të flija derisa të gdhihej, por mendja më tha se kisha plot arsye për të hequr dorë. Së pari, deri atëherë kurrë nuk kisha fjetur jashtë shtëpisë sime pa e ditur im ungj dhe tetoja; së dyti, e dija se do të ishte e pamundur ta ndilla përsëri gjumin; së treti, duhej të shikoja Angjelicën, pse?, s'më kujtohej, por ndjeva nevojën urgjente për ta parë, për ta parë tek flinte me këmbë të mbledhura në shtratin e saj, si një këlysh apo si një fëmijë (metaforë e tmerrshme, por e saktë). Kështu që rrëshqita drejt derës dhe me mend i thashë mirupafshim Horhitos, faleminderit që më bëre vend, kunatoll! (që vjen nga latinishtja *cognatus*), dhe duke marrë zemër nga kjo fjalë, që më dha aq vrundull, dola më në fund nga dhoma nëpër një korridor të errët, si një natë pus e zezë, ose si në një kinema ku befas gjithçka është mbyllur, përfshi edhe disa sy, duke u kapur për muri për të gjetur, pas një lundrimi tepër të gjatë e të anktshëm si për të gjetur me detaje (sa i urrej detajet), shkallën solide që lidhte katin e dytë me të parin. Dhe atje, i palëvizur si një statujë kripe (domethënë dyllë i verdhë e me duart në një gjest gjysmë gjallëri e gjysmë druajtje), u gjenda përpara dy alternativave. Ose të kërkoja telefonin në sallon dhe të njoftoja dajën dhe dajeshën, të cilët në atë

kohë ka të ngjarë të kishin zgjuar më se një polic të ndershëm, ose të kërkoja kuzhinën që, sipas kujtimeve të mia, i binte të ishte në të majtë, pranë një tip dhome ngrënie të përditshme. Peshova mirë pro-të dhe kundra-t e të dy linjave vepruese dhe zgjodha atë më të heshturën, që ishte të braktisja sa më parë shtëpinë e madhe të familjes Fonti. Nuk qe larg vendimit tim edhe figura e beftë apo e ëndërrimtë e Kim Fontit, i cili, në errësirë, rrinte ulur në një kolltuk të mbështjellë me një mjegullinë squfuri të kuqërremtë. Me sforcim të madh mezi munda të kthjellohem. Në shtëpi të gjithë flinin, edhe pse, përveç meje, atje askush nuk i dëgjonte gërhimat e të tjerëve. Pasi kaluan disa sekonda, mjaftueshëm për të më bindur se asnjë rrezik, të paktën aty për aty, nuk ekzistonte rreth meje, nisa të eci përsëri. Në këtë krah të shtëpisë, feneri i oborrit ndriçonte zbehtësisht rrugën time dhe nuk vonova e u gjenda në kuzhinë. Atje, duke e braktisur kujdesin tim ekstrem të deriatëhershëm, mbylla derën, ndeza dritën dhe u plandosa mbi një karrige, i rraskapitur, sikur të kisha vrapuar një kilometër, përpjetë brinjës. Pastaj hapa frigoriferin, mbusha një gotë me qumësht deri në buzë, bëra një sanduiç me proshutë, djathë, salcë stridhesh dhe mustardë Dizhoni. Mbarova së ngrëni, por ende kisha uri, prandaj përgatita një tjetër sanduiç, kësaj here me sallatë jeshile dhe trangull, të stolitur me dy-tri lloje specash. As sanduiçi i dytë nuk ma shoi urinë, kështu që vendosa të vihem në kërkim të diçkaje më të fuqishme. Në fund të frigoriferit, në një kuti plastike, gjeta një pjesë pule me salcë; në një enë tjetër gjeta pak oriz, ca ushqim, si duket i mbetur nga dita e djeshme, e pastaj gjeta bukë të plotë dhe jo bukë të prerë në feta, dhe fillova të përgatis darkën. Për të pirë zgjodha një shishe me Lulú në shijen e luleshtrydhes, në të vërtetë më pëlqen më shumë ajo me shije hamajke. Hëngra i ulur në kuzhinë, në qetësi, duke medituuar për të ardhmen. Pashë uragane, tufane, cuname, zjarre. Pastaj lava tiganin, pjatën, lugën, thikën e pirunin, mblodha thërrimet dhe tërhoqa shulin e derës që të nxirrte në oborr. Para se të dilja, fika dritën.

Shtëpiza e motrave Fonti ishte e mbyllur nga brenda. Thirra një herë, pastaj pëshpërita emrin e Angjelicës. Nuk m'u përgjigj

askush. Shikova nga mbrapa, hijet e oborrit, pishina që kapardisej si një kafshë kokëkrisur, më bindën të kthehem prapë te dhoma e Horhito Fontit. Po përsëri bëra zë, kësaj here pak më fort. Prita disa sekonda dhe thashë të ndryshoj taktikë. U shmanga disa metra në të majtë dhe godita disa herë me majë të gishtave në qelqin e dritares. Marie, fola, Angjelika, Marie, hapeni, jam unë. Pastaj qëndrova në heshtje, në pritje të ndonjë rezultati, por në brendësi të shtëpizës asnjë lëvizje. Më vinte plasja, megjithëse më e saktë do të ishte të them dëshpërimisht i dorëzuar, u zvarrita edhe një herë drejt derës dhe e lëshova veten e u mbështeta me kurriz në të me vështrim të përhumur. Parandjeva se përfundimisht, në një mënyrë apo në një tjetër, do të ngelesha atje, te këmbët e motrave Fonti, duke fjetur, si një qen (një qen i lagur nga nata, mizorisht!), ashtu siç kisha dëshiruar para disa orësh, unë vetë, rrëmbyeshëm dhe derrçe. I zjarrmuar, isha gati t'ia pëlçisja vajit. Për t'u bërë ballë reve të mëdha që vinin rrotull së ardhmes sime të menjëhershme, iu kushtova shqyrtimit të gjithë librave që duhej të lexoja, të gjitha poezive që duhej të shkruaja. Pastaj mendova se po të flija, shërbëtorja e familjes Fonti do të më gjente aty dhe do të bënte çmos të më zgjonte, se, po të më shihte zonja Fonti, ndonjë nga bijat e saj apo Kim Fonti personalisht, unë do të turpërohesha. Megjithëse, sikur të ishte ky i fundit që të më shihte, gjykova me njëfarë shprese, kishte gjasa të mendonte se kisha sakrifikuar një natë gjumi të qetë për hir të një vigjilimi besnik për bijat e tij. Nëse do të më ngrinin duke më ftuar për një kafe me qumësht, arsyetova unë, nuk kishte asgjë të keqe, por, nëse do të më ngrinin me shkelma e të më lëshoheshin pa kërkuar asnjë shpjegim, atëherë nuk do të kishte më asnjë shpresë për mua dhe, veç kësaj, si do t'ia shpjegoja unë tim ungji hallakatjen zbathur nëpër gjithë Meksikon? Mendoj se qe pikërisht kjo arsyeja, ndoshta edhe dëshpërimi, që më bëri të ngrihem përsëri dhe, në mënyrë të pavetëdijshme, t'i bie derës me kokë, e sigurt është se menjëherë ndjeva disa hapa në brendësi të shtëpizës. Disa sekonda më pas dera u hap dhe një zë mermëritës dhe i përgjumur më pyeti se ç'bëja aty.

Ishte Maria.

- Më kanë humbur këpucët. Po t'i gjej, do të iki menjëherë në shtëpinë time, – thashë.

- Eja, – tha Maria. – Mos bëj zhurmë.

Shkova pas saj me duart e shtrira përpara, si një qorr. Befas u përplasa me diçka. Ishte krevati i Maries. E dëgjova të më urdhëronte të shtrihesha, pastaj e pashë të kthehet (shtëpiza e motrave Fonti është *vërtetësisht* e madhe) e të mbyllë derën pa zhurmë, e cila kishte mbetur gjysmë e hapur. Nuk e dëgjova të vinte prapë. Në një terr të plotë, pas disa çastesh, kur isha ulur në anë të krevatit, nuk isha shtrirë siç më kishte urdhëruar, dallova përvijimin e dritares midis perdeve të mëdha prej lini. Pastaj ndjeva se dikush po futej në shtrat e po shtrihej, dhe pastaj, nuk di sa kohë më vonë, ndjeva se ai person u ngrit përgjysmë, me sa duket i mbështetur mbi bërryl, dhe po më tërhiqte drejt tij. Nga fryma kuptova se isha pak centimetra larg fytyrës së Maries. Gishtat e saj bridhnin në fytyrën time, që nga mjekra deri te sytë, duke m'i mbyllur, si të donte të më ftonte të flija, dora a saj, një dorë eshtake, më zbërtheu pantallonat dhe nisi të kërkonte karin tim; nuk e di pse, ndoshta për shkak të nervozizmit që kisha, pohova se nuk më flihej. E di, tha Maria, as unë. Pastaj gjithçka u kthye në një vargan bëmash konkrete ose të emrave të përveçëm apo foljeve, ose të kapitujve të një manuali anatomie të shpetluar si një lule, të ndër-këmbyeshme rrëmujshëm midis tyre. E eksplorova trupin lakuriq të Maries, të ëmblin trup lakuriq të Maries, me një qetësi të përmbajtur, edhe pse kisha një dëshirë të madhe për të bërtitur, duke gëzuar çdo vend, çdo centimetër të lëmuar dhe të pambarimtë që prekja. Maria, më pak e duruar se unë, pas pak filloi të rënkonte dhe veprimet e saj, fillimisht të ndrojtura ose të matura, po bëheshin më të hapura (për momentin nuk gjej dot fjalë tjetër), duke e drejtuar dorën time nëpër ca vende që ajo, domethënë dora ime, nga mosnjohja apo nga shqetësimi nuk i gjente dot. Kështu, në më pak se dhjetë minuta, mësova ku ishte klitori i një femre dhe si duhej t'i bëje masazh atij, ta thithje apo ta ngjeshje, veç gjithmonë brenda kufijve të ëmbëlsisë, kufij që, nga ana e saj, Maria i shkelte herë pas here, sepse kari im, i trajtuar mirë në çastet e para, shpejt filloi të martirizohej nga duart e saj; duar të cilat në disa momente, në errësirë dhe midis pështjellimit të çarçafëve, me kthetra fajkoi ose shqiponje, ma mbërthenin me aq forcë sa u tremba se do të ma shkulinin me gjithë rrënjë, dhe në disa

momente të tjera, si xhuxhër kinezë (gishtat ishin kodoshët kinezë!) duke huluntuar e duke studiuar kodrat dhe luginat që lidhnin koqet e mia me karin dhe me njëra-tjetrën. Pastaj (por më përpara më kishte ulur pantallonat deri te gjunjët) ma hipi kaluar dhe vetë ajo e futi brenda.

- Mos ma derdh brenda, – tha Maria.

- Do të mundohem, – i thashë.

- Si do të mundohesh, trap? Mos e derdh brenda të them!

Shikova nga të dy anët e krevatit, ndërkohë që këmbët e Maries ngjisheshin e fërkoheshin mbi supet e mi (doja të vazhdonte ashtu derisa të vdisja). Së largu dallova hijen e krevatit të Angjelicës dhe lakoren e këllqeve të Angjelicës, si një ishull i kundruar nga një tjetër ishull. Papritur ndjeva se buzët e Maries thithnin koqen time të majtë. Ishte sikur të më kafshonte zemrën. Mora fuqi nga lart dhe ia futa të gjithë me një të ngulur, me dëshirën që ta gozhdoja për krevati (trandjet e tij dhanë një gërvimë të frikshme dhe u ndala), ndërkohë që i puthja flokët dhe ballin me shumë delikatesë dhe ende kisha kohë për të vrarë mendjen si ishte e mundur që Angjelika të mos zgjohej me tërë atë zhurmë që bënim. E ndjeva kur do të prishesha. Gjithnjë kam pasur reflekse të mira dhe, sigurisht, arrita ta nxirrja.

- Nuk besoj ta kesh derdhur brenda, ë? – tha Maria me shqetësim.

Iu betova te veshi që jo. Gjatë disa çasteve qëndruam duke marrë frymë të lodhur. E pyeta nëse ajo kishte pasur orgazmë dhe përgjigjja e saj më la ndërdyhas:

- Pata dy herë, Garsia Madero. Nuk e kuptove? – pyeti me tërë seriozitetin e duhur.

I thashë sinqerisht që jo, që nuk kisha kuptuar asgjë.

- Ende e ke të fortë, – tha Maria.

- Më duket se po, – thashë unë. – Mund të ta fus prapë?

- Mirë, – tha ajo.

Nuk di sa kohë kaloi. Përsëri e derdha jashtë. Kësaj radhe nuk munda t'i përmbaja rënkimet e mia.

- Tani masturbomë, – tha Maria.

- Nuk pate fare orgazmë?

- Jo, kësaj radhe nuk pata fare, por e ke punuar mirë.

Më kapi dorën, më zuri gishtin tregues, dhe me të shtypte rreth e rreth klitorin e saj, duke më urdhëruar:

- Puthmi thithkat, kafshomi ato, por në fillim me ngadalë. Pastaj kafshomi më fort. Fërkomë gushën dhe përkëdhelma fytyrën me dorën tjetër. Futmi gishtat në gojë.

- Nuk do të... thith klitorin? – thashë në një përpjekje të kotë për të gjetur fjalët më elegante.

- Jo, tani për tani jo. Mjafton me gisht. Po puthmi sisët.

- Ke ca gjinj të mrekullueshëm, – nuk isha i aftë të përsëritja fjalën sisë.

U zhvesha lakuriq pa dalë nga çarçafët (isha bërë ujë në djersë) dhe pastaj, menjëherë nisa të veproj siç më mësonte Maria. Së pari psherëtimat e saj e më pas rënkimet e saj ma ngritën përsëri. Ajo e kuptoi dhe me një dorë filloi të më fërkonte karin derisa nuk durova dot më.

- Çfarë ke, Maria? – i shushurita në vesh i trembur se mos i kisha vrarë fytyrën (shtrëngomë, pëshpëriste ajo, shtrëngomë) apo mos e kisha kafshuar shumë njërin thithkë.

- Vazhdo, Garsia Madero, – buzëqeshi Maria në errësirë dhe më puthi.

Kur mbaruam, më tha se ishte prishur më shumë se pesë herë. Unë, ç'është e vërteta, e pata të vështirë ta besoja, dukej si fantastike, por, kur m'u betua, nuk kisha pse të mos i besoja.

- Për çfarë mendon? – më tha.

- Për ty, – e gënjeva; në të vërtetë mendoja për tim ungj, për Fakultetin e Drejtësisë dhe për revistën që do të nxirrnin Belanoja dhe Lima. – Po ti?

- Mendoj për fotot, – tha.

- Për cilat foto?

- Për fotot e Ernestos.

- Fotot pornografike?

- Po.

Të dy dridheshim në unison, me fytyra të ngjitura. Flisnim, çuçurisnim, kur hundët tona na krijonin distancë, por edhe ashtu ndieja me buzët e mia se si lëviznin buzët e saj.

- Do që ta bëjmë edhe një herë?



- Po, – tha Maria.

- Mirë, – thashë pak i trulllosur, - nëse bëhesh pishman në çastin e fundit, thuamë.

- Të pendohem! Pse? – tha Maria.

Shalët e saj qenë latërzhyer me farën time. Ndjeva të ftohtë dhe nuk munda ta shmang një teshtimë të fortë në momentin që sapo i penetrova.

Maria rënkoj dhe unë fillova ta pompoj gjithnjë e me më shumë entuziazëm.

- Mundohu të mos bësh shumë zhurmë, nuk dua të na dëgjojë Anjelika.

- Ti përpiqu të mos bësh zhurmë, – thashë unë, dhe shtova: - Çfarë i ke dhënë Anjelicës që paska gjumë aq të thellë. Ndonjë gjumëndjellës?

Të dy qeshëm me zë të ulët, unë mbi zverkun e saj e ajo duke kredhur fytyrën në jastëk.

Në fund nuk pata më ánimo (nga latinishtja *animus* e kjo nga fjala greke që do të thotë *frymë*) as për të pyetur nëse ishte kënaqur dhe e vetmja gjë që lakmoja ishte të më zinte gjumi dalëngadalë, me Marien në krahët e mi. Por ajo u ngrit dhe më detyroi të vishem dhe të shkonim bashkë në banjën e shtëpisë së madhe. Kur dolëm në oborr pashë se po gdhihej. Maria kishte veshur një këmishë nate të bardhë, me qëndisma të kuqe te mëngët dhe flokët i kishte kapur me një shirit apo rrip lëkure gërshetë.

Pasi të fshihemi e të thahemi, mendova të marr në telefon shtëpinë time, por Maria tha se ata do të ishin duke fjetur, prandaj t'i merrja më vonë.

- Po tani? – i thashë.

- Tani pak gjumë, – tha Maria dhe e kaloi krahun rreth mesit tim.

Por, nata ose dita do të jepte çudinë fundit. Aty, brenda në shtëpizë, të kruspullosur në një qosh, zbulova Barriosin dhe miken e tij amerikane. Të dy gërhisnin. Me dëshirë të madhe do t'i kisha zgjuar me një të puthur.

## 19 nëntor

Hëngrëm mëngjes të gjithë bashkë. Kim Fonti, zonja Fonti, Maria dhe Angjelika, Horhito Fonti, Barriosi, Barbara Paterson dhe unë. Për mëngjes kishim omëletë, feta buke me proshutë të fërguar, bukë, marmelatë mangoje, marmelatë luleshtrydheje, gjalpë, patë salmoni dhe kafe. Horhitoja piu një gotë me qumësht. Zonja Fonti (më dha një të puthur në faqen nga ana e saj!) bëri disa pallaçinka që i quajti petulla, por që në njëfarë mënyre ashtu ngjanin. Gjërat e tjera për mëngjes i kishte përgatitur shërbyesja (emrin e së cilës nuk e di ose e kam harruar, diçka që më duket e pafalshme), pjatat i lamë unë dhe Barriosi.

Më vonë, kur Kimi iku në punë dhe zonja Fonti filloi të planifikojë ditën e saj të punës (punon, kështu më tha, si gazetare në një revistë dedikuar familjes meksikane), vendosa përfundimisht të marr në telefon shtëpinë. Në shtëpi ndodhej vetëm dajeshja, Martita, e cila sa ma dëgjoi zërin, zuri të bërtiste si e çmendur e pastaj të qajë. Pas një sërë lutjesh të pareshtura Virgjëreshës, thirrjeve për të qenë i përgjegjshëm, copa rrëfimesh për “natën e tmerrshme që kishte kaluar im ungj”, paralajmërimet me një ton më shumë përkrahës sesa qortues për ndëshkimin që im ungj me siguri kishte ndër mend pikërisht atë mëngjes, munda më në fund të flas e ta siguroj se isha mirë, se e kisha kaluar natën me disa miq dhe se nuk do të vija në shtëpi derisa “dielli të fshihej”, sepse mendoja të dilja shpejt nga universiteti. Tetoja ime premtoi se do të fliste me tim ungj në punë dhe më bëri të betohem për ç’kisha të shtrenjtë në jetë që herë tjetër të telefonoja në shtëpi, kur kisha ndër mend ta kaloja natën jashtë. Për disa minuta u mendova nëse do të ishte mirë t’i telefonoja vetë tim ungj, por në fund e ndava mendjen se nuk ishte e nevojshme.

U lëshova mbi një kolltuk dhe nuk dija ç’të bëja. Kisha përpara pjesën e mbetur të mëngjesit dhe gjithë ditën, domethënë isha i vetëdijshëm se koha e mbetur ishte në dispozicionin tim dhe në atë mënyrë më dukeshin të ndryshme nga mëngjeset e tjera dhe nga ditët e tjera (ku unë isha një shpirt i trishtuar që po braktisja universitetin ose virgjërinë time), por mundësitë që më ofroheshin ishin aq të shumta sa nuk dija ç’të bëja.

Kisha ngrënë si një ujë ndërkohë që zonja Fonti dhe Barbara Paterson flisnin për muzetë dhe familjet meksikane, kështu që tretja e ushqimit më kishte shkaktuar një dremitje të lehtë dhe isha zgjuar tamam në kohë, me dëshirën për ta qirë përsëri Marien (së cilës, gjatë mëngjesit, iu shmanga për ta parë dhe kur e pashë u përpoqa t'ia përshtat vështrimin tim konceptit të dashurisë vëllazërore apo të shoqërisë së sinqertë që mendoja se do të dallonte i ati, i cili në të vërtetë nuk shfaqti as më të voglën habi kur më pa aty, në tavolinën e vet, që në orët e para të mëngjesit), por Maria dhe Angjelika po përgatiteshin për të dalë, Horhito Fonti tashmë kishte dalë, Barbara Patersoni ishte në dush dhe vetëm Barriosi e shërbyesja sorollateshin, si dërrasat e një varke të mbytur, nëpër bibliotekën e gjerë të shtëpisë së madhe, kësisoj, për të mos i bezdisur dhe nisur nga një zell i lehtë simetrie, përshkova për të disatën herë oborrin dhe u futa në shtëpizën e motrave, ku krevetet ishin ende të parregulluara (gjë që dukej qartazi se ishte shërbyesja apo rrogëtarja – ose *katunarja* luftarake, siç e quante Horhitoja – ajo që merrej me to, karakteristikë që në vend ta zvogëlonte konsideratën time për Marien, e zmadhonte, duke i dhënë një hije mendjelehtësie dhe moskokëçarjeje që i shkante) dhe kundrova teatrin tim të “galerisë së mrekullive”, ende të lagur, dhe, megjithëse duhet t'ia kisha plasur vajit ose të lutesha, ajo që bëra që të shtrihem në një nga krevetet e parregulluara (në atë të Angjelikës, jo të Mariës, siç e vërtetova më vonë), dhe ia futa gjumit.

Më zgjoi Panço Rodriguesi duke më dhënë një shi dackash (përfshi edhe një shkelm, megjithëse për këtë nuk jam i sigurt) në gjithë trupin. Vetëm edukata ime e mirë më pengoi për ta përshëndetur me një grusht në nofull. Pasi i thashë mirëdita, dola dhe lava fytyrën te shatërvani (dukej që ende isha përgjumësh) me Pançon mbrapa, duke mërmëritur fjalë pa kuptim.

- Nuk ka njeri fare në shtëpi, – tha. – M'u desh të hyja nga muri. Ç'bën ti këtu?

I thashë se e kisha kaluar natën aty (duke shtuar, për të mos e dramatizuar, ngaqë fërfëllima e hundës së Panços më alarmoi, se edhe Barriosi e Barbara Patersoni e kishin bërë) dhe pastaj provuam të hynim në shtëpinë e madhe nga dera e pasme, nga ajo e kuzhinës, edhe nga dera përpara, por të dyja ishin të mbyllura mirë.

- Në qoftë se na shikon ndonjë fqinj, do të lajmërojë policinë, – thashë, – do ta kemi të vështirë për të shpjeguar se nuk kemi ardhur për të vjedhur.

- As që e çaj kokën fare. Mua më pëlqen të vjedh nganjëherë në shtëpitë e shokëve të mi, – tha Pançoja.

- Edhe diçka tjetër, – thashë duke mos ia vënë veshin fjalëve të Panços, - më duket se pashë të lëvizë një perde te shtëpia në krah. Po të vijë policia...

- E ke qirë gjë Angjeli, o shkërdhatë? – tha Pançoja papritur, duke e hequr vështrimin nga dritaret e përparme të shtëpisë së familjes Fonti.

- Të siguroj që jo, – thashë.

Nuk e di në më besoi apo jo. Pastaj të dy kapërcyem murin dhe u nisëm për të dalë nga lagjja *Condesa*.

Ndërsa ecnim (në heshtje, përmes parkut *Spanja*, parkut *Parras*, parkut *San Martín* dhe atij *Teotihuacán*, në atë orë shëtitjeje vetëm për zonjat e shtëpisë, shërbëtoret dhe endacakët), mendova se çfarë më kishte thënë Maria për dashurinë dhe për dhimbjen që dashuria linte të binte mbi kokën e Panços. Ndërkohë që mbërritëm te sheshi i *Kryengritësve*, Pançoja kishte ardhur në qejf dhe fliste për letërsi, më rekomandonte autorë e sigurisht përpiquej ta largonte nga mendja Angjeli. Pastaj u futëm nëpër *Manzanillo*, iu shmangëm *Aguascalientes* dhe morëm përsëri drejt jugut, gjatë rrugës *Medellín*, derisa mbërritëm te rruga *Tepeji*. U ndalëm përballë një godine pesëkatëshe dhe Pançoja më ftoi për të drekuar me familjen e tij.

Morëm ashensorin deri në katin e fundit.

Aty, në vend të hynim në një nga hyrjet e katit, siç prisja unë, u ngjitëm shkallëve deri në tarracë. Një qiell gri, por i shndritshëm, sikur të kishte ndodhur një sulm nuklear, na priti në mes të një shumice saksish me lule të larmishme nëpër korridor dhe sqolle.

Familja Panço jetonte në dy dhoma në tarracë.

- Përkohësisht, – më shpjegoi Pançoja, - derisa të kemi para për një shtëpi këtu rrotull.

Për formalitet më prezantoi me mamanë e tij, donja Pançitën, me të vëllain Moktezuma, nja nëntëmbëdhjetë vjeç, poet katolian dhe

sindikalist, dhe me vëllain e vogël, Norberton, pesëmbëdhjetë vjeç, nxënës i shkollës së mesme.

Një nga dhomat, gjatë ditës, shërbente si dhomë ngrënie dhe si sallë për të parë televizorin, ndërsa natën si dhomë gjumi për Pançon, Moktezumën dhe Norberton. Tjetra ishte një lloj gardërobe apo *closet*-i gjigant, ku përveç frigoriferit dhe enëve të kuzhinës (kuzhinë portative që e nxirrnin në korridor gjatë ditës dhe e fusnin në këtë dhomë gjatë natës) ndodhej edhe dysheku ku çlodhej donja Pançita.

Sa u ulëm për të ngrënë, u bashkua me ne edhe njëfarë Piel Divina, njëzetetrevjeçar, fqinj i tarracës, i cili u prezantua si poet viseralist. Para se të ikja (shumë orë më vonë, koha paskej fluturuar), e pyeta edhe një herë se si quhej dhe ai tha Piel Divina aq natyrshëm dhe me aq siguri (shumë më tepër nga çdo të kisha bërë unë për të thënë Huan Garsia Madero) sa për një çast arrita të besoj se në dredhat e lumenjve dhe në kënetat e Republikës tonë Meksikane ekzistonte vërtet një familje e tillë Divina.

Pasi hëngrëm, donja Pançita iu kushtua telenovelave të saj të dashura dhe Norberti iu vu studimit të librave të shpërndara mbi tryezë

. Pançoja dhe Moktezuma lanë pjatat në një lavaman prej nga dukej një pjesë e mirë e parkut *Las Américas* e më tutje madhësitë kërcënuese – si të ardhura nga një planet tjetër, ama një planet i pagjasë – të Qendrës Mjekësore, Spitali i Fëmijëve dhe Spitali i Përgjithshëm.

- E mira e të jetuarit këtu, nëse nuk do t'ia dish për të tjerat, – tha Pançoja, - është se i ke pranë të gjitha, je mu në zemër të qytetit.

Piel Divina (të cilin, me sa duket, Pançoja dhe i vëllai, edhe donja Pançita, e thërrisnin Piel), na ftoi të shkonim në dhomën e tij ku, siç tha, kishte mbetur ca marijuanë nga zdërrhallja e fundit.

- Tani, menjëherë, shpirti im, – tha Moktezuma.

Dhoma e Piel Divinës, ndryshe nga dy dhomat që kishin Rodriguesit, ishte një shembull zbrazësie dhe thjeshtësie. Nuk pashë rroba të nderura, nuk pashë orendi shtëpiake, nuk pashë libra (Pançoja dhe Moktezuma ishin të varfër, por në vendet më të paimagjinueshme të banesës së tyre mund të shikoje libra të Efrain Huertas, Augusto

Monterrosos, Hulo Torrit, Alfonso Rejes, të famshmit tashmë Katulit përkthyer prej Ernesto Kardenalit, të Haime Sabianes, Maks Aubit, Andres Henestrosas<sup>26</sup>), vetëm një dyshek të vogël, një karrige – tavolinë nuk kishte – dhe një valixhe lëkure të cilësisë së mirë, ku mbante rrobat e tij.

Piel Divina jetonte vetëm, megjithëse nga fjalët e tij dhe nga ato të vëllezërve Rodrigues nxora si përfundim se nuk kishte shumë kohë që atje kishte jetuar një grua (dhe djali i saj), të dy të tmerrshëm, të cilët, kur kishin ikur, kishin marrë me vete një pjesë të madhe të mobilieve.

Gjatë disa çasteve po tymosnim marijuanë dhe po shikonim peizazhin (që, siç kam thënë, përbëhej kryesisht nga siluetat e spitaleve, nga një mori tarracash të ngjashme me atë ku ndodheshim ne dhe nga një qiell me re të ulëta që ecnin lehtë-lehtë drejt jugut) dhe pastaj Pançoja nisi të tregojë aventurën e tij të atij mëngjesi te shtëpia e motrave Fonti dhe takimin me mua.

Që të tre më pyetën lidhur me motrat Fonti, por nuk arritën të nxjerrin gjë, sepse unë nuk i kisha treguar as Panços. Për një çast filluan të flisnin për Marien. Nga fjalët e tyre të dyshimta, arrita të besoj se Piel Divina dhe Maria kishin qenë dashnorë. Po ashtu, që këtë e kishin ndaluar të hynte në shtëpinë e familjes Fonti. Desha të dija pse. Më shpjeguan se zonja Fonti i kishte gjetur befas ata një natë, ndërkohë që qiheshin te shtëpiza. Në shtëpinë e madhe bëhej një festë për nder të një shkrimtari spanjoll që sapo kishte mbërritur në Meksikë dhe në një çast të caktuar të festës zonja Fonti deshi t'i prezantonte poetit bijën e vet të madhe, domethënë Marien, por nuk po e gjente dot. Kështu që me poetin spanjoll për krahu doli në kërkim të saj. Kur mbërritën te shtëpiza, aty dritat qenë të fikura dhe nga fundi i shtëpisë dëgjuan një zhurmë si goditje, goditje ritmike dhe kumbuese. Zonja Fonti, sigurisht, pa e ditur se ç'do të shikonte (po ta kishte shkuar në mendje, para se ta bënte këtë, tha Moktezuma, do ta kishte çuar spanjollin përsëri në festë, pastaj do të

---

<sup>26</sup> Efraín Huerta, Augusto Monterroso, Julio Torri, Alfonso Reyes, Ernesto Cardenal, Jaime Sabines, Max Aub, Andrés Henestrosa – poetë dhe shkrimtarë hispanikë.

ishite kthyer vetëm për të parë se ç'bëhej me të bijën në atë dhomë), e po mirë, ku ta dinte lumëmadhja ajo, dhe ndezi dritën. Në fund të dhomës, e tmerruar, pa të bijën, vetëm në bluzë, me pantallonat e ulura, duke i thithur karin Piel Divinës, ndërkohë që ky i binte me dacka bythëve dhe seksit të saj.

- Dacka shumë të forta, – tha Piel Divina. – Kur u ndez drita pashë se mollaqet e saj qenë bërë flakë. Ç'është e vërteta, u tremba.

- Po pse e godisje? – thashë me inat dhe i trembur se mos skuqesha.

- Sepse vetë ajo ia kishte kërkuar, shelegu im, – tha Pançoja.

- Nuk mund ta besoj, – thashë.

- Eh, janë parë gjëra edhe më të çuditshme, – tha Piel Divina.

- Fajin për të gjitha e ka një franceze që quhet Simon Darrië, – tha Moktezuma. – Unë di se Maria dhe Angjelika e ftuan atë farë Simone në një tubim feminist dhe kur dolën andej, filluan të bisedonin për seksin.

- Cila është kjo Simone? – thashë.

- Një mikeshja e Artur Belanos.

- Unë iu afrova atyre. Ç'kemi shoqe, u thashë, dhe ato tepër kurva po bisedonin për Markes de Saden, – tha Moktezuma.

Pjesa tjetër e historisë ishte e parashikueshme. Mamaja e Maries deshi të thoshte diçka, por nuk mundi. Spanjollë, që sipas Piel Divinës u bë dyllë i verdhë para pamjes së prapanicës së ngritur dhe të dorëzuar të Maries, e kapi për krahu zonjë Fonti, duke iu lutur, siç u lutet të sëmurëve mendorë, dhe e tërhoqi përsëri drejt festës. Në qetësinë e beftë që menjëherë ra mbi shtëpizë, Piel Divina i dëgjoi të bisedonin në oborr me ca fjalë të shpejta. Me sa dukej rrufjani *gaçupin*<sup>27</sup>, i harbuar, po i propozonte diçka të pandershme të shkretës zonjës Fonti, e cila qe shtrirë te shatërvani.

Por më vonë, kur u dëgjuan hapat e tyre tek largoheshin drejt shtëpisë së madhe, Maria i tha që të vazhdonin.

- Pas gjithë këtyre që ndodhën Maria donte të vazhdonte të bënte dashuri?

---

<sup>27</sup> Gaçupin (gachupin) – nofkë përçmuese me të cilën në Meksikë quajnë spanjollët.

- Këtë as që mund ta besoj dot, – thashë unë.  
- Për kokë të plakës, – u betua Piel Divina.  
- Ashtu është ajo, – tha Moktezuma.  
- Po ti nga e di? – thashë unë gjithnjë e më i nxehur.  
- Edhe unë e kam qirë, – tha Moktezuma, – nuk gjen gocë aq të apasionuar si ajo në tërë Meksikon, veç unë kurrë nuk e kam goditur, jo, jo, gjëra të tilla të çuditshme nuk më pëlqejnë mua. Asaj po, jam i bindur.

- Unë nuk e godita, më dëgjon, puna është se Maria është dalldisur pas Markes de Sades dhe donte t'i provonte shuplakat në mollaqe, – tha Piel Divina.

- Kjo është një veti e Maries, – tha Pançoja, – është pasojë e leximeve të saj.

- Dhe vazhduat të qiheshit? – thashë unë. Pëshpërita apo ulërita, nuk më kujtohet, por më kujtohet mirë që i dhashë ca të thithura të shpejta bishtit të cigares me drogë dhe që atyre iu desh të ma përsëritnin disa herë se çfarë kishte ndodhur, se nuk ishte vetëm për mua.

- Po pra, vazhduam punën tonë, domethënë ajo vazhdoi të pinte sisën time dhe unë vazhdova ta goditja me pëllëmbë bythëve, por çdo herë e më me pak forcë ose çdo herë e më me pak dëshirë, sepse mendoj që mua më kishte tronditur ardhja e mamasë së saj dhe, ngaqë tashmë isha ftohur, nuk kisha më dëshirë për ta qirë, doja vetëm të ngrihesha e mbase të shkoja e të bëja një xhiro nga festa, besoj se atje ishin disa poetë të famshëm, *gaçupin*-ë, Ana Maria Diaz dhe zoti Diaz, prindërit e Laura Damianit, poeti Alamo, poeti Labarka, poeti Berrokal, poeti Artemio Sançes, artistja televizive Amerika Lagos, po ashtu ngaqë kisha ca frikë se mos dukej atje përsëri mamaja e Maries, veç kësaj here e shoqëruar prej atij arkitektit bythëmut, dhe atëherë do t'i ikte truri vërtet.

- Ishin prindërit e Laura Damianit? – thashë.

- Pikërisht prindërit e casta diva-s, – tha Piel Divina, – dhe personalitete të tjera të njohura, nuk të besohet, po mua më pëlqen të përqendrohem në këto hollësi, më përpara i kisha parë nga larg, kisha përshëndetur poetin Berrokal, dikur kisha asistuar në studion e tij, nuk e di nëse më mbante mend apo jo. Gjithashtu më duket



se kisha uri dhe, vetëm duke imagjinuar gjërat që po hanin në shtëpinë tjetër, më lëshonte goja lëng. E kisha të qartë se nuk ishte mirë të dukesh atje me Marien dhe t'i futesha të ngrënit me babëzi. Ndiheha i këputur, duhet ta kisha nga të thithurit. Por e vërteta e thjeshtë është se unë as që mendoja fare të thithurit, më kupton? Nuk mendoja për buzët e Maries, as për gjuhën e saj që më lëpinte karin, as për pështymën e saj që tani më zbriste poshtë nëpër qimet e koqeve...

- Mjaft se na hape barkun, – tha Pançoja.

- Mos, se e dhjeve fare, – tha vëllai i tij.

- Ik or, se na çave kokën, – thashë unë për të mos mbetur pa folur, megjithëse, në të vërtetë, nuk po e duroja dot.

- Mirë, pra ia thashë. I thashë: Marie, e lëmë për një herë tjetër ose për natën tjetër. Zakonisht qiheshim këtu, në shtëpinë time, pa kufij kohe, edhe pse ajo asnjëherë nuk rrinte tërë natën, gjithnjë ikte në katër të mëngjesit ose në pesë, dhe ishte një vuajtje për mua, sepse unë gjithnjë i lutesha ta shoqëroja, nuk doja ta lija vetëm në atë orë. Por ajo më tha vazhdo, mos ndalo, nuk ka fare problem. Unë e kuptova se më thoshte që të vazhdoja ta qëlloja me dacka në prapanicë, si do ta kishe kuptuar ti? – njësoj, i tha Pançoja, – kështu që fillova përsëri, me një dorë e goditja dhe me tjetrën i fërkoja klitorin dhe sisët. Për mua, sa më parë ta bënim, më mirë do të ishte. Unë isha gati. Ama, nuk doja të prishesha pa u prishur edhe ajo. Por ajo karakurva vonohej tmerrësisht. Kjo më tërboi dhe si herët e tjera iu futa me dacka të forta. Në mollaqe, në kofshë dhe në pidh. Po ju, çuna, nuk e kini bërë ndonjëherë këtë? Mirë, jua rekomandoj. Në fillim kërcitja, kërcitja e pëllëmbëve, nuk e di mirë se qysh, të lë pa mend, është si diçka tepër e papjekur në një pjatë, ku gjërat janë të gatuar mirë, por pastaj sikur lidhet me atë çka je duke bërë, dhe rënkimet e saj, ato të Maries, gjithashtu bashkohen, çdo goditje prodhon një rënkim, dhe kjo vjen në rritje, dhe mbërrin një çast kur ndien mollaqet e saj të digjen, dhe pëllëmbët e tua gjithashtu digjen, dhe kari fillon të të regëtojë sikur të ishte një zemër, tak, tak, tak...

- Mjaft, robi, se na çokanise kokën, – tha Moktezuma.

- Me të vërtetë. Ajo e mbante karin tim në gojë, por nuk po ma shtrëngonte, as po ma thithte, vetëm sa e përkëdhelte me

majën e gjuhës. E mbante si një pistoletë brenda në këllëf. E vë re ndryshimin? Jo si një pistoletë në dorë, por si një pistoletë e futur në këllëf, në mëngore ose në fishekore, nuk e di në e thashë mirë. Edhe ajo regëtime, i regëtime mollaqet, këmbët, buzët e pidhit dhe klitori, e di pse, sepse godit e godit, por edhe e përkëdhelja, ia fusja dorën atje dhe ndizesh flakë e mezi po mbahesha për të mos u prishur. Dhe rënkonte, po kur e goditja më shumë, rënkonte më shumë (unë nuk mund t'ia shikoja fytyrën), por kur goditjet bëheshin shumë më të forta, them, rënkimet, sikur i dhembte shpirti, dhe unë atëherë doja ta ktheja nga vetja e t'ia fusja brenda, por as mos e shko në mendje këtë, do të mërzitej, është e papranueshme për Marien, gjërat me të bëhen të forta, por duhet të jenë sipas mënyrës së saj.

- E çfarë u bë pastaj? – pyeta unë.

- Pra ajo u prish, u prisha dhe unë dhe asgjë më.

- Asgjë më? – tha Moktezuma.

- Të betohem, asgjë më. Pastaj, u pastruam, unë u pastrova, u kreuha një çikë, ajo veshi pantallonat dhe dolëm për të parë si shkonte festa. Aty u ndamë. Ai qe gabimi im. Që u ndava prej saj. Unë fillova të bisedoj me maestro Berrokalin, i cili ndodhej vetëm në një qoshe. Pastaj me ne u bashkua poeti Artemio Sançes dhe një gocë që shkonte me të, një tipe nja tridhjetë vjeçe që, me sa duket, ishte sekretare e revistës *El Guajolote* dhe unë pikërisht aty fillova ta pyes nëse i duheshin poezi, tregime apo tekste filozofike për revistën; i thashë se kisha material të pabotuar me shumicë, i fola për përkthimet e vëllamit tim, Moktezuma, dhe ndërsa flisja po shikoja me bisht të syrit tavolinën në kuzhinë, sepse më kishte marrë një uri e pjerdhur sa... atëherë pashë përsëri mamanë e Maries, pas saj të shoqin dhe një çikë më mbrapa poetin e famshëm spanjoll, dhe aty përfundoi gjithçka: më dhanë shkelmin e më paralajmëruan të mos dukesh më në shtëpinë e tyre.

- Po Maria nuk u ndje fare?

- Jo, nuk tha asgjë. Unë në fillim u hoqa sikur nuk po kuptoja hiç si ishte puna, dreqi e mori, sikur çështja nuk kishte të bënte me mua, por më pas, vëllaçko, pse ta fsheh, u bë e qartë që do të më përzinin si një qen të zgjebosur. Më erdhi vdekje që ma bënë në sy të maestro Berrokalit, sepse në të vërtetë, me siguri ai kodosh do të shqyhej

së qeshuri përbrenda, ndërkohë që unë zvarritesha drejt derës dhe mendoja se pati një çast kur isha gati t'i thosha që e admiroja.

- Berrokalit? Çfarë trapi që je, Piel, – tha Pançoja.

- E vërteta është se në fillim u soll mirë me mua. Ju e merrni vesh këtë punë, janë kryeqytetas, janë rritur këtu, unë kam ardhur këtu pa njohur njeri dhe pa një mut peso në xhep. Kjo ka ndodhur këtu e tre vjet të shkuara, unë atëherë isha njëzet e një. Ishte si një garë me pengesa. Dhe Berrokali u soll mirë me mua, më mori në studion e tij, më prezantoi me njerëz që mund të më fusnin në një punë, në studion e tij njoha Marien. Jeta ime ka qenë një gënjeshtër, – tha më në fund, me një zë të përgjumur Piel Divina.

- Mirë, vazhdo: Berrokali të shikonte dhe qeshte, – thashë unë.

- Jo, nuk qeshte, por unë besoj se qeshte përbrenda. Edhe Artemio Sançes më shikonte, por ishte aq i çoroditur sa nuk e mori vesh për çfarë bëhej fjalë. Dhe sekretarja e redaksisë së *El Guajolote*-s ishte ajo që u habit më shumë, kështu m'u duk mua, dhe nuk kishte si të ndodhte ndryshe, po të shikojë fytyrën e mamasë së Mariës me qimet e kokës përpjetë. Ju betohem që mendova se mund të ishte e armatosur. Dhe unë, vëllezër, isha gati t'ia mbathja e të dilja andej me vrap, megjithatë tërhiqesha ngadalë, sepse nuk e kisha humbur ende shpresën se do të dukej Maria, se Maria do të çante përmes të ftuarve dhe prindërve të saj dhe do ta hidhte dorën e saj mbi supin tim, Maria është e vetmja femër që njoh e cila nuk i përqafton burrat nga mesi, por nga supet, dhe do të më nxirrte prej andej siç më kishte hije, them unë, se do të dilnim andej bashkë.

- A u duk?

- A u duk... Asaj që i thonë të dukur, jo. Por, që e pashë, po. E nxori kokën për disa sekonda, midis supeve dhe kokave të disa zabërhanëve.

- E çfarë bëri?

- Asgjë, kurva e mutit, nuk bëri asgjë.

- Ndoshta nuk të ka parë, – tha Moktezuma.

- Patjetër që më pa. Më shikoi në sy me atë mënyrën e saj, ju e dini si është ajo, nganjëherë të shikon dhe duket sikur nuk të shikon apo sikur të depërton me vështrimin e saj. Dhe pastaj u zhduk.

Kështu që unë i thashë vetes: sot je i humbur, robi, hajde ik, mos e bëj të madhe. Dhe kështu, bëra si bëra, u tërhoqa, se do të më turrej me të shara zuzaresh mamaja e Maries, mendova unë, e do të më futej me shkelma nga koqet, ose të paktën do të më qëllonte me ndonjë dackë. Mbathja, shoku, thashë, s'ka më kohë të tërhiqesh me terezi, është më mirë t'ia fusësh vrapit, por, tamam në atë çast, ajo karakurva plakë m'u hodh përsipër, thua se do të më puthte apo do të më kafshonte, dhe çfarë mendoni se më tha...

Vëllezërit Rodrigues nuk thanë asgjë, sigurisht e dinin ç'do t'u thoshte.

- Ta zuri në gojë e ëma? – thashë unë vrulltazi.

- Më tha: sa turp, sa turp, vetëm kaq, por të paktën nja dhjetë herë dhe më pak se një centimetër nga fytyra ime.

- Nuk të besohet që ajo shtrigë zuzare të ketë pjellë Marien dhe Angjeliqën, – tha Moktezuma.

- Eh, kanë ndodhur gjëra edhe më të çuditshme, – tha Pançoja.

- Vazhdon të jesh dashnor i saj? – thashë unë.

Piel Divina më dëgjoi por nuk m'u përgjigj.

- Sa herë e ke qirë atë? – pyeta unë.

- Tani as që më kujtohet, – tha Piel Divina.

- Ama ç'pyetje bën dhe ti! – tha Pançoja.

- Kot, për kureshtje, – thashë unë.

Atë natë ika shumë vonë nga shtëpia e vëllezërve Rodrigues (hëngra me ta, darkova me ta, madje edhe mund të kisha ndenjur për të fjetur me ta, zemërgjerësia e tyre nuk kishte kufij). Kur mbërrita te *Kryengritësit*, te stacioni i autobusëve, menjëherë ndjeva se tashmë nuk kisha më dëshirë, as fuqi, për diskutimin e gjatë dhe bizantin që më priste në shtëpi.

Më në fund, kur erdhi autobusi që duhej të merrja, u ngrita nga buza e trotuarit ku isha ulur dhe po meditoja e kundroja trafikun ose më mirë të them dritat e makinave që ndriçonin fytyrën time, dhe mora rrugën drejt shtëpisë së familjes Fonti.

Para se të shkoja atje, mora në telefon. U përgjigj Horhitoja. I thashë se doja të motrën. Pas pak doli Maria. I thashë se doja ta takoja. Më pyeti ku isha. Afër shtëpisë së saj, i thashë, te sheshi *Popocatépetl*.

- Prit nja dy orë, – tha ajo, – pastaj eja. Mos i bjer ziles. Kalo nga muri dhe hyr pa zhurmë. Do të pres.

Mora frymë thellë, gati i thashë se e doja (por nuk ia thashë), pastaj e preva bisedën. Meqë nuk kisha para për të hyrë në ndonjë kafe, qëndrova tek ai shesh, i ulur në një stol, duke shkruar ditarin tim dhe duke lexuar një libër me poezi të Tabladës që ma kishte dhënë Pançoja. Plot pas dy orësh, u ngrita dhe eca drejt rrugës *Colima*.

Pashë nga të dy anët para se të ngjitesha e të kapërceja murin. U hodha duke u munduar të mos shkelulet që zonja Fonti (ose shërbyesja) kishte mbjellë në atë pjesë të kopshtit. Pastaj eca në errësirë drejt shtëpizës.

Maria po më priste poshtë një peme. Para se unë t'i thosha gjë, më dha një të puthur në buzë. Ma futi gjuhën deri në gurmaz. Vinte era duhan dhe erë gjelle të shijshme. Unë mbaja erë ushqimi të varfër. Por të dy gjellët ishin të mira. Gjithë frika dhe gjithë trishtimi që ndieja avulluan në çast. Në vend që të futeshim brenda ia filluam dashurisë aty ku ishim, në këmbë, poshtë pemës. Që të mos dëgjoheshin rënkimet e saj, Maria më mbërtheu me dhëmbë për qafe. Para se të prishesha, nxora karin (Maria tha ahhhh!, kur ia nxora mbase tepër vrazhdë) dhe e shtriva mbi bar e mbi lule. Në shtëpizë, ku Angelika flinte në gjumë të thellë ose bënte sikur flinte në gjumë të thellë, e bëmë edhe një herë. Pastaj unë u ngrita, e ndieja trupin sikur ma kishin bërë thela dhe e dija se po t'i thosha se isha i dërrmuar, do të ikja menjëherë, por nuk i thashë asgjë, veç kontrollova me sy edhe qoshet më të largëta, pa le mund të zbuloja Barriosin dhe Patersonin duke fjetur diku, por nuk kishte asnjë tjetër veç motrave Fonti dhe meje.

Pastaj ia nisëm bisedës. U zgjua edhe Angelika dhe ndezëm dritën e biseduam deri vonë. Folëm për poezinë, për Laura Damianin, për çmimin me emrin e saj dhe për poetin e vdekur, për revistën që mendonin të nxirrnin Ulises Lima dhe Belanoja, për jetën e Ernesto San Epifanos, për atë se si do të ishte fytyra e Hurakan Ramiresit, për një piktor, mik i Angelikës, që jetonte në Tepito dhe për miqtë e Maries në shkollën *Danza Moderna*. Dhe pas tërë atyre bisedave e shumë cigareve Angelika dhe Maria fjetën, ndërsa unë fika dritën e u futa në krevat dhe me mend bëra prapë dashuri me Marien.

## 20 nëntor

Militantizma politikë: Moktezuma është trockist. Hasinto Rekena dhe Artur Belanoja ishin trockistë.

Maria Fonti, Angjelika Fonti dhe Laura Hauregi (ish-shoqe e Belanos) i përkisnin një lëvizjeje feministe radikale e quajtur *Mexicanas al Grito de Guerra*. Atje ka të ngjarë që njohën Simon Darriënë, mike e Belanos dhe propagandiste e një lloj sadomasikizmi.

Ernesto San Epifanio themeloi të parën Parti Komuniste Homoseksuale në Meksikë dhe të parën Komunë Proletare Homoseksuale Meksikane.

Ulises Lima dhe Laura Damiani planifikuan të themelonin një grup anarkist: mbetej projekti i një manifesti themeltar. Më përpara, kur ishte pesëmbëdhjetë vjeç, Ulises Lima kishte tentuar të hynte në atë që mbeti nga grupi gueril i Lusio Kabanjas.

I ati i Kim Fontit quhej gjithashtu Kim Fonti, kishte lindur në Barcelonë dhe ishte vrarë në betejën e Ebros.

I ati i Rafael Barrios kishte milituar në sindikatën hekurudhore klandestine. Kishte vdekur nga cirroza.

I ati dhe e ëma e Piel Divinës kishin lindur në Oaksaka dhe, siç thotë vetë Piel Divina, kishin vdekur nga uria.

## 21 nëntor

Festë në shtëpinë e Katalina O'Harës.

Në mëngjes fola në telefon me tim ungj. Më pyeti se a kisha ndër mend të kthehesha. Gjithnjë, i thashë. Pas një heshtjeje të vështirë (me siguri ose nuk e kuptoi përgjigjen time, ose nuk deshë ta pranojë), më pyeti se në ç'ngatërrësë isha futur. Në asgjë, i thashë. Huan, sonte dua të të shoh në shtëpi, më tha, siç është e mira, ndryshe e ke keq punën. Pastaj dëgjova teto Martitën të qante. Mirë, i thashë. Pyete se mos është i droguar, i tha ajo, por im ungj i tha mjaft se të dëgjon dhe pastaj më pyeti nëse kisha para apo jo. Sa për autobus, thashë dhe pastaj nuk munda të flisja më.

Në të vërtetë nuk më kishin ngelur para as për autobus. Megjithëse më pas gjërat morën një rrugë të paparashikuar.

Në shtëpinë e Katalina O'Harës ishin Ulises Lima, Belanoja, Myleri, San Epifanio, Barriosi, Barbara Patersoni, Rekena dhe e dashura e tij Ksoçitla, vëllezërit Rodrigues, Piel Divina, piktorja që kishte një studio me Katalinën dhe plot njerëz të tjerë të panjohur, për të cilët nuk kisha dëgjuar të flitej dhe që dukeshin e zhdukeshin si një lumë i errët.

Kur mbërritëm Maria, Angjelika dhe unë, dera e shtëpisë ishte e hapur dhe sa hymë pamë vëllezërit Rodrigues që rrinin ulur te shkallët që të çonin në katin e dytë. Po pinin së bashku një bisht cigareje me marijuanë. I përshëndetëm dhe u ulëm pranë tyre. Besoj se na prisnin. Pastaj Pançoja dhe Angjelika u ngjiten lart dhe ne mbetëm vetëm. Nga pjesa e pasme e shtëpisë vinte një muzikë e kobshme, me sa duket qetësuese, domethënë me tinguj zogjsh, rosash, bretkosash, ere, deti, përfshi edhe hapat e njerëzve mbi tokë ose mbi bar të thatë, por që gjithsesi rezultonte e frikshme, si muzikë sfondi në një film me terror. Pastaj erdhi aty Piel Divina, e puthi Marien në faqe (unë shikojta në anën tjetër, nga një mur plot me gardëroba grash apo me ëndrra grash) dhe filloi të bisedonte me ne. Nuk e di pse, ndoshta nga druajtja, ndërkohë që ata bisedonin (Piel Divina ishte një frekuentues i shpeshtë i Shkollës së Vallëzimit, ishte në ujdi me Marien), dalëngadalë, sikur po përçartësja e po përhumbësja, fillova të mendoj për ca gjëra të çuditshme që i kisha përjetuar atë mëngjes në shtëpinë e familjes Fonti.

Në fillim gjithçka kaloi natyrshëm. U ula në tryezë për të ngrënë mëngjes bashkë me familjen, zonja Fonti më përshëndeti ëmbëlsisht, Horhitoja nuk më pa (ishte ende përgjumësh), shërbyesja, sa mbërriti, më bëri një përshëndetje, ku dallohej simpatia; deri aty mirë, aq mirë sa për një çast arrita të mendoj se mund ta kaloja edhe në shtëpizën e Maries pjesën e jetës që më kishte mbetur. Dhe pikërisht atëherë u duk Kimi. Vetëm pamja e tij m'i ngriti qimet përperjetë. Dukej se nuk kishte fjetur tërë natën, dukej sikur sapo kishte dalë nga një sallë torturash apo nga një karrige xhelatësh, flokët i kishte rrokopujë, sytë të skuqur, i parruar (as i larë), duart i kishte bërë pis me diçka, se në kurriz të duarve dukeshin njolla jodi e në gishta njolla boje.

Sigurisht, nuk më përshëndeti, edhe pse unë i thashë mirëdita me shumë përzemërsi. Gruaja e tij dhe të bijat nuk ia varën fare. Pas disa minutash, edhe unë e harrova. Të ngrënët e tij qe shumë i përkorë krahasuar me tonin: gjerbi dy filxhanë me kafe të zezë dhe pastaj ndezi një cigare të zhaparitur që e nxori jo nga paketa, por nga xhepi, duke na parë në një mënyrë të veçantë, sikur të na sfidonte, por, në të njëjtën kohë, sikur të mos na vinte re. Me të mbaruar mëngjesin unë, u ngrit e më kërkoi ta ndiqja, se donte të fliste pak me mua.

Pashë nga Maria, pashë nga Angjelika, por në fytyrat e tyre nuk dallova asnjë shenjë që të më këshillonin të mos i bindesha; dhe shkova pas tij.

Ishte hera e parë që hyja në studion e Kim Fontit dhe më habitën përmasat e dhomës. Ishte shumë më e vogël se dhomat e tjera të shtëpisë. Atje qenë grumbull, pa rend e pa rregull, fotografi, plane të punuara me rapidograf dhe të ngjitura mureve ose të shpërndara sheshit. Një tryezë vizatimi dhe një bankë ishin të vetmet mobilie dhe zinin më shumë se gjysmën e hapësirës së studios. Vinte erë duhan dhe djersë.

- Kam punuar gjithë natën dhe nuk e kam qepur fare syrin, – tha Kimi.

- Ah, pse? – thashë unë, ndërsa mendoja se ishte mërzitur, sepse Kimi, me siguri, e kishte marrë vesh që kisha ardhur një natë më parë, sepse na kishte parë mua dhe Marien nga e vetmja dritare e vogël e studios, dhe tani do të vinte qortimi.

- Po, shiko duart e mia, – tha.

Shtriu duart në lartësinë e gjoksit të vet. I dridheshin mjaft.

- Me ndonjë projekt? – pyeta me ëmbëlsi ndërsa shikoja letrat e shpërndara mbi tryezë.

- Jo, – tha Kimi, - me një revistë, me një revistë që do të dalë së afërmi.

Nuk e di pse, por menjëherë më shkoi mendja (ose e dija se ai vetë do të ma thoshte) se ishte fjala për revistën e viseralistëve.

- Tani kam për t'u dhënë një dru të mirë të gjithë atyre që më kanë kritikuar, po zotëri, – tha.

Iu afrova tryezës dhe vura re diagrame dhe vizatime, duke i ngritur lehtë fletët që qenë shpërndarë pa kurrfarë rregulli. Projekti i revistës



ishte një kaos figurash gjeometrike dhe emrash apo shkronjash të vizatuara kuturu. Nuk pata asnjë dyshim se i mjeri zoti Fonti ishte në prag të një kolapsi nervor.

- Hë, si të duket?

- Shumë interesante, – thashë.

- Tani do ta marrin vesh ata budallenjtë se çfarë do të thotë avangardë, apo jo? Ja, kjo u mungonte poezive, e shikon? Këtu do të dalin poezitë tuaja.

Hapësira që më tregoi ishte plot me vija, vija që imitonin shkrimin, por edhe vizatime, sikur në serinë e rrëfimit vizatimor dikush nëm me: gjarpërinj, bomba, thika, kafka, fyej këmbësh të kryqëzuar, shpërthime të vogla atomike. Përveç kësaj, çdo faqe ishte një përmbledhje e ideve të pafundme që Kim Fonti zotëronte mbi disenjon grafike.

- Shiko, kjo është anagrama e publikimit.

Një gjarpër (që ndoshta buzëqeshte, por që më shumë gjasa kishte të përdridhej nga një spazmë dhimbjeje) kafshonte bishtin me një pamje grykësie dhe vuajtjeje, me sytë ngulur si gjilpëra mbi lexuesin hipotetik.

- Por askush nuk e di ende sesi do të quhet revista, – thashë.

- Njësoj është. Gjarpri është meksikan dhe veç kësaj simbolizon qarkullimin. E ke lexuar Niçen, Garsia Madero? – tha papritur.

Jo, thashë, si me pahir. Pastaj pashë me kujdes çdo faqe të revistës (ishin mbi gjashtëdhjetë) dhe kur isha gati të ikja, Kimi më pyeti se çfarë lloj marrëdhëniesh kisha me të bijën. I thashë se ishin të mira, se Maria dhe unë kuptoheshim çdo ditë e më mirë, dhe pastaj heshta.

- Ne prindërit vuajmë shumë, – tha, - sidomos në kryeqytet. Sa ditë ke që nuk fle në shtëpinë tënde?

- Tri net, – thashë.

- Nuk shqetësohet nëna jote?

- I kam marrë në telefon, e dinë që jam mirë.

Kimi më pa nga lart poshtë.

- Nuk më dukesh mirë nga pamja, djalosh.

Mblodha supet. Për një çast të dy mbetëm pa folur fare, të menduar, ai duke trokitur me gishta mbi tryezë dhe unë duke parë

planet e vjetra të shtëpive ideale (dhe që siç duket Kimi kurrë nuk arriti t'i realizojë dot) të mbërthyer me pineska nëpër mure.

- Eja me mua, – tha.

E ndoqa pas deri te dhoma e tij, në katin e dytë, që ishte nja pesë herë më e madhe se studioja.

Hapi gardërobën dhe nxori aty një këmishë sportive ngjyrë të gjelbër.

- Provoje, të shohim si të rri.

U mëdysha për disa çaste, por gjesti i Kimit ishte i prerë, sikur nuk donte të humbiste kohë. E lashë këmishën time mbi këmbët e krevatit, një krevat aq i madh sa mund të flinin në të Kimi, e shoqja dhe të tre fëmijët, dhe vesha këmishën e gjelbër. Më rrinte mirë.

- Ta kam falur, – tha Kimi. Pastaj futi dorën në xhep dhe më zgjati ca kartëmonedha. – Për të qerasur Marien me ndonjë freskuese.

Dora po i dridhej, krahu i shtrirë po i dridhej, krahu tjetër që mbështetej në ijën e tij, po ashtu i dridhej dhe me fytyrë bënte ca ngërdheshje të tmerrshme që më detyruan ta heq menjëherë vështrimin prej tij e ta hedh në çdo anë tjetër. E falënderova, por i thashë se nuk mund t'i pranoja.

- Sa i çuditshëm, – tha Kimi, - të gjithë i pranojnë paratë e mia, ime shoqe, vajzat, im bir, punonjësit e mi, – përdori shumësin, edhe pse unë tani e dija shumë mirë se nuk kishte asnjë punonjës, përveç shërbyeses, po ai nuk e kishte fjalën për shërbyesën, - edhe shefave të mi u pëlqejnë paratë e mia dhe prandaj m'i mbajnë.

- Shumë të faleminderit, – i thashë.

- Merri dhe futi në xhep, hajt!

I mora paratë dhe i futa në xhep. M'u dukën shumë, megjithëse nuk e pashë të udhës t'i numëroja.

- Do t'i kthej sa më parë që të mundem, – i thashë.

Kimi u shtri në shpinë mbi krevat. Trupi i tij bëri një zhurmë të mbytur dhe pastaj u drodh. Për një çast mendova se mos ishte një krevat prej uji.

- Mos e vra mendjen, djalosh. Në këtë botë duhet ta ndihmojmë njëri-tjetrin. Ti ndihmon vajzën time, unë të ndihmoj ty me pak të holla për harxhimet e tua, le të themi me një rrogë ekstra, apo jo?

Zëri i tij tingëllonte i lodhur, dukej pothuaj i këputur dhe ishte gati t'ia fuste gjumit, por sytë vazhdonte t'i mbante të hapur, duke shikuar tavanin.

- Më pëlqen si ka dalë revista, do t'ua mbyll gojën të gjithë atyre rrufjanëve, – tha, por tashmë zëri i tij ishte si një murmurimë.

- E shkëlqyer ka dalë, – thashë

- E qartë, nuk jam kot arkitekt, – tha ai. E pas një çasti: – Ne gjithashtu jemi artistë, puna është se dimë ta fshehim shumë mirë, apo jo?

- Ashtu është, – thashë.

M'u duk se filloi të gërhinte. E pashë në fytyrë: sytë i kishte të hapur. Kim?, thashë. Nuk u përgjigj. Iu afrova shumë ngadalë dhe preka dyshekun. Në brendësi të tij diçka iu përgjigj veprimit tim. Flluska të mëdha sa një mollë. Bëra mbrapsht dhe ika nga dhoma.

Pjesën tjetër të ditës e kalova me Marien e pas Maries.

Ra shi nja dy herë. Kur mbaroi shiu i parë, doli një ylber. Herën e dytë nuk doli gjë. Re të zeza dhe natë mbi luginë.

Katalina O'Hara është bionde, është njëzet e tre vjeçe dhe ka një fëmijë. Është e ndarë nga burri dhe është e bukur.

Po ashtu njoha edhe Laura Hauregin, shoqen e Artur Belanos. Ishte në festë me Sofie Galvesin, dashuria e humbur e Ulises Limës.

Që të dyja janë të bukura.

Jo, Laura është *shumë* më e bukur.

Piva pa masë. Real-viseralistët gëlonin ngado edhe pse më shumë se gjysma e tyre, në fakt, ishin studentë të maskuar.

Angjelika dhe Pançoja ikën shpejt.

Në një moment të caktuar të mbrëmjes, Maria më tha: katastrofa është e shpejtë.

## 22 nëntor

U zgjova në shtëpinë e Katalina O'Harës. Ndërsa haja mëngjesin, shumë herët (Maria nuk ishte, të tjerët flinin), me Katalinën dhe djalin e saj, të voglin Davi, të cilin duhej ta çonte në çerdhe, kujtova natën e kaluar, kur kishim mbetur pak vetë, Ernesto San Epifanio tha

se ekzistonte letërsi heteroseksuale, homoseksuale dhe biseksuale. Përgjithësisht, romanet ishin heteroseksuale, poezia, përkundrazi, ishte plotësisht homoseksuale, tregimet, mendoj, ishin biseksuale, megjithëse këtë nuk e tha.

Brenda oqeanit të pafund të poezisë dallohen rryma të ndryshme: dylbere, dylberuce, historike, homoseksuale, flutura, nimfa, lozonjare, të zhburrënuara dhe delikate. Uollt Uitmani, për shembull, ishte një poet dylber. Pablo Neruda, poet dylberuc. Uiliam Blejk, pa pikë dyshimi, ishte dylber dhe Oktavio Paz dylberth. Borhes ishte delikat, domethënë papritur mund të bëhej dylber ose, befas, thjesht a seksual. Ruben Darío ishte një historike, në të vërtetë mbretëresha dhe modeli i historikeve.

- Në gjuhën tonë, kuptohet, – sqaroi. – Në botën e madhe dhe të huaj modeli vazhdon të jetë Verlen Shpirtgjëri.

Sipas San Epifanios, një historike ishte më afër çmendurisë së lulëzuar dhe halucinacioneve të gjalla, ndërsa dylberët dhe dylberucët endeshin si të zalisur nga Etika tek Estetika dhe anasjelltas. Sernuda, i dashuri Sernuda, ishte një nimfë dhe në çaste hidhërimi të madh një poet dylber, ndërsa Gijeni, Aleksandri dhe Alberti mund të konsiderohen respektivisht: dylberucë, homoseksualë dhe flutura. Poetët e tipit Karlos Pejiser, sipas një rregulli të përgjithshëm, ishin homoseksualë, ndërsa poetët si Tablada, Novo, Renato Leduk ishin dylberucë. Në fakt, poezisë meksikane i mungonin poetët dylberë, edhe pse ndonjë optimist mund të mendonte se atje bënte pjesë Lopes Velarde apo Efrain Huerta. Përkundrazi, dylberucët ishin me shumicë, që nga mujshari (megjithëse për një çast unë dëgjova mafioz) Dias Miron e deri tek i shquari Homero Aridhis. Na duhet të vijmë tek Amado Nervo (dëgjohen fërshëllima) ku do të gjejmë një poet të vërtetë, domethënë një poet dylber dhe jo një lozonjar, siç është tani i famshmi dhe i rivendikuari, boliviani Manuel José Oton, sido që të jetë, i padurueshëm. Meqë ra fjala për të padurueshmit: Manuel Akunja ishte dylberuc, dhe Gresia José Hoakin Pesado ishte një nimfë e pyjeve të Greqisë, pronarë të përhershëm të njëfarë lirike meksikane.

- Po Efrén Rebodejo? – pyeta unë.

- Një dylberth i vockël fare. Virtyti i vetëm i tij është për të qenë, në mos i vetmi, të paktën i pari poet meksikan që botoi një libër në Tokio, *Rima japoneze*, më 1909. Sigurisht, ishte diplomat atje.

Pas gjithë këtyre, panorama poetike ishte thelbësisht lufta (nëntokësore), rezultati i betejës midis poetëve dylberë dhe poetëve dylberucë për t'u mësuar me *fjalën*. Dylberthët, sipas San Epifanios, ishin poetët dylberë në gjak, të cilët për dobësi ose rehati bashkëjetonin dhe respektonin – megjithëse jo gjithnjë – parametrat estetikë dhe vitalë të dylberucëve. Në Spanjë, në Francë dhe në Itali poetët dylberucë kanë qenë legjion, thoshte ai, në kundërshtim nga ç'mund të mendonte një lexues jo tepër i vëmendshëm. Ajo që ndodhte ishte se një poet dylber si Leopardi, për shembull, në njëfarë mënyre rikrijon dylberucë si Ungaretti, Montale dhe Quasimodo, trashja e vdekjes.

- Po ashtu Pasolini stërlyen dylberinë aktuale italiane, shiko rastin e të mjerit Sanguinetti (me Pavesen nuk përzihem, ishte një flutur e trishtuar, shembull i vetëm i llojit të vet, apo me Dino Kampanën, që ha në tavolinë mënjanë, tavolinë e fluturave të fundit). Për të mos folur për Francën, gjuha e madhe e qelizangrënësve, ku njëqind poetë dylberë, që nga Vijoni deri te Sofi Podolski kanë mbrojtur, po mbrojnë e do të mbrojnë me gjakun e sisëve të dhjetë mijë poetëve dylberucë, me oborrin e tyre të nimfave, homoseksualëve dhe fluturave, drejtorë shumë të lartë të revistave letrare, përkthyes të mëdhenj, funksionarë të vegjël dhe diplomatë shumë të nderuar të Mbretërisë së Letrave (shiko, në qoftë se jo, e vajtueshme dhe e mbrapshtë të mendosh për poetët e *Tel Quel-it*). Dhe nuk themi asgjë për dylberinë e Revolucionit Rus ku, nëse do të jemi të sinqertë, pati vetëm një poet dylber, vetëm një.

- Cili? – Majakovski? – e pyeta.

- Jo.

- Esenini?

- As ai.

- Pasternak, Blok, Mandelsen, Ahmatova?

- Aq më pak.

- Thuaje, drejtin, Ernesto, se më hoqe trurin.

- Vetëm një, – tha San Epifanio, - dhe tani po ta nxjerr merakun, dylberi i stepave dhe i akujve, kokë e këmbë dylber: Khlebnikov.

Pati mendime për të gjitha shijet.

- Po në Amerikën Latine, sa dylberë të vërtetë mund të gjejmë? Vajeho dhe Martin Adani. Pikë dhe kryeradhë. Mos vallë Masedonio Fernandez? Të tjerët, dylberucë të tipit Huidobro, flutura të tipit Alfonso Kortés (edhe pse ky ka vargje prej dylberthi autentik), të homoseksualëve të tipit Leon de Greif, nimfa lozonjare të tipit Pablo de Roka (me kërbacë historik që do ta kishin çmendur Lakanin), dylberucët e tipit Lezama Lima, lexues i rremë i Gongorës, dhe bashkë me Lezamën të gjithë poetët e Revolucionit Kuban (Diego, Vitier, Retamari i tmerrshëm, Gijeni i dhimbshëm, Fina Garsia e pangushëllueshme) me përjashtim të Rohelio Nogeras, që është një magji dhe një nimfë me shpirt dylberi lojçak. Por le të vazhdojmë. Në Nikaragua sundojnë fluturat e tipit Koronel Urteço ose dylberucët me vullnet buzëpërdredhurish, të tipit Ernesto Kardenal. Dylberët, gjithashtu, janë Bashkëkohësit e Meksikës.

- Jo, - bërtiti Belanoja, - Gilberto Oven jo!

- Në fakt, – vazhdoi pa u turbulluar fare San Epifanio, - *Vdekje pa fund* është, bashkë me poezinë e Pasit, *La Marsejeza* e poetëve dylberucë meksikanë sedentarë dhe tepër të nervozuar. Emra të tjerë: Helmani nimfë, Benedeti dylberuc, Nikanor Parra dylberth, më pak se dylber, Uestfalen historik, Enrike Lin dylberuc, Hirondoja flutur, Ruben Bonifas Nunjo flutur e homoseksualizuar, Sabinesi homo i homoseksualizuar, i dashuri dhe i paprekshmi ynë Hosemijo Pe historik. Le të kthehemi në Spanjë, në origjinë – vërshëllima -: Gongora dhe Kevedo<sup>28</sup> dylberucë; San Huan de la Krus dhe Frei Luis de Leon dylberë. Ja, u thanë të gjithë. Tani disa ndryshime midis dylberucëve dhe dylberëve. Të parët e kërkojnë edhe në gjumë një rroçkë tridhjetë centimetra që t'i hapë dhe t'i ndërzejë, por kur vjen çasti i vërtetë, e kanë shumë të vështirë për të shkuar në shtrat me hamshorët e tyre të shpirtit. Dylberët, përkundrazi, të duket se kërkojnë përherë një hu për të llokoçitur të përbrendshmet dhe, kur

---

<sup>28</sup> Francisco de Quevedo (1580–1645) – shkrimtar spanjoll, përfaqësues i Shekullit të Artë.

shikohen në një pasqyrë (veprim që e duan dhe e urrejnë me gjithë shpirt), në sytë e tyre të zgarbulluar zbulojnë identitetin e Rrufjanit të Vdekjes. Për dylberët dhe dylberucët, rrufjani është fjala që e paprekur përshkon zotërimet e asgjësë (ose të heshtjes ose të tjetërsisë). Veç kësaj, dhe me vullnet të mirë, nuk ka asnjë pengesë që dylberucët dhe dylberët të jenë miq të mirë, të mbulohen me finesë, të kritikohen apo të lavdërohen, të dalin hapur apo të fshihen në mënyrë të ndërsjellët në vendin e tërbuar dhe të mekur të letërsisë.

- Po Sesarea Tinahero, a është një poete dylbere apo dylberuce? – pyeti dikush. Nuk e njoha nga zëri.

- Ah, Sesarea Tinahero është tmerri vetë – tha San Epifanio.

## 23 nëntor

I tregova Maries se babai i saj më kishte dhënë para.

- Ti mendon se jam një kurvë? – tha.

- Sigurisht që jo!

- Atëherë, mos ia prano paratë atij plaku të marrë! – tha.

Këtë pasdite shkuam në një konferencë të Oktavio Pazit. Në metró Maria nuk më tha asnjë fjalë. Na shoqëroi Angelika dhe atje, u takuam me Ernesto San Epifanion. Pasi dolëm andej, u futëm në një restorant të rrugës *Palma*, ku shërbenin tetëdhjetëvjeçarët. Restoranti quhej *La Palma de la Vida*. Menjëherë e ndjeva veten si në grackë. Kamerierët, të cilët nga njëri çast në tjetrin mund të vdisnin, indiferenca e Maries, sikur të qe mërziur me mua, buzëqeshja e San Epifanios, e largët dhe ironike, Angelika që ishte njësoj si gjithnjë, të gjitha këto m'u dukën si një kurth, një shpjegim qesharak mbi vetë ekzistencën time.

Për t'i vënë kapakun, sipas tyre, unë nuk kisha kuptuar asgjë nga konferenca e Oktavio Pazit dhe mund të kishin të drejtë se vështrimi im qe fiksuar te duart e poetit që ritmonin me ato çka lexonte, sigurisht një lëvizje e pavetëdijshme, huq që nga adoleshenca e tij.

- Ky çunak është një përmbledhje e padijes, – tha Maria, - ekzemplar tipik i Fakultetit të Drejtësisë.

Preferova të mos përgjigjem. (Edhe pse më erdhën në mendje disa përgjigje.) Po çfarë mendova atëherë? Mendova për këmishën time që qelbej. Për paratë e Kim Fontit. Për poeten Laura Damiani që kishte vdekur aq e re. Për dorën e djathtë të Oktavio Pazit, për gishtin tregues e atë të mesit, për gishtin e tij të unazës, për gishtin e madh dhe të vogël që çanin ajrin e kishës, sikur në atë hapësirë *na* qenkej jeta. Gjithashtu mendova për shtëpinë time dhe krevatin tim.

Pastaj u dukën dy tipa flokëgjatë e me pantallona lëkure. Ngjanin si muzikantë, por ishin studentë të Shkollës së Vallëzimit.

Për shumë çaste nuk ekzistoj fare.

- Pse më urren, Maria? Çfarë të kam bërë? – e pyeta te veshi.

Ajo më pa sikur t'i kisha folur nga një planet tjetër.

- Mos u bëj qesharak, - tha.

Ernesto San Epifanio e dëgjoi çfarë tha ajo dhe më buzëqeshi në një mënyrë shqetësuese. Në të vërtetë, e dëgjuan të gjithë dhe të gjithë më buzëqeshën, sikur unë të kisha shkalluar! Në atë çast besoj se mbylla sytë. Bëra përpjekje të hyja në ndonjë bisedë. U mundova të flas për poetët real-viseralistë. Pseudomuzikantët qeshën. Në një moment Maria puthi njërin prej tyre dhe Ernesto San Epifanio nisi të më rrahë shpatullat. Më kujtohet se ia kapa dorën në ajër ose e mbërtheva për bërryli dhe, duke e parë në sytë e tij të qetë, i thashë se nuk kisha nevojë për asnjë lloj ngushëllimi. Mbaj mend që Maria dhe Angjelika vendosën të iknin me valltarët. Mbaj mend të kem dëgjuar të bërtas në ndonjë moment të natës:

- I kisha hak paratë e babait tënd!

Por nuk më kujtohet nëse ishte Maria që të më dëgjonte apo në ato çaste isha vetëm fare.

## 24 nëntor

U ktheva në shtëpi. Shkova në fakultet (por nuk u futa brenda). Do të doja të shtrihesha me Marien. Do të doja të shtrihesha me Katalina O'Harën. Do të doja të shtrihesha me Laura Hauregin.



Nganjëherë dua të shkoj në shtrat me Angjelicën, por Angjelika çdo minutë që kalon bëhet më fytyrëvrarë, më e zbehtë, më e dobët, më e përhumbur.

## 25 nëntor

Sot takova Barriosin dhe Hasinto Rekenën te kafë *Quito* dhe biseda jonë ishte tepër melankolike, sikur të ndodheshim në prag të diçkaje të ndreqshme. Megjithatë, qeshëm shumë. Më treguan se një herë Artur Belanoja kishte dhënë një konferencë në *Casa del Lago* dhe se, kur i erdhi radha të fliste, i kishte harruar të gjitha. Më duket se konferenca kishte qenë mbi poezinë kiliane dhe Belanoja kishte stisur një rrëfim mbi filmat me tmerre. Një herë tjetër, kishte dhënë konferencë Ulises Lima dhe nuk kishte shkuar askush. Me këto muhabete ndenjëm derisa u mbyll lokali.

## 26 nëntor

Nuk gjeta asnjë te kafja *Quito* dhe nuk kisha dëshirë për t'u ulur në ndonjë tavolinë e për t'iu futur leximit në mes të poteres së zyrtë të asaj ore. Për një çast nisa të eci nëpër *Bucareli*. Mora në telefon Marien po nuk më doli, kalova dy herë përballë *Kryqëzimit Veracruzana*, të tretën herë hyra dhe atje, pranë banakut, ishte Rosario.

Mendova se nuk do të më njihje. Vetë unë, në këto momente, nuk njihem! Por Rosario më pa për një çast, pastaj buzëqeshi dhe, pasi u vonua pak që të shërbente në një tavolinë plot me çehrevrasës të dehur, m'u afrua mua.

- Ma ke shkruar poezinë? – tha dhe u ul në krahun tim. Rosario i ka sytë të errët dhe unë do të thosha të zinj, ndërsa vithet i ka të gjera.

- Në njëfarë mënyre, – thashë me një ndjenjë të lehtë triumfi.

- Pa he, ma recito.

- Poezitë e mia nuk recitohen, ato vetëm lexohen, - thashë. - Besoj se José Emilio Paçeko, ka pak kohë që ka pohuar të njëjtën gjë.

- Mirë pra, lexoma, – tha Rosario.
- Desha të them se është më mirë ta lexosh ti.
- Jo, më mirë ti. Nëse do ta lexoj unë, nuk kam për ta kuptuar. Kapa kuturu një nga poezitë e mia të fundit dhe ia lexova.
- Nuk e kuptova, – tha Rosario, – po s’ka gjë, të faleminderit.

Gjatë një çasti prita se mos më ftonte të kalonim nga magazina. Po Rosario nuk ishte si Brixhida, kjo dukej qartas. Pastaj nisa të mendoj për hendekun që ndan poetin nga lexuesi dhe, ndërsa mundohesha ta merrja vesh, rashë në një dëshpërim të thellë. Rosario pasi shkoi e shërbeu nëpër tavolina të tjera, u kthye pranë meje.

- Edhe Brixhidës i ke shkruar disa vargje? – tha duke më parë në sy dhe duke fërkuar kofshët në buzë të tavolinës.

- Jo, vetëm ty, – i thashë.

- Ma treguan atë që ndodhi atë ditë.

- Çfarë ndodhi atë ditë? – thashë duke u përpjekur të tregohem i ftohtë, i ëmbël vërtet, por i ftohtë.

- E shkreta Brixhidë, ka qarë për ty, – tha Rosario.

- Po pse kështu? Ti e pe që qante?

- E pamë të gjitha. Është bërë si e çmendur për punën tënde, zoti poet. Ti duhet të kesh diçka të veçantë për t’i tërhequr femrat.

Besoj se u skuqa edhe pse në të njëjtën kohë u ndjeva i lajkatur.

- Nuk kam asgjë... të veçantë, – mëmërita. – Të ka treguar gjë ajo?

- Më ka treguar shumë gjëra. Do të t’i them?

- Mirë, – thashë, megjithëse në të vërtetë nuk isha shumë i sigurt nëse doja apo jo t’i dëgjoja të fshehtat e Brixhidës. Aty për aty urreva veten për këtë. Qenia njerëzore është mosmirënjohëse, thashë me vete, harraqe, bukëshkalë.

- Por jo këtu, – tha Rosario. – Për pak do të marr një orë pushim. E di ku është pizzeria e gringos? Atje më prit.

I thashë mirë dhe dola nga *Kryqëzimi Verakruzana*. Jashtë dita që mbushur me re dhe një erë e fortë i detyronte njerëzit të ecnin më nxituar se zakonisht ose të qëndronin në prag të dyqaneve. Kur kalova përpara kafe *Quito-s* hodha një sy, po nuk pashë asnjë të njohur. Për një çast mendova t’i telefonoj Maries, po pastaj hoqa dorë.

Piceria ishte plot dhe njerëzit hanin në këmbë racionet që ua priste vetë gringoja me një thikë të madhe kuzhine. Për ca çaste mbeta duke parë. Mendova se tregtia po i ecte mirë e duhej të fitonte shumë para dhe u gëzova që gringoja dukej simpatik. Gjithçka e bënte vetë: përgatiste brumin dhe petën, vinte domate dhe mozarelën, fuste picat në furrë, i priste, ua jepte klientëve që grumbulloheshin te banaku e ia niste përsëri nga fillimi. Pra i bënte të gjitha, përveç marrjes së parave dhe kthimit të restos. Për këtë ishte ngarkuar një djalosh nja pesëmbëdhjetë vjeç, zeshkan, me flokë të prera fare shkurt dhe që çdo çast konsultohej me gringon me zë shumë të ulët, sikur të mos i dinte mirë çmimet ose të ishte i dobët në matematikë. Pas pak çastesh vura re një detaj tjetër interesant. Gringoja nuk e lëshonte kurrë nga dora thikën e madhe të kuzhinës.

- Ja ku jam, – tha Rosario duke më kapur për mënge.

Aty në rrugë m'u duk ndryshe nga ç'ishte brenda te *Kryqëzimi Verakruzana*. Në ajrin e lirë fytyra i dukej më e brishtë, tiparet më transparente, flurore, sikur në rrugë të ekzistonte rreziku për ta kthyer në një femër të padukshme.

- Ecim pak dhe pastaj do të qeras me diçka, okej?

U nisëm në drejtim të shëtitores *Reforma*. Sapo kapërcyem rrugën e parë, Rosario më kapi për krahu dhe nuk ma lëshoi më krahun.

- Dua të jem mamaja jote, – tha, - por mos më keqkupto, nuk jam një kurvë si Brixhida, unë dua të të ndihmoj, të të trajtoj mirë, dua të jem me ty kur të bëhesh i famshëm, zemra ime.

Kjo grua duhet të jetë e çmendur, mendova, por nuk thashë gjë, vetëm buzëqesha.

## 27 nëntor

Gjithçka është e ndërlikuar. Po ndodhin gjëra të tmerrshme. Çohem natën duke bërëtitur. Shoh ëndërr sikur jam me një grua me kokë lope. Sytë e saj më shikojnë me ngulm. Në të vërtetë, me një trishtim mallëngjyes. Dhe në fund dua të them se pata një bisedë si “burri me burrin” me tim ungj. Më bëri të betohem se nuk do të marr më drogë. Jo, i thashë, nuk marr drogë, të betohem. Fare,

fare?, tha im ungj. Ç’do me thënë kjo?, thashë unë. Si ç’do me thënë kjo!, ulëriti ai. E pra, ç’do të thotë kjo?, të lutem, ji një çikë më i saktë, thashë unë duke u mbledhur si një kërmill. Natën i telefonova Maries. Nuk ishte në shtëpi dhe fola pak me Angjelicën. Si je?, më tha. Ç’është e vërteta nuk jam shumë mirë, thashë unë, në fakt jam shumë keq. Je sëmurë?, tha Angjelika. Jo, thashë nervoz. Edhe unë nuk jam mirë, tha Angjelika, nuk më zë gjumi. Do të më pëlqente ta pyesja për shumë gjëra, nga ish-virgjëresha tek ish-virgjëri, po nuk e bëra.

## 28 nëntor

Vazhdojnë të ndodhin gjëra të tmerrshme, ëndrra, makthe, vrulle që vazhdojnë dhe që janë plotësisht jashtë kontrollit. Njësoj si atëherë kur isha pesëmbëdhjetë vjeç që nuk pushoja së masturbuari. Tri të rëna me dorë në ditë, pesë të rëna në ditë dhe nuk ishte e mjaftueshme. Rosario do të martohet me mua. I thashë se unë nuk besoj te martesë. Mirë, qeshi ajo, nuk do të martohesh?, mos u marto, ajo që dua të them është se KAM NEVOJË të jetoj me ty. Të jetojmë bashkë, thashë unë, në TË NJËJTËN shtëpi? Po pra, në të njëjtën shtëpi, ose në të njëjtën DHOMË, nëse nuk kemi para për të paguar QIRANË për një shtëpi. Qoftë edhe në një shpellë, tha, nuk kam fare PRETENDIME. I shkëlqente fytyra, nuk e di nga djersa apo nga besimi i pastër në ato që thoshte. Herën e parë e bëmë në shtëpi të saj, në një ndërtesë të humbur në lagjen *Merced Balbuena*, pak hapa nga *Calzada de la Vega*. Dhoma ishte plot me pamje të Verakruzës dhe me fotografi artistësh kinemaje të ngjitura në mure me pineska.

- E ke për herë të parë, babush? – më pyeti Rosario.

Nuk e di pse i thashë po.